




LAPIDARI

I



# LAPIDARI I

Edited by · Redaktuar nga  
Vincent W.J. van Gerven Oei



*Lapidari 1*

© The Department of Eagles · Departamenti i shqiponjave, 2015.

This work is licensed under the · Kjo vepër autorizohet nën  
Creative Commons Attribution-NonCommercial-NoDerivs 3.0 Unported License.

This publication is Open Access, which means that you are free to copy, distribute, display, and perform the work as long as you clearly attribute the work to the authors, that you do not use this work for commercial gain in any form whatsoever, and that you in no way alter, transform, or build upon the work outside of its normal use in academic scholarship without express permission of the author and the publisher of this volume. For any reuse or distribution, you must make clear to others the license terms of this work.

Kjo publikim është Open Access, që do të thotë se ti je i/e lirë ta kopjosh, shpërndash, shfaqësh dhe performosh atë për sa kohë që ti saktëson qartazi se kjo punë iu përket autorëve, nuk e përdor atë për përfitime tregtare të çfarëdo lloji forme, dhe nuk ndryshon, transformon apo ndërton mbi këtë punë jashtë përdorimeve të saj të zakonshme në akademi pa lejen e shprehur të autorit dhe të publikuesit të këtij volumi. Për çdo ripërdorim ose shpërndarje, duhet t'ua bësh të qartë të tjerëve kushtet e autorizimit të kësaj pune.

First published in 2015 by · Botuar për herë të parë në 2015 pranë  
Punctum Books, Brooklyn, NY & The Department of Eagles · Departamentit të shqiponjave, Tiranë.

ISBN-13: 978-06-923504-6-1

Translations · Përkthime

Jonida Gashi (23–7; 81–8; 97–104; 115–24) & Vincent W.J. van Gerven Oei (29; 33–7; 45–7; 53–5; 125–8; 133–40)

Design by · Dizajn nga  
Vincent W.J. van Gerven Oei

Cover image · Në kopertinë

Lapidar dedicated to the 1st Offensive Brigade, Pishkash · Lapidari kushtuar Brigadës së 1-rë Sulmuese, Pishkash [ALS–38]





Many people have helped the Albanian Lapidar Survey, either through contributing to our research, field work, or by means of financial support. The Albanian Lapidar Survey team – Vincent W.J. van Gerven Oei (researcher and editor), Marco Mazzi (photographer), Xheni Alushi (assistant photographer) – would like to thank the following people: Barend Beekhuizen, Julian Bejko, Matthias Bickert, Joseph Bonk, Mariusz Czepczyński, Eda Derhemi, Jonathan Eaton, Ekphrasis Studios, Jeremy Fernando, Jonida Gashi, Wim van Gerven, Willem-Victor van Gerven Oei, Kosta Giakoumis, Iannis Goerlandt, Adam Staley Groves, Armando Guçe, Valter Gjoni, Sanja Horvatinčić, Pajtim Hoxha, Elvis Hoxhaj, Dan Hughes, Raino Isto, Nico Jenkins, Xheni Karaj, Vasilika Laci, Jérôme Le Page, Armando Lulaj, Melissa Luna, Grisilda Manjani, Giovanni Mazzi, Carrie Morgan, Oei Swan Ien, Theo Ploeg, Iris Pojani, Artan Puto, Seth Pyenson, Robert Renxa, Kailey Rocker, Gëzim Qëndro, Jonas Staal & Younes Bouadi (New World Summit), Katharina Stadler, Carlo Staldegger, Ardian Vehbiu, Maks Velo, Luis Vivaldi, Samuel Vriezen, Michelle Warren, Muharrem Xhafa, Anisa Zakolli, Katarina Živanović, as well as several anonymous donors.

We are also grateful for the support of the following Albanian institutions: Ministry of Culture, Central Albanian State Archive, Institute of Monuments, Central Albanian State Film Archive, Albanian Telegraphic Agency.

Shumë njerëz e kanë ndihmuar Hulumtimin mbi Lapidarët e Shqipërisë, duke kontribuar në kërkim, punë në terren, ose nëpërmjet ndihmës financiare. Ekipi i Hulumtimin mbi Lapidarët e Shqipërisë – Vincent W.J. van Gerven Oei (kërkues dhe redaktor), Marco Mazzi (fotograf), Xheni Alushi (asistent fotografe) – duan të falendërojnë të mëposhmit: Barend Beekhuizen, Julian Bejko, Matthias Bickert, Joseph Bonk, Mariusz Czepczyński, Eda Derhemi, Jonathan Eaton, Ekphrasis Studios, Jeremy Fernando, Jonida Gashi, Wim van Gerven, Willem-Victor van Gerven Oei, Kosta Giakoumis, Iannis Goerlandt, Adam Staley Groves, Armando Guçe, Valter Gjoni, Sanja Horvatinčić, Pajtim Hoxha, Elvis Hoxhaj, Dan Hughes, Raino Isto, Nico Jenkins, Xheni Karaj, Vasilika Laci, Jérôme Le Page, Armando Lulaj, Melissa Luna, Grisilda Manjani, Giovanni Mazzi, Carrie Morgan, Oei Swan Ien, Theo Ploeg, Iris Pojani, Artan Puto, Seth Pyenson, Robert Renxa, Kailey Rocker, Gëzim Qëndro, Jonas Staal & Younes Bouadi (New World Summit), Katharina Stadler, Carlo Staldegger, Ardian Vehbiu, Maks Velo, Luis Vivaldi, Samuel Vriezen, Michelle Warren, Muharrem Xhafa, Anisa Zakolli, Katarina Živanović, ashtu si disa dhurues anonim.

Gjithashtu jemi mirënjohës për mbështetjen nga institucionet shqiptare të mëposhtme: Ministria e Kulturës, Arkivi Qendror i Shtetit, Instituti i Monumenteve, Arkivi Qendror Shetëror i Filmit, Agjencia Telegrafike Shqiptare.





# CONTENTS · PËRMBAJTJA



TEXTS · TEKSTE

Vincent W.J. van Gerven Oei

*Introduction* – 17

*Parathënie* – 23

People's Republic of Albania, Ministry of Education, Directorate of Culture ·  
Republika Popullore e Shqipërisë, Ministrija e Arsimit, Drejtorija e Kulturës  
*Circular to the Prefectural Executive Committee (Section Education): Regarding Lapidars* – 29  
*Qarkore komitetit ekzekutiv të prefekturës (seksionit t'Arsimit): Mbi lapidarët* – 31

Ramiz Alia

*Report on the State and Measures for the Development and Further Revolutionization of Monumental Propaganda* – 33

*Relacion: Mbi gjendjen dhe masat për zhvillimin dhe revolucionarizimin e mëtejshëm të propagandës monumentale* – 39

Kujtim Buza & Kleanth Dedi

*Dignified Symbols for Historical Events* – 45

*Simbole dinjitoze ngjarjeve historike* – 49

Muharrem Xhafa

*Natural and Cultural Monuments during the Years of Socialism* – 53

*Monumentet e natyrës dhe të kulturës në vitet e socializmit* – 57

Gëzim Qëndro

*The Thanatology of Hope* – 61

*Thanatologjia e shpresës* – 67

Raino Isto

*“We Raise Our Eyes and Feel as if She Rules the Sky”: The Mother Albania Monument  
and the Visualization of National History* – 73

*“Ngremë sytë lart e ndejmë, se ajo zotëron qiellin”: Monumenti Nëna Shqipëri dhe vizualizimi i historisë kombëtare* – 81

Konstantinos Giakoumis & Christopher Lockwood

*Pilgrimage Centered at Text and Memory: The Lapidar in Qukës–Pishkash* – 89

*Pelegrinazhi i përqëndruar tek teksti dhe kujtesa: Lapidari në Qukës–Pishkash* – 97

Matthias Bickert

*Lapidars and Socialist Monuments as Elements of Albania's Historic Cultural Landscapes* – 105

*Lapidarët dhe monumentet socialiste si elemente të peizazheve kulturore historike të Shqipërisë* – 115

Julian Bejko

*About the Film Lapidari* – 125

*Rreth filmit Lapidari* – 129

Ardian Vehbiu

*Texts Chiseled on the Calendar: A Semiotic Reading of Inscriptions on the Commemorative Monuments  
of the Period of the National Liberation War* – 133

*Tekste të gdhendura në kalendar: Një lexim semiotik i mbishkrimeve në monumentet përkujtimore  
të periudhës së Luftës Nacional–Çlirimtare* – 141

INDEX OF NAMES · TREGUESI I EMRAVE – 215

INDEX OF PLACES · TREGUESI I VENDEVE – 261

INDEX OF DATES · TREGUESI I DATAVE – 267

INDEX OF MILITARY FORMATIONS OF THE ALBANIAN NATIONAL LIBERATION ARMY AND POLITICAL ORGANS  
AND ORGANIZATIONS · TREGUESI I FORMACIONEVE TË USHTRISË NACIONALÇLIRIMTARE TË SHQPËRISË DHE I  
ORGANEVE E ORGANIZATAVE POLITIKE – 277



IMAGES, PART I · PAMJE, PJESA E I-RË  
N42°27'23" E19°56'19" until · deri në N40°42'41" E19°56'48"



IMAGES, PART II · PAMJE, PJESA E II-TË  
N40°42'38" E19°56'18" until · deri në N39°39'24" E20°10'22"

Marco Mazzi

*Note* – 332

*Shënim* – 333

**TEXTS · TEKSTE**





*Rendre une période illisible, c'est autre chose,  
c'est beaucoup plus que de simplement la condamner.*

– Alain Badiou, “Le courage du présent”



# Introduction

Vincent W.J. van Gerven Oei

To a large extent, the period between 1945–1990 in Albanian history, and the type of monumentality created during this period, is still unreadable to us today. This unreadability is partially the result of a politicization of the monumental heritage from this period, if not its entire historiography, as evidenced by the many conflicting descriptive adjectives launched like missiles into the past: “socialist,” “communist,” “dictatorial,” “scientific-stalinist,” “terrorist,” “totalitarian,” and so on. This situation, however, has led to a climate of insistent negligence, if not outright condemnation and destruction, as well as various gaps in the scholarly tradition attending to the various sorts of monumentality in the Albanian cultural landscape. The most recent overview of Albanian monumentality was published in 1973, entitled *Përmendore të heroizmit shqiptar (Memorials of Albanian Heroism)*.<sup>1</sup> This album was published as a part of the campaign of what then Secretary of the Central Committee of the Albanian Labor Party Ramiz Alia called “monumental propaganda,” being an integral element of the Cultural and Ideological Revolution. As a project, the Albanian Lapidar Survey (ALS), conducted by the Department of Eagles in 2014, aimed to give a first, and general, overview of Albanian monumentality from the period 1945–1990.

As the title of this publication already suggests, ALS focused mainly on documenting a monumental form that in Albanian is called *lapidar*, although, as will be discussed below, we have also documented other forms. We have decided to leave this word untranslated, as it forms a category of monumentality that is as difficult to translate as it is to define. There are several issues we have had to deal with during our field work that touch upon the practical problems of defining lapidars as a closed and coherent category.

First, on a formal level. Within Albanian monumental propaganda there appears to have been a hierarchy of monuments, starting with commemorative plaques and busts, then sculptures and lapidars, and finally sculptural

complexes and martyrs’ cemeteries. The precise definitions and criteria for these different types of monuments are not entirely clear, and the archival documents often enumerate a subset of them, followed now and then by an indefinite “etc.” Objects are also sometimes classified differently in different documents. That this situation is not particular to the textual tradition of the socialist period may be observed in the texts collected in this catalogue. Moreover, there are many hybrid monumental forms, in which busts or sculptural groups are combined with a lapidar element, lapidars or sculptural complexes in martyrs’ cemeteries, and bas-reliefs mounted onto or next to lapidars. The group of monuments documented during the fifty days of fieldwork in June and July 2014 generally consists of the larger monuments, that is, anything from the size of a lapidar and up; it was simply impossible to locate and photograph all busts and plaques as well within that limited timeframe.

Second, on the level of content. By and large, the lapidars and other documented monuments commemorate fallen partisans, specific battles, military units, or the achievements of socialist statecraft. Moreover, there are a few lapidars commemorating the battles of Skënderbeg and several other events that precede the National Anti-Fascist Liberation War.<sup>2</sup> We have chosen not to include any non-lapidar monument that commemorates an event preceding the National Anti-Fascist Liberation War, which therefore means that the Skënderbeg statues in Tiranë and Krujë are not documented. However, the survey did include the Monument for the Independence in Vlorë [ALS-460], as it in fact appears to effectively incorporate the form of a lapidar. This principle, as well as others that constrained the object of our investigation, sometimes emerged *ad hoc* “in the field,” and without the possibility of revisiting certain sites, may be considered subjective, and to some extent, it is. In general, the more remote and difficult to reach the monumental site was, the more we felt impelled to document it, even if not precisely fitting our preconceived categories, simply because no one knew who would visit next.

Third, on the temporal level. The majority of lapidars and other monuments were planned, built, restored, or

<sup>1</sup> Kujtim Buza, Kleant Dedi, Dhimitraq Trebicka (eds.), *Përmendore të heroizmit shqiptar* (Tiranë: Tipografi ushtarak “Ndërmarrje e Kulturës së lartë”, 1973). See also Valter Gjoni, *Gjurmime historike në parkun e madh të Tiranës* (Tiranë: West Point, 2012); Bardhyl Ylli, *Simbole të heroizmit në Skrapar* (Tiranë: Shtëpia botuese “8 Nëntori”, 1988).

<sup>2</sup> The qualification “Anti-Fascist” is not consistently present on all forms of socialist monumentality.

updated during the Cultural and Ideological Revolution. There are very few left that with certainty predate this period, and these have been included whenever we have been able to locate them. Notable examples are a lapidar on Qafë e Gjarpërit [ALS-237], a lapidar for the First Brigade near Vithkuq [ALS-148], a lapidar in Rehovë [ALS-275], and the curious constellation of two lapidars in Mashkullorë [ALS-378]. Although we have chosen to exclude those lapidars newly constructed after 1990 that do not clearly sustain the formal characteristics of earlier monumental forms, lapidars that have been restored, updated, or moved after their pre-1990 construction have been included, in spite of the fact that this has often led to loss of their original form or at least a rewriting of their inscription to suit the new post-socialist reality, for example by euphemistically referring to the martyrs of the National Anti-Fascist Liberation War as “martyrs fallen after 1939” [ALS-529]. Most lapidars therefore do not show a simple reference to a single historical event from the perspective of the communist regime, but incorporate the traces of post-socialist developments in political discourse. There are also a few monuments, such as Odhise Paskali’s *Luftëtar Kombëtar* (*National Warrior*) [ALS-123], that predate the National Anti-Fascist Liberation War.

All in all, this means that *Lapidari* offers a representative overview of the large majority of Albanian monumentality produced between 1945 and 1990. It does in no way aspire, nor could it have aspired, to be complete and all-inclusive; the extant archives are incomplete, lapidars and other monuments are not protected by the Albanian legal code, and many have been damaged, covered in (political) graffiti, destroyed, or moved. To trace the production and the different transformations of each of the objects that are gathered in these three volumes have undergone remains a task for future researchers, as well as the investigation into the collective memories that these objects have shaped. All too often, our field work felt like a drive-by shooting, recording the monument and its location, before darting off to the next one, onward across the seriously neglected Albanian secondary and tertiary road system.

Of the 659 locations surveyed, 651 have been indexed and 649 included with images in volumes 2 and 3.<sup>3</sup> The

following data were gathered for each location using a Garmin eTrex 20 GPS tracker: latitude, longitude, and elevation, as well as accessibility, type of location, type of monument, material, general condition, visible repaintings and restorations, graffiti, destruction, and whether the monument had been repurposed. All locations were also documented photographically using a Canon 5D camera with tilt/shift lens. Moreover, the entire documentation process itself was captured on photo and video.<sup>4</sup> Of the 651 documented sites, 96% contained a lapidar, 11% a bas-relief in concrete or bronze, and 6% of them contained specifically marked graves (including martyrs’ cemeteries). Busts, statues, sculptural groups, mosaics, and plaques all comprise less than 5% of the documented sites. Of all monuments, a majority of 79% is constructed using concrete, whereas 33% also utilizes carved stone or marble plaques. Bronze elements are visibly used in 8% of the cases, although it seems that many of the original bronze elements were removed after 1990 to be sold as scrap and/or smelted. This is for example the case with bronze bas-reliefs of the lapidar dedicated to the Artillery Forces in Sauk [ALS-13], and the lapidar dedicated to the Land Reform in Gorrë [ALS-324]. The same holds for bronze lettering, which is very often removed. Less than 1% of the monuments uses non-bronze metals.

In their governmental report “Disa probleme dhe masa për të ngritur me kritire më të drejta monumentet, përmendorët, bustet, lapidarët dhe pllakat përkujtimore” (“Several problems and measures to erect monuments, memorials, busts, lapidars, and commemorative plaques with the most correct criteria”) from 1970<sup>5</sup> and subsequent article in *Drita*, entitled “Dignified Symbols for Historic Events,”<sup>6</sup> Kujtim Buza and Kleanth Dedi remark that lapidars were showing a tendency to approach city centers and roads, instead of being erected on the locations pertaining to the events they commemorate. This observation seems to be confirmed by our findings. From the 651 documented sites, 55% was found inside or close to an agglomeration (village or city), 40% alongside roads, and only 5% in remote locations. Of these sites, 85% was easily accessible, whereas at least 11% required off-road vehicles, and an additional 4% extensive hikes due to the absence of any road whatsoever.

3 Two additional lapidars were located and documented, but not photographed, during the production of this book. Eight monuments that turned out to be post-1990 have not been included. Additionally, due to weather, road, or time conditions, the following suspected or confirmed locations could not be documented: Ballenjë (Bulqizë); Bashaj (Vlorë); Bënjë (Përmet); Çemicë (Korçë); Çikallesh (Kavajë); Fratar (Përmet); Godolesh (Elbasan); Kaçinar (Mirditë); Kuturman (Librazhd); Lavdar (Korçë); Laku i Dardhës (Kukës); Luaras (Kolonjë); Lis-Patros

(Kavajë); Orenjë (Librazhd); Panarit (Korçë); Protopapë (Korçë); Qafë e Martës (Skrapar); Steblevë (Librazhd); Surroj (Kukës); Shalë (Shkodër); Vërmik (Vlorë); Zikxhafaj (Kavajë). This list is by no means exhaustive.

4 See the documentation gathered on <http://albanianlapidarsurvey.tumblr.com> and <http://vimeo.com/channels/albanianlapidarsurvey> (Accessed December 15, 2014).

5 AQSH, f. 511 v. 1970 d. 86, pp. 2–22.

6 Kujtim Buza and Kleanth Dedi, *this volume*, pp. 45–8.

As regards the general condition of the monuments surveyed, about 27% seems to be in good to excellent condition, meaning that either their original form has been retained, or that they have been repainted or restored in a manner that is relatively respectful to the suspected original state of the monument. Nevertheless, in almost all cases, more invasive restoration attempts seem to have avoided conventional practices, often leading to what can only be judged to be the destruction of the monument, such as in the case of Thoma Thomai's restructured Skënderbeg Lapidar in Krujë [ALS-594] and the disastrous restoration attempt of the monument for the First Offensive Brigade in Pishkash [ALS-38], undertaken after it was documented during the Albanian Lapidar Survey. There are, however, exceptions, such as the lapidar in Topojan [ALS-566], which appears to have been restored in a way faithful to its original form and color scheme. Another 33% of the sites are in moderate to good condition, sometimes overpainted or with new, post-1990 plaques (41% of all monuments), or with visible graffiti (19% of all monuments). Most politically oriented graffiti is for the PD (Democratic Party, 3%) and LSI (Socialist Integration League, 1%). PS graffiti is nearly absent (Socialist Party, <1%). Of all monuments, 38% shows signs of destruction, such as the removal of bronze elements, the (partial) destruction of plaques, gunshot holes, complete destruction of parts of the monument, etc. Additionally nearly all lapidars have had their stars removed,<sup>7</sup> and 12% has been nearly or completely destroyed. About 1% of all monuments has been incorporated into recent structures, as parts of buildings or walls. Notable examples are the lapidar for Mine Peza in Tiranë [ALS-6] and a lapidar integrated into a house in Bardhac [ALS-563].

According to the list of monuments appended to the abovementioned report of Buza and Dedi,<sup>8</sup> the entirety of Albania contained 513 lapidars, whereas the Albanian Lapidar Survey has recorded 509 locations that feature only a lapidar, i.e., not in conjunction with a buste, sculpture, sculptural group, or cemetery. The following table shows all lapidars in 1970 and 2014, split out according to region.

REGION	1970	2014
Tropojë	15	19
Berat		22
Kuçovë	55	8
Dibër		31
Bulqizë	50	4
Durrës		3
Kavajë	14	8
Elbasan		17
Peqin	14	14
Ersekë	9	17
Fier		22
Mallakastër	18	17
Gjirokastër	38	28
Gramsh	10	9
Korçë		72
Devoll	22	27
Krujë		12
Kurbin	23	2
Kukës		17
Has	4	3
Librazhd	40	11
Lezhë	4	5
Lushnjë	13	22
Mirditë	21	6
Mat	7	10
Përmet	25	23
Pogradec	26	20
Pukë	7	9
Shkodër		20
Malësi e Madhe	10	6
Sarandë		15
Delvinë	9	5
Tepelenë	21	32
Vlorë	18	47
Skrapar	10	20
Tiranë	24	24

The difference in numbers is to be accounted for both by the construction of new lapidars between 1970 and 1990, and the continuous destruction and physical degradation of lapidars after 1990. For example, although the number of lapidars in the Tiranë region appears to be the same in 1970 and 2014, the lapidar of Misto Mame, which was inaugurated on August 16, 1969, has been destroyed to make way for a private parking space. Therefore the current number of monuments supposedly includes at least one erected after 1970. Due to lack reliable data between 1970 and 2014, it is impossible to arrive at any more detailed conclusions based on these numbers alone. One of our working hypotheses was that the lapidars and monuments in the north were in a worse state than the ones in the south of Albania, considering that the power base of the Communist Party, later the Labor Party of Albania was mainly in the Tosk speaking area of the country. This hypothesis seems to be confirmed by

<sup>7</sup> Due to its common occurrence, removal of the star has not been marked as destruction.

<sup>8</sup> AQSH, f. 511 v. 1970 d. 86, pp. 23–35.

our data: regions in which more than 60% of the lapidars is in a state between moderate and destroyed are all to be found in the northern half of Albania: Kurbin (100%), Mat (80%), Tropojë (70%), Kukës (65%), and Dibër (61%).

The first volume of this catalogue brings together a number of materials and reflections related to the Albanian monumental heritage from the period 1945–1990. It includes two texts selected from the National Archive, a newspaper article by Kujtim Buza and Kleant Dedi from 1971, and a contribution by the current Secretary of the Labor Party of Albania, Muharrem Xhafa, which provide a historical context for monumental production during the socialist regime. The contributions of art theorist Gëzim Qëndro, art historian Raino Isto, and historians Kostandinos Giakoumis and Chris Lockwood address specific monuments, respectively the Martyrs' Cemetery in Përmet with the sculptural group *Shokët (The Comrades)* by Odhise Paskali [ALS-244], the National Martyrs' Cemetery in Tiranë [ALS-12], and the lapidar dedicated to the First Offensive Brigade in Pishkash [ALS-38]. Finally, the texts by geographer Matthias Bickert, sociologist Julian Bejko, and semiotician Ardian Vehbiu attempt to place the monuments in a larger field of research on cultural landscapes, cultural production, and language acts. Beside this documentary and critical background, the first volume also includes a full overview of all monuments documented in the second and third volumes as well as a full index of names, places, dates, and military units, and party structures based on the indexation model of *Historia e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar (History of the National Anti-Fascist Liberation War of the Albanian People)*.<sup>9</sup>

The index of names includes all names present in inscriptions, including fallen partisans, war victims, patriotic figures, military leaders, and in a few cases private sponsors of the monuments. Often, partisan names occur on more than one inscription, being featured on for example the lapidar in their home village, the lapidar dedicated to their military unit, and the lapidar dedicated to the battle in which they were killed. For example, partisan Astrit Toto was from the Palorto neighborhood in Gjirokastër [ALS-392], served in the Battalion "Asim Zeneli" [ALS-379], and was killed near Manastir on October 2, 1943 [ALS-416].<sup>10</sup> I have tried to reduce the number of redundancies and duplicates, although only

a full cross-check with the extant archives will allow for a completely clean indexation.<sup>11</sup> Many names seem to have varying spellings on different inscriptions, and often it has been impossible to verify whether similar names refer to identical or different persons, owing to a lack of secondary sources. This problem is compounded by the fact that the difference between *c* and *ç* is not consistently made even on the same inscription, and the trema on *ë* is nearly always missing. I have corrected this in all inscriptions as far as I was able to reasonably verify. I have been able to distinguish about 4200 distinct names, although this number most certainly includes orthographical variants of the same name. Also it should be noted that this list does not include all partisans interred on martyrs' cemeteries, as the names in the index have only been gathered from inscriptions on plaques, and not from individual graves. Nevertheless, it gives us an indication of the order of magnitude of the number of partisans that died during National Liberation War.

The index of places includes all place names mentioned in inscriptions, including places of birth and death, battle grounds, provenance of military units, and lapidar locations.<sup>12</sup> The index of dates includes all dates on inscriptions, including dates of birth and death, the founding dates of military units and party structures, and dates referring to battles.<sup>13</sup> Finally, the index of military units and party structures refers to all organizational structures mentioned in inscriptions pertaining to the National Liberation War and the organization of the People's Republic of Albania thereafter. It should be evident that, taking into account the incompleteness or illegibility of many of the inscriptions, as well as the fact that not all extant inscriptions in Albania (including all commemorative plaques) were documented, this index may only serve as a starting point for further research.

The second and third volumes of the catalogue contain the photo documentation of all 651 locations, organized by GPS coordinates, from Dragobi in the north until Konispol in the south, with the halfway line running through Berat. We have explicitly chosen to accord each monument the same space, two images on a single page. Nearly all these monuments commemorate lost lives, lives lost for survival, adventure, an ideal, or simply a desire for the new. These lives, and the many others that were never commemorated in stone, deserve our insistent attention and care. Therefore, at the close of the 70th anniversary of Albania's liberation, I hope that

9 Instituti i Studimeve Marksiste–Leniniste pranë KQ të PPSh, *Historia e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*, 4 vols. (Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori," 1984–9).

10 Cf. Komiteti Kombëtar i Veteranëve të Luftës të Popullit Shqiptar në bashkëpunim me Komitetet e Veteranëve të Rretheve (ed.), *Yje të pashuar: Dëshmorë të Luftës Nacionalçlirimtare*, vol. 4 (Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori," n.d.), pp. 60–4.

11 Each name has been checked against all volumes containing biographical data of partisan martyrs that I could access. See for a full bibliography the Index of Names.

12 The orthography of place names in the index was standardized whenever possible.

13 Initial and final dates have been indexed separately.



this catalogue will contribute to a broader debate on the past, present, and perhaps even future meaning Albanian monumentality from the socialist period within Albania itself as well as within the international scholarly community at large.

– Tiranë & Singapore, 2014.



# Parathënie

Vincent W.J. van Gerven Oei

Në historinë e Shqipërisë, periudha midis viteve 1945–1990 dhe llojet e monumentalizmit që u prodhuan, janë më së shumti të palexueshme për ne sot. Shkak për këtë palexueshmëri, të paktën pjesërisht, është politizimi i trashëgimisë monumentale, në mos i gjithë historiografisë së kësaj periudhe, siç evidentohet ndër të tjera nga cilësimet e tipit: “socialiste”, “komuniste”, “diktatoriale”, “shkencore-staliniste”, “terroriste”, “totalitare” e kështu me rradhë, që lëshohen si predha mbi të kaluarën. Për pasojë, është krijuar një klimë mospërfilljeje kronike, në mos ndëshkimi e shkatërrimi të mirëfilltë, dhe janë hapur boshllëqe të ndryshme në traditën shkollare që merret me format e ndryshme të monumentalizmit në peizazhin kulturor shqiptar. Botimi i fundit kushtuar monumentalizmit shqiptar në tërësi, i titulluar *Përmendore të heroizmit shqiptar*, daton në 1973.<sup>1</sup> Ky album qe pjesë e fushatës që Sekretari i atëhershëm i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, Ramiz Alia, quajti “propaganda monumentale”, që konsiderohej një pjesë e rëndësishme e Revolucionit Ideologjik e Kulturor. Projekti “Hulumtim mbi Lapidarët e Shqipërisë” (“Albanian Lapidary Survey”, shkurt ALS) i Departamentit të Shqiponjave zhvilluar në 2014, ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë fillestare e të përgjithshme të monumentalizmit shqiptar të periudhës 1945–1990.

Siç evidentohet edhe nga titulli i këtij katalogu, qëllimi kryesor i këtij projekti qe dokumentimi i një forme monumentale që në shqip quhet *lapidar*, ndonëse siç do të shohim më poshtë u dokumentuan edhe forma të tjera. Kemi vendosur të mos e përkthejmë këtë fjalë në anglisht, pasi ajo i referohet një kategorie monumentalizmi që është po aq e vështirë për t’u përkthyer sa edhe për t’u përkufizuar. Dhe në të vërtetë, edhe gjatë punës në terren kemi hasur probleme të ndryshme që lidhen me vështirësitë praktike sa i përket përkufizimit të lapidarëve si një kategori e mbyllur dhe koherente.

Pikë së pari, në rrafshin formal. Duket se në propagandën monumentale të Shqipërisë, ka patur një hierarki monumentesh, duke filluar me pllakat dhe bustet,

ër të vijuar me skulpturat dhe lapidarët, e më pas komplekset skulpturore dhe varrezat e dëshmorëve. Përkufizimet dhe kriteret që përbushin apo duhet të përbushin monumente të llojeve të ndryshme nuk janë plotësisht të qarta, dhe në materialet arkivore shpesh herë hasim edhe nënbashkësi të tyre, që pasohen herë pas here nga një “etj.” e papërcaktuar. Gjithashtu, në disa raste, i njëjti objekt klasifikohet tjetërsoj në dokumenta të ndryshme. Kjo nuk përbën në vetvete një traditë të periudhës socialiste, siç evidentohet edhe nga tekste në këtë katalog. Për më tepër, ekzistojnë shumë forma monumentale hibride, ku bustet apo komplekset skulpturore kombinohen me një element lapidari, dhe lapidarët ose komplekset skulpturore në varrezat e dëshmorëve dhe bazoreliefet fiskohen mbi apo ngjitur me lapidarë. Gjatë pesëdhjetë ditëve të punës në terren në qershor dhe ko-rrik 2014, jemi përqëndruar tek monumentet e mëdha, që do të thotë gjithçka me përmasat e një lapidari e sipër; e patëm thjesht të pamundur të identifikojmë e të fotografojmë të gjitha bustet e pllakat brenda kohës së limituar që kishim në dispozicion.

Së dyti, në rrafshin e përmbajtjes. Në pjesën dërrmuese të rasteve, lapidarët dhe monumentet e tjera përkujtojnë partizanë të rënë, beteja të caktuara, njësi ushtarake, ose arritjet e ndërtimit të socializmit. Megjithatë, ka edhe disa lapidarë që përkujtojnë betejat e Skënderbeut si dhe ngjarje të tjera që paraprijnë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Kemi vendosur të mos përfshijmë asnjë monument që nuk mund të cilësohet si një lapidar dhe që i referohet një ngjarjeje që i paraprin Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare,<sup>2</sup> si për shembull statujat e Skënderbeut në Tiranë dhe në Krujë. Nga ana tjetër, kemi vendosur të përfshijmë Monumentin e Pavarësisë në Vlorë [ALS-460], pasi duket se përfshin formën e një lapidari. Ky kriter, si dhe kriteret e tjera që ngushtuan objektin e hulumtimit tonë, në disa raste lindën në mënyrë spontane gjatë punës në terren, dhe në pamundësi për t’iu rikthyer vendngjarjeve të caktuara, mund të konsiderohen subjektive, dhe deri në një farë pike janë të tilla. Në përgjithësi ama, sa më i largët e i vështirë për t’u arritur monumenti, aq më të nxitur e ndjemë veten për ta dokumentuar atë, edhe kur nuk

<sup>1</sup> Kujtim Buza, Kleant Dedi, Dhimitraq Trebicka (red.), *Përmendore të heroizmit shqiptar* (Tiranë: Tipografi ushtarak “Ndërmarrje e Kulturës së lartë”, 1973). Publikimet e tjera që u konsultuan përfshijnë: Valter Gjoni, *Gjurmime historike në parkun e madh të Tiranës* (Tiranë: West Point, 2012); Bardhyl Ylli, *Simbole të heroizmit në Skrapar* (Tiranë: Shtëpia botuese “8 Nëntori”, 1988).

<sup>2</sup> Jo çdo formë monumentalizmi e periudhës socialiste mund të cilësohet si “antifashiste”.

përshtatej plotësisht me kategoritë tona të paramenduar, vetëm për faktin se nuk dihej se kur dhe kush do të mund ta vizitonte sërish.

Së treti, në rrafshin kohor. Shumica e lapidarëve dhe monumenteve të tjera u planifikuan, ndërtuan, restauruan ose rinovuan gjatë Revolucionit Ideologjik dhe Kulturor. Shumë pak monumente kanë mbetur për të cilat mund të themi me siguri se i paraprijnë kësaj periudhe, dhe këto janë përfshirë sa herë që kemi arritur t'i gjejmë. Disa shembuj të spikatur janë lapidari në Qafën e Gjarprit [ALS-237], një lapidar kushtuar Brigadës së Parë afër Vithkuqit [ALS-148], një lapidar në Rehovë [ALS-275], dhe një grup i çuditshëm lapidarësh në Mashkullorë [ALS-378]. Ndonëse kemi vendosur të mos përfshijmë lapidarët që janë ndërtuar pas vitit 1990 që nuk kanë karakteristikat formale të formave monumentale të mëhershme, kemi përfshirë lapidarët e ndërtuar para vitit 1990 që janë restauruar, rinovuar ose zhvendosur pas ndryshimit të regjimit, pavarësisht se gjatë procesit ata kanë humbur shpesh herë formën e tyre origjinale ose u janë ndryshuar mbishkrimet në përputhje me realitetin e ri post-socialist, si për shembull në rastin e dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare që cilësohen si “dëshmorë të rënë pas vitit 1939” [ALS-529]. Kështu pra, shumica e lapidarëve nuk i referohen vetëm një ngjarjeje historike nga pikëpamja e regjimit komunist, por përfshijnë edhe gjurmët e zhvillimeve post-socialiste në ligjëratën politike. Shumë pak monumente, si për shembull *Luftëtar Kombëtar* i Odhise Paskalit [ALS-123], i paraprijnë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në tërësi, kjo nënkupton se lapidarët janë një formë përfaqësuese e monumentalizmit shqiptar prodhuar gjatë viteve 1945–1990. E megjithatë, ky projekt nuk pretendon, dhe nuk do të mund të pretendonte, se është tërësor dhe gjithëpërfshirës; arkivat ekzistuese nuk janë të plota, lapidarët dhe monumentet e tjera nuk mbrohen nga kodi ligjor shqiptar,<sup>3</sup> dhe shumë prej tyre janë dëmtuar, mbuluar me grafiti (me mesazhe politike), shkatërruar, ose zhvendosur. Ndjekja e gjurmëve të objekteve të përfshira në këto tri vëllime, duke filluar nga prodhimi i tyre e duke përfshirë çdo transformim që i janë nënshtruar, si dhe një studim i kujtimeve kolektive që këto objekte kanë formësuar, mbeten për t'u kryer nga studiues të tjerë në të ardhmen. Shumë shpesh gjatë punës tonë në terren, jemi detyruar të fotografojmë një monument e të përcaktojmë vendndodhjen e tij me shpejtësi para së të niseshim drejt monumentit ngjitur me të, përgjatë rrugëve dytësore e tretësore të braktisura të Shqipërisë.

Nga 659 vendndodhjet që kemi inspektuar, 651 janë

indeksuar dhe 649 janë përfshirë në imazhet në vëllimin e dytë dhe të tretë.<sup>4</sup> Në çdo rast, të dhënat e mëposhtme u mbledhën duke përdorur një Garmin eTrex 20 GPS Tracker: gjerësi, gjatësi, lartësi mbi nivelin e detit, si dhe aksesibilitet, lloji i vendndodhjes, lloji i monumentit, përbërja, kushtet e përgjithshme në të cilat ndodhet, restaurime dhe lyerje të dallueshme me sy të lirë, grafiti, shkatërrim, dhe nëse monumenti ishte përdorur për qëllime të tjera. Gjithashtu, të gjitha vendndodhjet u fotografuan me një kamera Canon 5D, me lente *tilt/shift*. Për më tepër, i gjithë procesi i dokumentimit u dokumentua me fotografi dhe video.<sup>5</sup> 96% e 651 vendndodhjeve të dokumentuara kishin një lapidar, 11% një bazorelief në çimento ose bronx, dhe 6% varre të shënuara posaçërisht (përfshirë varrezat e dëshmorëve). Bustet, statujat, grupet e statujave, mozaikët dhe pllakat përbëjnë së bashku më pak se 5% të vendndodhjeve të dokumentuara. Rreth 79% e të gjithë monumenteve janë në çimento, kurse në 33% të rasteve janë përdorur gur i gdhendur dhe pllaka mermeri. Elemente në bronx janë përdorur dukshëm në 8% të rasteve, ndonëse duket se shumë prej elementeve origjinale në bronx janë vjedhur pas vitit 1990 për skrap dhe/ose janë shkrirë. Një rast konkret është ai i bazoreliefve në bronx të lapidarit kushtuar Forcave të Artilerisë në Sauk [ALS-13], dhe të lapidarit kushtuar Dorëzimit të Tapive në Gorrë [ALS-324]. E njëjta gjë vlen edhe për mbishkrimet në bronx. Vetëm në më pak se 1% të rasteve janë përdorur metale të tjera.

Në raportin e tyre qeveritar “Disa probleme dhe masa për të ngritur me kritire më të drejta monumentet, përmendorët, bustet, lapidarët dhe pllakat përkujtimore” të 1970<sup>6</sup>, dhe artikullit vijues publikuar në gazetën *Drita* “Simbole dinjitoze ngjarjeve historike”, Kujtim Buza dhe Kleanth Dedi theksojnë se lapidarët në vend që të ngriheshin në vendet ku kishin ndodhur ngjarjet që shënonin po tregonin tendencën për t’iu afruar rrugëve dhe qendrave të qyteteve. Ky vrojtim mbështetet edhe

4 Kemi identifikuar dhe dokumentuar edhe dy lapidarë të tjerë gjatë prodhimit të këtij libri, por që nuk kemi arritur t'i fotografojmë dhe kësaj nuk janë përfshirë në këtë katalog. Tetë monumente të ndërtuara pas vitit 1990 nuk janë përfshirë. Gjithashtu, për arsye që kanë të bëjnë me kushtet atmosferike, të aksesibilitetit dhe të kohës së limituar në dispozicion, vendndodhjet e mëposhtme nuk janë dokumentuar: Ballenjë (Bulqizë); Bashaj (Vlorë); Bënjë (Përmet); Çemerice (Korçë); Çikallesh (Kavajë); Fratar (Përmet); Godolesh (Elbasan); Kaçinar (Mirditë); Kutturman (Librazhd); Lavdar (Korçë); Laku i Dardhës (Kukës); Lularas (Kolonjë); Lis-Patros (Kavajë); Orenjë (Librazhd); Panarit (Korçë); Protopapë (Korçë); Qafë e Martës (Skrapar); Steblevë (Librazhd); Surroj (Kukës); Shalë (Shkodër); Vermik (Vlorë); Zikxhafaj (Kavajë). Kjo listë nuk është përfundimtare.

5 Shih <http://albanianlapidarsurvey.tumblr.com> dhe <http://vimeo.com/channels/albanianlapidarsurvey>.

6 AQSH, f. 511 v. 1970 d. 86, f. 2–22.

7 Kujtim Buza and Kleanth Dedi, *ky vëllim*, f. 49–51.

nga të dhënat që ne kemi mbledhur. Nga 651 monumentet e dokumentuara, 55% ndodhen brenda ose pranë një fshati ose qyteti, 40% përgjatë rrugëve, dhe vetëm 5% në vende të largëta. Në 85% të rasteve, ato ishin lehtësisht të arritshme, kurse në 11% të rasteve mund të arriheshin vetëm me fuoristrade, dhe në 4% të rasteve mungesa e rrugëve të çfarëdo lloji bëri të nevojshëm marshimin me këmbë.

Sa i përket kushteve të përgjithshme të monumenteve të shqyrtuara, rreth 30% janë në gjendje të mirë e deri të shkëlqyeshme, që do të thotë se ato ende ruajnë formën e tyre origjinale, ose që janë rilyer apo restauruar në përputhje me gjendjen e tyre fillestare. Megjithatë, pothuajse në të gjitha rastet, përpjekje më invazive restaurimi duket se u janë shmangur praktikave konvencionale, si në rastin e Lapidarit të Skënderbeut në Krujë të Thoma Thomait [ALS-594] dhe atë të “restaurimit” skandaloz të Brigadës së Parë Sulmuese në Pishkash [ALS-38] që u krye pas përfundimit të Hulumtimit mbi Lapidarët e Shqipërisë. Ekzistojnë megjithatë përjashtime, si rasti i lapidarit në Topojan [ALS-566], që duket se është restauruar sipas formës dhe ngjyrave të tij origjinale. 33% e monumenteve janë në kushte mesatare e deri të mira, në disa raste të tejlyera ose me pllaka të post-1990 (41% e gjithë monumenteve), ose me grafiti të dallueshëm (19% e gjithë monumenteve). Në shumicën e rasteve, grafitit me përmbajtje politike i referohen PD (3%) dhe LSI (1%). Grafitit e PS-së janë thuajse inekzistente (<1%). 38% e të gjithë monumenteve tregojnë shenja shkatërrimi, si heqja e elementeve në bronx, shkatërrim të pjesshëm ose të plotë të pllakave, vrima plumbash, shkatërrim të pjesshëm ose të plotë të disa pjesëve të vetë monumentit, etj. Për më tepër, thuajse të gjithë lapidarëve u janë hequr yjet pjesë përbërëse e tyre<sup>8</sup>, dhe 12% janë shkatërruar thuajse tërësisht ose tërësisht. Rreth 1% e monumenteve janë përfshirë në struktura të ndërtuara rishtazi si pjesë ndërtesash ose muresh. Shembuj që spikasin janë lapidari i Mine Pezës në Tiranë [ALS-6] dhe një lapidar i integruar në një shtëpi në Bardhoc [ALS-563].

Bazuar në listën e monumenteve bashkëngjitur raportit të sipërpërmendur të Buzës dhe Dedit,<sup>9</sup> në vitin 1970 në Shqipëri gjendeshin 513 lapidarë. Gjatë studimit tonë kemi identifikuar 509 vendngjarje ku ka vetëm lapidarë, d.m.th. jo lapidarë së bashku me buste, skulptura, grupe skulpturash dhe varreza. Tabela e mëposhtme pasqyron të gjithë lapidarët në vitet 1970 dhe 2014 të ndarë sipas krahinave.

RRETH	1970	2014
Tropojë	15	19
Berat		22
Kuçovë	55	8
Dibër		31
Bulqizë	50	4
Durrës		3
Kavajë	14	8
Elbasan		17
Peqin	14	14
Ersekë	9	17
Fier		22
Mallakastër	18	17
Gjirokastër	38	28
Gramsh	10	9
Korçë		72
Devoll		27
Krujë		12
Kurbin	23	2
Kukës		17
Has	4	3
Librazhd	40	11
Lezhë	4	5
Lushnjë	13	22
Mirditë	21	6
Mat	7	10
Përmet	25	23
Pogradec	26	20
Pukë	7	9
Shkodër		20
Malësi e Madhe	10	6
Sarandë		15
Delvinë	9	5
Tepelenë	21	32
Vlorë	18	47
Skrapar	10	20
Tiranë	24	24

Diferenca mund t'i atribuohet si ndërtimit të lapidarëve të rinj gjatë periudhës 1970–1990, ashtu edhe shkatërrimit të vazhdueshëm dhe degradimit fizik të lapidarëve pas vitit 1990. Për shembull, ndonëse numri i lapidarëve në zonën e Tiranës është i njëjtë në vitet 1970 dhe 2014, lapidari i Misto Mames, që u inaugurua më 16 gusht 1969, është shkatërruar për t'i bërë vend një parkingu privat. Kësisoj, numri aktual i monumenteve përfshin të paktën një monument të ngritur pas vitit 1970. Fatkeqësisht, për shkak të mungesës së të dhënave mbi periudhën 1970–2014, është e pamundur të arrijmë në përfundime më të detajuara bazuar në këto shifra. Një nga hipotezat tona qe se lapidarët dhe monumentet në veri të Shqipërisë janë në gjendje më të keqe se ato në jug të Shqipërisë, duke pasur parasysh se baza e pushtetit të Partisë Komuniste, më pas të Partisë së Punës së Shqipërisë, qe në pjesën toske të vendit. Edhe kjo hipotezë mbështetet nga të dhënat që mblodhëm: krahinat ku

8 Për shkak të shpeshtësisë, heqja e yjeve nuk është cilësuar si shkatërrim.

9 AQSH, f. 511 v. 1970 d. 86, f. 23–35.

mbi 60% e lapidarëve janë në kushte nga të pranueshme deri të shkatërruar gjenden në gjysmën veriore të Shqipërisë: Kurbin (100%), Mat (80%), Tropojë (70%), Kukës (65%), dhe Dibër (61%).

Vëllimi i parë i këtij katalogu sjell një sërë materialesh dhe reflektimesh mbi trashëgiminë monumentale të Shqipërisë gjatë periudhës 1945–1990. Aty përfshihen dy tekste nga Arkivi Shtetëror, një artikull gazete i Kujtim Buzës dhe Kleanth Dedit i vitit 1970 dhe një kontribut nga Sekretari aktual i Partisë së Punës së Shqipërisë Muharrem Xhafa, që i japin një kontekst historik prodhimin të monumenteve gjatë regjimit socialist. Kontributet e historianëve të artit Gëzim Qëndro dhe Raino Isto, dhe të historianëve Kostandinos Giakoumis dhe Chris Lockwood, trajtojnë monumente të veçanta, më konkretisht, Varrezat e Dëshmorëve në Përmet dhe kompleksin skulpturor *Shokët* të Odhise Paskalit [ALS–244], Varrezat e Dëshmorëve në Tiranë [ALS–12], dhe lapidarin kushtuar Brigadës së Parë Sulmuese në Pishkash [ALS–38]. Kontributet e gjeografit Matthias Bickert, sociologut Julian Bejko dhe gjuhëtarit Ardian Vehbiu përipiqen t’i shqyrtojnë monumentet në kuadrin e një fushe më të gjerë kërkimi mbi peizazhet kulturore, prodhimin kulturor, dhe aktet gjuhësore. Përveç këtij sfondi dokumentar dhe kritik, vëllimi i parë përfshin gjithashtu një pasqyrë të përgjithshme të të gjitha monumenteve, të dokumentuara edhe në vëllimin e dytë dhe të tretë, si dhe një indeks të plotë të emrave, vendeve, datave dhe njësive ushtarake dhe strukturave partiake bazuar në modelin e indeksimit të *Historisë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*.<sup>10</sup>

Indeksi i emrave përfshin të gjithë emrat e përmendur në mbishkrime: ato të partizanëve të rënë, viktimave të luftës, figurave patriotike, prijësve ushtarakë, dhe në disa raste edhe të financuesve privatë të monumenteve në fjalë. Shpesh ndodh që emri i disa partizanëve të përmendet në më shumë se një mbishkrim: në lapidarin që ndodhet në fshatin e tyre të lindjes, në lapidarin kushtuar njësive të tyre ushtarake, dhe në lapidarin kushtuar betejës gjatë së cilës ata vdiqën. Për shembull, partizani Astrit Toto ishte nga lagjja e Palortos në Gjirokastrë [ALS–392], luftoi në batalionin “Asim Zenebi” [ALS–379], dhe u vra afër Manastirit në 2 tetor 1943 [ALS–416].<sup>11</sup> Ndonëse jam përpjekur ta reduktoj numrin e dublikatave e të përsëritjeve sa më shumë, vetëm një verifikim i plotë krahas arkivave ekzistuese do të bënte

të mundur një indeksim të pastër.<sup>12</sup> Gjithashtu, shumë prej emrave duket se janë shqiptuar ndryshe në mbishkrime të ndryshme, dhe shumë shpesh ka qenë e pamundur për ne të verifikojmë nëse emra të ngjashëm i referohen të njëjtit person apo personave të ndryshëm për shkak të mungesës së burimeve dytësore. Ky problem ndërlikohet edhe më tej prej faktit se në shumë raste autorët nuk i janë përmbytur dallimit midis shkronjave *c* dhe *ç* as brenda të njëjtit mbishkrim, dhe pikat mbi shkronjën *ë* mungojnë thuajse gjithmonë. E kam korrigjuar këtë në çdo rast që kam mundur të vërtetoj se ka patur një gabim. Kam arritur të evidentoj rreth 4200 emra të veçantë, ndonëse me shumë gjasa tek kjo shifër përfshihen edhe variante të ndryshme ortografike të të njëjtit emër. Duhet theksuar gjithashtu se kjo listë nuk përfshin emrat e të gjithë partizanëve në varrezat e dëshmorëve, pasi emrat në këtë listë janë mbledhur vetëm nga mbishkrimet mbi pllaka dhe jo nga ato mbi varreza individuale. Megjithatë, kjo listë na jep një ide rreth numrit të partizanëve që vdiqën gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

Indeksi i vendngjarjeve përfshin emrat e vendeve të përmendura në mbishkrime: vendin e lindjes dhe atë të vdekjes, fushat e betejës, prejardhjen e njësive ushtarake, dhe vendndodhjet e lapidarëve.<sup>13</sup> Indeksi i datave përfshin të gjitha datat e përmendura në mbishkrime: datat e lindjes e të vdekjes, datat e themelimit të njësive ushtarake e strukturave partiake, dhe datat e betejave të ndryshme.<sup>14</sup> Së fundmi, indeksi i njësive ushtarake dhe strukturave partiake përfshin të gjitha strukturat organizative që përmenden në mbishkrimet që lidhen me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe ndërtimin më pas të Republikës Popullore të Shqipërisë. Besoj është e qartë se, duke marrë parasysh paplotësinë dhe palexueshmërinë e shumë mbishkrimeve, si dhe faktin se jo të gjitha mbishkrimet në Shqipëri u dokumentuan, ky indeks shërben vetëm si një pikënisje për hulumtime të mëtejshme.

Vëllimi i dytë e i tretë i këtij katalogu përmbajnë fotografit të 651 vendndodhjeve, të organizuara sipas koordinatave GPS, nga Dragobi në veri e deri tek Konispoli në jug, me Berat në mes. Kemi vendosur qëllimisht t’i japim çdo monumenti të njëjtën hapësirë, dy imazhe në një faqe. Pothuajse të gjitha monumentet përkujtojnë jetë të humbura, jetë të humbura për mbijetesë, aventura, ideale, apo thjesht për dëshirën për të rënë. Këto jetë, dhe shumë të tjera që asnjëherë nuk u përkujtuan

10 Instituti i Studimeve Marksiste–Leniniste pranë KQ të PPSH, Historia e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, 4 vol. (Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori,” 1984–9).

11 Shih Komiteti Kombëtar i Veteranëve të Luftës të Popullit Shqiptar në bashkëpunim me Komitetet e Veteranëve të Rretheve (red.), *Yje të pashuar: Dëshmorë të Luftës Nacionalçlirimtare*, vëll. 4 (Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori,” n.d.), f. 60–4.

12 Kam verifikuar çdo emër krahas të gjitha vëllimeve me të dhëna biografike mbi dëshmorët partizanë që kam arritur të gjej. Për një bibliografi të plotë shih Treguesin e Emrave.

13 Ortografia e emrave të vendeve në tregues është standardizuar në çdo rast që kjo ishte e mundur.

14 Datat e fillimit dhe ato të fundit janë indeksuar veçmas.



në gur, meritojnë vëmendjen dhe kujdesin tonë. Kështu pra, në përfundim të përvjetorit të 70 të çlirimit të Shqipërisë, shpresoj që ky katalog do të kontribuojë për një debat më të gjerë mbi domethënien e kaluar, të tashme dhe ndoshta edhe të ardhme të monumentalizmit shqiptar të periudhës socialiste brenda Shqipërisë si dhe në komunitetin shkollor në mbarë botën.

– Tiranë & Singapor, 2014.



# Circular to the Prefectural Executive Committee (Section Education): Regarding Lapidars

People's Republic of Albania, Ministry of Education, Directorate of Culture

Our National Liberation War has truly been a war of the masses, such that there is no village, neighborhood, and road left where it did not leave its traces.<sup>1</sup> It is our duty that they immortalize this holy and heroic war of our people. We have to realize that each traveller, wherever he may pass, may say: "Here has been fought."

How to make sure that our people and especially the future generations may forever consider the large sacrifices with which the freedom that we enjoy was won?

In the first place we have to immortalize the hundreds and thousands of names of our martyrs. Our government will directly take care of this and has to give all its assistance to the initiative of the people and organizations in this direction.

This Ministry thinks that at the initiative of the Prefectural Section of Education and the Subprefectural Sections of Education commemorative signs in the form of lapidars are to be erected, in all places where martyrs have fallen. Similar lapidars, but larger in form, are to be erected in the places where our battles have been waged.

These lapidars feature the martyr's name, date of birth, date of death, and possibly also some other characteristics. For the lapidars on battle fields the plaque features the place name, army unit, the number of fallen martyrs, etc.

The material taken from destruction of the lapidars that fascism has left in our country is to be used for the construction of these lapidars.

For the erection of the lapidars attention is to be paid to differentiate between those that have fallen as martyrs and those that have been killed accidentally by some mortar or in a different way, but without having taking part in the war.

The Clerk of Culture should compile a list of places where martyrs have fallen or battles have been waged, where lapidars will be erected, starting with the most important ones.

---

<sup>1</sup> AQSH, f. 511 v. 1946 d. 43, p. 1, dated August 6, 1946.



# Qarkore komitetit ekzekutiv të prefekturës (seksionit t’Arsimit): Mbi lapidarët

Republika Popullore e Shqipërisë, Ministrija e Arsimit, Drejtorija e Kulturës

Lufta e jonë Nacional-Çlirimtare ka qënë me të vërtetë një luftë masash, sa s’ka mbetur katund, lagje dhe rrugë ku të mos ketë lënë gjurmat e saj.<sup>1</sup> Është detyra e jonë që këtë luftë të shënjtë dhe heroike të popullit t’onë t’a përjetësojnë. Ne duhet të bëjmë që çdo udhtar, nga çdo vënd që të kalojë, të thotë: “Këtu është luftuar”.

Të bëjmë që populli i jonë e sidomos brezat e ardhshëm të kenë gjithnjë përparasysh sakrificat e mbëdha me të cilat u fitua liria që gëzojmë?

Ne duhet të bëjmë të pavdekshme në radhë të parë emrat e qindra e mija dëshmorëve t’onë. Pushteti i jonë do të interesohet direkt për këtë dhe duhet t’u japi gjithë ndihmën e tij inisjativës së popullit dhe të organizatave në këtë drejtim.

Kjo Ministri mendon që me inisiativën e Seksionit t’Arsimit të Prefekturës dhe Seksioneve t’Arsimit në N/Prefekturat të ngrihen shënja kujtimi në formë lapidari; në të gjitha vëndet ku kanë rënë dëshmorë. Lapidarë të tillë, po me një formë më të madhe, të ngrihen në vëndet ku janë zhvilluar lufetërat t’ona.

Në këto lapidarë shënohet emri i dëshmorit, data e lindjes, data e vrasjes, mundësisht edhe ndonjë shënim tjetër karakteristik. Për vëndet e luftimeve shënohen në një pllakë emri i vëndit, njësitit luftues, sa dëshmorë kanë rënë etj.

Si material për ngritjen e këtyre lapidarëve të përdoret edhe ay që do të nxirret nga prishja e lapidarëve që ka lënë fashizmi në vëndin t’onë.

Për ngritjen e lapidarëve të kihet kujdes dhe të bëhet dallimi për ata që kanë rënë dëshmorë dhe ata që rasisht janë vvarë nga ndonjë mortaj ose në një mënyrë tjetër, por pa qënë në luftë.

Referenti i Kulturës duhet të përpilojë një listë të vëndeve ku kanë rënë dëshmorë ose janë zhvilluar luftime, në të secilës do të bëhet ngritja e lapidarëve, duke filluar nga më të rëndësishmet.

<sup>1</sup> AQSH, f. 511 v. 1946 d. 43, fl. 1, me datë 6 gusht 1946.



# Report on the State and Measures for the Development and Further Revolutionization of Monumental Propaganda

Ramiz Alia

With the continuous care of the party and government for the preservation and further development of the patriotic and revolutionary traditions of our people, monumental propaganda acquires with us increasingly broader proportions for the immortalization of the most important events and figures, and is transforming into a powerful instrument for the reflection of the glorious history of our people and for the revolutionary and class education of the masses.<sup>1</sup> Nowadays, beside the placement of hundreds of commemorative plaques, dozens upon dozens of lapidars, busts, statues, and monuments have been erected everywhere, reminding the traveller and visitor that the Albanian, as comrade Enver has said, has – sword in hand – cut the road of history in two, and that Albania has turned into a country of lapidars and construction sites.

Especially during the last years monumental propaganda has not been developing badly. Partial data show that, except for the naming of 2900 institutions, cities, cooperatives, military wards, roads, and squares with names of persons and historical events, only after the liberation more than 12 monuments, 145 busts, and 590 lapidars have been erected, and 530 commemorative plaques have been placed.

The places where objects of monumental propaganda have been placed have become the most effective centers for patriotic and revolutionary education of the masses, especially of the young generation. They are used by the party and mass organizations, and especially on the occasion of celebrations and anniversaries, as centers for the organization of a range of mass-political activities such as conversations, excursions, admission to the pioneer and youth organizations, etc.

The organization of various activities near objects of monumental propaganda has inspired deep political emotions in the consciousness of the participants, which has contributed to the growth of the love of the masses for the work of the party. At the same time this

shows the extensive militant role played by busts, monuments, lapidars, and other objects of monumental propaganda in the ideo-political and emotional education of the masses with the spirit of the party and the revolutionary and military traditions of our people.

Starting from these factors and with the aim of strengthening and further improving the educational and political role and level of monumental propaganda as a tool that is in continuous contact with the masses, the organizations of the party, its levers, and all other pertinent organs are faced with the duty to understand well and treat correctly the importance and militant effect of this powerful weapon in the hand of the party. There still remains much to be done in this direction.

What are actually the main problems that need to be addressed?

## 1

The issue of the erection and placement of monumental propaganda objects with the most correct political criteria is of special importance. To this aim, the Politburo of the Central Committee of the PPSH [Labor Party of Albania – trans.] has issued on August 8, 1961, a special decree “About the Criteria for the Erection of Monuments, Statues, Busts, and the Naming of Various Institutions.” Nevertheless, this decree, which provides clear and precise outlines of the political criteria and the way of placing monumental propaganda objects, has neither been adopted as it should nor has it always been considered by the party committees and pertinent organs. In a few regions there are cases showing ignorance about the criteria decided upon of local initiatives (for issues that are not their competencies) for the erection of 2–4 busts for some outstanding figures such as Mustafa Matohiti, Gjok Doçi, Kajo Karafili, Ali Demi, Avni Rustemi, and others, whereas for some other figures and important persons from the patriotic movements, from the National Liberation War, or from the post-liberation period, there is no bust at all. So, for example, until today

<sup>1</sup> AQSH, f. 511 v. 1968 d. 27, pp. 2-12, dated February 1, 1968.

no busts have been erected in public for indispensable figures such as Qerime Galica (Shota), Ded Gjo Luli, Naum Veqilharxhi, Hasan Prishtina, Alqi Kondi, Baba Faja, and others.

This doesn't mean that in the future no more than one bust will be erected for some outstanding figures. At issue here is to be more principled and careful in the precise implementation of the criteria, to correctly value the contribution of each important person in the service of the people and party. This problem has to be seen and treated with a political eye, lest we risk falling into subjectivism, err in the right appreciation of phenomena, arouse bad feelings, and as a result damage the party line in this field. Therefore, it is necessary to think about and work on this important problem according to the orientations of the party, in a programmatic way, based on studies that are serious and offer perspective.

Truly, good work in the placement of different monumental propaganda objects has been done from the liberation onward, and with a thematics that was to a certain extent well studied.

It is a positive fact that many places have been determined and demarcated that are of interest for the history and traditions of our people, although in the field there are still many unknown spots that, without losing time, need to be discovered, recognized, and for now demarcated.

This has to be seen also with regard to the issue of the division of monumental propaganda objects, because their distribution and placement, from the simplest objects to the most complex ones, has not always been done following correct criteria. So for example, while more than 70 lapidars have been erected in several regions such as Korçë and Vlorë, in several other regions such as Librazhd, Gramsh, and Pogradec there are no more than 5–10 or 15 lapidars. Just like the placement of other objects, the erection of lapidars is of course determined by the events that happened in one or the other region. But this has also to do with the insufficient political care and appreciation shown for this problem by the party committees and pertinent organs of local government.

This flaw is also to a certain extent noticed in the division and placement of large objects of monumental propaganda, whose situation can be presented as follows:

- 28 busts erected for important historical figures from before 1939;
- 77 busts erected for the heroes and martyrs of the National Liberation War;
- 25 busts erected for the classic figures of Marxism–Leninism and comrade Enver;
- 16 monuments erected in 10 regions for those three

divisions, including those that have been placed before the liberation.

The above data show that the distribution of the large monumental propaganda objects according to the regions and periods is, as is also shown below, irregular, because there are important cities such as Durrës, Fier, or Lushnjë that do not have any monument. But there are also regions such as Gramsh and Librazhd that have not placed any bust.

As regards the thematics of those objects, it is mainly dedicated to historical events, patriots, heroes, and martyrs of the National Liberation War, border guards, and martyrs that have fallen in struggles with groups of saboteurs. In the large genre of monumental propaganda represented through monuments and sculptural complexes, beside the monuments of Skënderbeg (in the city and the “Stalin” Textile Combines in Tiranë) and of comrade Enver (at the United School), 5 monuments and sculptural complexes have been erected like the one of the first cooperative (in Krutje) [ALS–327], of the martyrs of the National Liberation War (in Përmet) [ALS–244], of the Partisan (in Tiranë) [ALS–1], etc., that symbolize events from the heroic past and present of our people. As such, the thematics of the large genre of monumental propaganda in the field of sculpture is still limited.

1. There are quite a few complexes missing that reflect the most important aspects of the great epic of the National Liberation War, and especially those in which the heroism of our current days is reflected and monuments that treat and generalize the work of the party. (To this end the Ministry of Culture has drafted a 15-year project.)
2. The state related to the representation of the thematics that pertains to the treatment of the Albanian woman is very unsatisfactory. In this direction, except for the bust of Zoja Çurre in Tragjas and Shejnase Juka in Shkodër, there is a total lack of objects that are dedicated to the memory of women in our cities and especially in the large cities where different monumental propaganda objects have been erected by the dozen. Therefore, in the future the thematics and treatment of the work and the figure of the Albanian woman in all types of objects of monumental propaganda remains to be represented. For now we think of taking urgent measures to erect busts of women and girls who have been declared heroines, and to gradually place memorials, and where possible, plaster and cement statues in parks, public gardens, and other places that symbolize the figure of the Albanian woman as a warrior that has played an important role in all periods of our people's



history.

3. Beside the representation of this theme it is necessary that more monumental propaganda objects are placed that treat the revolutionary activity of our children and pioneers, both of whom yesterday in the war and today in the construction of socialism have stood and stand side by side with their parents.
4. At the same time the gaps concerning the disappearance of the limitation in the thematics of memorials that are dedicated to events before 1939 or that have to do with names of persons or events of our days are to be filled. Especially in monumental propaganda we perform poorly in the representation of the theme of class struggle. Therefore the treatment of the role of the masses as moving force is to occupy a key place in this field, highlighting not only the struggle for national liberation, for the building of socialism and the victories that were won, but also for the struggle for social liberation waged by the masses in our country. This is to be represented through the placement of sculptural complexes, panels, murals, and other genres of this profile.
5. Special attention is to be dedicated to the erection of different monumental propaganda objects relating to the representation of current thematics, especially the revolutionary initiatives of our times that have exploded everywhere in our country, where in a special way the role and works of the masses for the further deepening of the ideological and cultural revolution catches the eye.

Another important problem that is related to the political and educational effect of monumental propaganda objects is the issue of their all-round presentation. Considering these objects from this point of view has as a result that in some them there is a lack in effort at national originality, and that some others are such that they do not attract and inspire respect in the visitor.

Quite a few monumental propaganda objects, especially lapidars, commemorative plaques, and an occasional bust have been planned and placed badly. The majority of lapidars has been built the same, with bricks and ugly plastering, without any decorative motive or chiselled basrelief, and nearly all suffer from uniformity. With a few exceptions, the lapidars that commemorate the ancient past and those that commemorate the National Liberation War or the building of socialism are indistinguishable. What is meant is that each epoch has its own characteristic motives. From the other side there are lapidars that do not correspond to the aim for which they were erected, because they do not symbolize concrete events or actions. There are even lapidars that in fact are dedicated to the memory of specific martyrs,

but which in reality are not recognized by the visitor because they have no inscription.

The inscriptions on a considerable part of monumental propaganda objects are not striking. The inscriptions suffer from a lack of emotional and political content and as such leave no impression in the visitor's memory. The inscriptions are often lengthy, badly written, and with mistakes. On many objects they have become illegible and on several others they have been destroyed.

This situation speaks for the little care that still is shown for the maintenance of monumental propaganda objects to the extent that in a few cases some of them have been completely destroyed. This carelessness is also noticed in the maintenance of objects from strong materials, such as important monuments and busts, which are painted by incompetent workers of municipal organs. As a result, some of the outstanding figures are damaged and are losing their characteristics. Therefore, except the serious measures that will be taken by the pertinent organs in this direction, starting from the general presentation of those objects until the systematization and decoration of the surroundings, it is necessary that the issue of the maintenance of monumental propaganda objects is made the opinion and education of all masses and especially the new generation.

To this occasion concrete actions can be undertaken by the front and youth organizations by considering them as a factor in the revolutionary education of the masses. The actions that will be taken in this field are to serve, beside the restoration and maintenance of existing monumental propaganda objects, also the erection of new objects that are related to the most marked events of our people, foremost with those events that represent the theme of the National Liberation War, the appreciation of the theme of the building of socialism and of the deepening of the ideological and cultural revolution.

## 2

It is known that monumental propaganda is not made solely from several specific genres, such as lapidars, busts, or sculptural complexes. Those are just some of its types. The issue is to fully awaken all other components of this branch of party propaganda, from slogans and banners to panels and murals of different types.

To make the role of monumental propaganda in the meanwhile more militant, the time has come to take measures for the development of several more effective artistic genres, such as the placement of basreliefs, different types of statues in parks, panels, murals, and so on. In the first place they need to be placed in those cafeterias, halls, theaters, work centers, military wards, squares, or public gardens that are frequented most by the masses.

On the other hand, the Ministry of Construction and its planning organs, in consultation with the Ministry of Education and Culture as well as the League of Writers and Artists, is to keep in mind prospective special locations for the most important works that will be built after, where eventually monumental propaganda objects can be placed.

The work for settling these issues not only needs to be closely connected to the need for the further revolutionarization of monumental propaganda, but at the same time serves to obliterate all foreign influence of feudo-bourgeois and religious ideology that we inherit in this field from the past and that in one or the other form is active in the conscience of the masses. It is clear that we are speaking about the final obliteration or confiscation – on a case by case basis – of those objects (such as crosses, statues, etc.) that have a religious content and that are still placed here and there. On the other side, paintings that are made with an inadequate ideo-artistic taste and content are to be removed from bars, restaurants, train stations, etc. and gradually replaced with artistic works prescribed by the current spirit. Similarly, all products (cushions, embroidered pictures, etc.) with bad content that are put out on the art market are to be recalled.

Parallel to the work for the further development of monumental propaganda, the issue of the systematic utilization of the objects of that propaganda for the continuous education of the masses acquires special importance. Until now, different activities have been organized in the places where those objects have been placed, but nevertheless the sporadic organization of those activities (only in the case of campaigns) shows that the usage of monumental propaganda objects is still not understood as a necessary requirement that contributes to the knowledge and appropriation of the revolutionary history and traditions of the people. This is the source of the limited and unattractive forms that are practiced as regards the utilization of monumental propaganda objects for the universal communist education of the masses, especially the youth. We are not speaking here of giving recipes about what forms and activities can be practiced afterward for the revolutionary education of the masses by means of lapidars, busts, monuments, etc. Each organization, work center, school, or military ward may solve this issue according to the conditions and possibilities it has, by applying various forms, from those the common ones to the military oath, the organization of concerts with revolutionary songs and poetry, the handing over of flags, etc., near monumental propaganda objects. What is important is that we systematize the work for the education of the masses on the side of

monumental propaganda and that we closely connect it to the aim of the Marxist–Leninist ideological tempering of our new man.

To improve the situation and to give a stronger impetus to the development of monumental propaganda, we also propose the following measures:

1. At the occasion of the celebration of the large 25th anniversary of the liberation of the Fatherland a broad national campaign is to be announced for lapidars and other monumental propaganda objects, in two directions:
  - a. Restoration and improvement of existing objects.
  - b. Placement of new objects.

To this end, the Ministry of Education and Culture, in cooperation with local organs, is to take measures that within the most feasible deadline all lapidars that are positioned along national roads are covered in marble, and that at the same time inadequate lapidars are replaced.

From the other side, the Ministry of Education and Culture is to make prototypes (several variants) of lapidars that will be erected, keeping in mind the fact that each prototype contains the characteristic motifs of specific epochs from our people's history.

2. Beside the different monumental propaganda objects that will be erected to commemorate the important events of the history and work of the party and our people from the great epic of the National Liberation War and the construction of socialism, in the framework of the 25th jubileum of the liberation of the Fatherland thematical monuments and sculptural complexes are to be placed treating several of the most marked events of the class struggle waged by the popular masses for social liberation, highlighting the role of mass heroism.

Special care is to be given notably to the placement of different monumental propaganda objects (panels, murals, sculptural complexes, etc.) that represent the mobilization of the masses and their massive heroism in the struggle for the realization of revolutionary initiatives that have erupted everywhere in our country, as well as for their work for the further deepening of the ideological and cultural revolution.

In the way that the large needs that are presented in this field are to be confronted, as well as for the planning of lapidars and other memorials, the Ministry of Education and Culture, beside the engagement of sculptures and architects, is to instruct the State University of Tirana and the Higher Institute of the Arts that in their education requirements the students of the Department of Figurative Arts and

those of the Faculty of Engineering are charged with the work to do projects of sculptural complexes, lapidars, and other monumental propaganda objects that are related to the representation of aforementioned thematics.

3. In the framework of the campaign for the improvement of the state and further development of monumental propaganda, no event is to remain without being commemorated and fixated in some monumental propaganda object, no matter how simple. On this occasion commemorative plaques are to be placed on each object where labor groups have been founded, schools, etc., so that they carry the names of martyrs or events.
4. All party committees and other pertinent organs are to study the state of monumental propaganda and to determine concretely the duties that follow from them for the solution of this problem. Special committees are to be formed for this issue.
5. To impose a better discipline on the issue of the placement of monumental propaganda objects, those objects that are under the nomenclature of the regions themselves are not to be erected without their project being seen and consulted with the masses and commissions.
6. All monumental propaganda objects are to be registered and identified and to be placed in the full care of the executive committees and local museums.
7. With the start of the campaign for the regulation of the situation and the further development of monumental propaganda there is to be written time after time in the central and local press.
8. On the threshold of the 25th anniversary of the liberation of the Fatherland, Publishing House "Naim Frashëri" is to bring out an album with the most beautiful artworks of monumental propaganda.

We think that the concrete determination of the masses for the further strengthening of the role of monumental propaganda becomes more necessary, especially at this moment when the ideological and culture revolution has entered in a new phase of development.



# Relacion: Mbi gjendjen dhe masat për zhvillimin dhe revolucionarizimin e mëtejshëm të propagandës monumentale

Ramiz Alia

Me kujdesin e vazhdueshëm të partisë dhe qeverisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të traditave patriotike e revolucionare të popullit tonë, për përjetësimin e ngjarjeve dhe figurave më të rëndësishme, tek ne, gjithnjë e më shumë, propaganda monumentale po merr përpjestime të gjëra dhe po shndërrohet në një mjet të fuqishëm për pasqyrimin e historisë së lavdishme të popullit tonë dhe për edukimin revolucionar e klasor të masave.<sup>1</sup> Tani kudo, krahas vendosjes të qindra pllakave përkujtimore, janë ngritur dhjetra e dhjetra lapidarë, buste, statuje e monumente që i kujtojnë udhëtarit e visitorit, se shqiptari, siç ka thënë shoku Enver, e ka qarë me shpatë në dorë rrugën e historisë, se Shqipëria është kthyer në një vend lapidarësh dhe kantieresh.

Propaganda monumentale, sidomos vitet e fundit është zhvilluar jo keq. Nga të dhënat e pjesëshme rezulton, se përveç emërtimit të 2900 institucioneve, qyteteve, kooperative, reparteve ushtarake, rrugëve e shesheve me emra personash e ngjarjesh historike; vetëm pas çlirimit janë ngritur mbi 12 monumente, 145 buste, 590 lapidare si dhe janë vendosur 530 pllaka përkujtimore.

Vendet ku janë vendosur objektet e propagandës monumentale janë bërë qendrat më efektive të edukimit patriotik e revolucionar të masave, veçanërisht të brezit të ri. Ato janë përdorur nga partia dhe organizatat e masave, e në mënyrë të veçantë me raste festash e ditësh jubilarë, si qendra për organizimin e një varg aktiviteteve politike masive si: biseda, eskursione, pranime në organizatën e pionierit, të rinisë, etj.

Organizimi i aktiviteteve të shumëllojshme pranë objekteve të propagandës monumentale ka ngjallur emocione të thella politike në ndërgjegjen e pjesëmarrësve, fakt ky që ka ndikuar për shtimin e dashurisë së masave ndaj veprës së partisë. Ndërkohë kjo tregon për rolin e madh militues që luajnë bustet, monumentet, lapidarët dhe objektet e tjera të propagandës monumentale në edukimin ideo-politik dhe emocional të masave me frymën e partisë dhe traditat revolucionare e luftarake

të popullit tonë.

Duke u nisur nga këto faktorë dhe me qëllim që të forcojmë e të ngrejme më tej rolin dhe nivelin edukativ e politik të propagandës monumentale, si një mjet që është në kontakt të vazhdueshëm me masat, përpara organizatave të partisë, levave të sajë dhe gjithë organeve të tjera përkatëse, shtrohet detyra që ato të kuptojnë mirë e të trajtojnë drejt rëndësinë dhe efektin militues të kësaj arme të fuqishme në dorën e partisë. Në këtë drejtim na mbetet ende shumë për të bërë.

Cilat janë aktualisht problemat kryesore ku duhet përqëndruar vëmëndja?

## 1

Rëndësi të veçantë ka çeshtja e ngritjes dhe e vendosjes me kriter më të drejtë politik të objekteve të propagandës monumentale. Për këtë qëllim Byroja Politike e Komitetit Qëndror të PPSH që më 28.8.1961 ka nxjerrë një vendim të posaçëm: “Mbi kriterët për ngritjen e monumenteve, statujëve, busteve dhe emërtimin e institucioneve të ndryshme”. Mirëpo ky vendim, në të cilin janë përcaktuar me qartësi e saktësi kriteret politike dhe mënyra e vendosjes të objekteve të propagandës monumentale, nuk është përvehtësuar si duhet dhe as që është mbajtur gjithmonë parasysh nga komitetet e partisë dhe organet përkatëse. Ka raste që disa rrethe, duke mos i njohur kriteret e vendosura, me inisiativa lokale (për çeshtje që s’janë kompetencat e tyre) për disa figura të shquara si: Mustafa Matohiti, Gjok Doçi, Kajo Karafili, Ali Demi, Avni Rustemi e tjerë të kenë ngritur 2–4 buste, kurse për disa figura të tjera dhe persona të rëndësishëm të lëvizjeve patriotike, të Luftës Nacional–Çlirimtare, ose të periudhës së pas çlirimit të mos ketë asnjë bust. Kështu p.sh. deri më sot nuk janë ngritur buste në natyrë për figura të domosdoshme si Qerime Galica (Shota), Ded Gjo Luli, Naum Veqilharxhi, Hasan Prishtina, Alqi Kondi, Baba Faja e tjerë.

Këtu nuk është fjala për të thënë, që për disa figura të shquara nuk do të ngrihen edhe në të ardhmen më tepër

<sup>1</sup> AQSH, f.5 11 v. 1968 d. 27, fl. 2-12, me datë 1 shkurt 1968.

se një bust. Çeshtja është për të qenë më parimore dhe të kujdesëshëm në zbatimin e përpiktë të kriterëve, për të vlerësuar drejt kontributin e çdo personi të rëndësishëm në shërbim të popullit dhe partisë. Ky problem do parë dhe trajtuar me syrin politik, ndryshe mund të biem në subjektivizëm, të gabojmë në vlerësimin e drejtë të fenomeneve, të nxisim ndjenja jo të mira e për pasojë të dëmtojmë vijën e partisë në këtë fushë. Prandaj për këtë problem të rëndësishëm do menduar e vepruar sipas orientimeve të partisë, në mënyrë të planifikuar e në bazë të studimeve serioze e me perspektivë.

Në të vërtetë që nga çlirimi e këtij është bërë një punë e mirë dhe me tematikë deri diku të studjuar në vendosjen e objekteve të ndryshme të propagandës monumentale.

Është pozitiv fakti që janë përcaktuar dhe piketuar shumë vende që paraqesin interes për historinë dhe traditat e popullit tonë, megjithëse në këtë fushë ka ende shumë pika të panjohura, që duhet, pa humbur kohë të zbulohen, të njihen dhe tani për tani të pikëtohen.

Kjo do parë edhe përsa i takon çeshtjes së ndarjes së objekteve të propagandës monumentale, mbasi shpërndarja dhe vendosja e tyre, që nga objektet më të thjeshta e deri tek ato më të komplikuarat, nuk është bërë gjithmonë me kriter të drejtë. Kështu p.sh. në rast se në disa rrethe si Korça e Vlora janë ngritur mbi 70 lapidarë në disa rrethe të tjera si Librazhd, Gramshi e Pogradeci nuk ka më tepër se 5–10 ose 15 lapidarë. Natyrisht ngritja e lapidarëve, ashtu si edhe vendosja e objekteve të tjera përcaktohet, nga ngjarjet që janë zhvilluar në njerën apo tjetrën krahinë. Por kjo ka të bëjë edhe me kujdesin e vlerësimin e pamjaftueshëm politik që komitetet e partisë dhe organet përkatëse të pushtetit lokal kanë treguar për këtë problem.

Kjo e metë verehet deri në një farë mase edhe në ndarjen e vendosjen e objekteve të mëdha të propagandës monumentale, gjendja e të cilave paraqitet si vijon:

- për figurat e rëndësishme historike që përfshihen deri në vitin 1939 janë ngritur 28 buste.
- për heronjtë dhe dëshmorët e Luftës Nacional–Çlirimtare janë ngritur 77 buste.
- për klasikët e marksizëm–leninizmit dhe shokun Enver janë ngritur 25 buste.
- tok për të tre këto ndarje në 10 rrethe janë ngritur 16 monumente, duke përfshirë këtu edhe ato që janë vendosur para çlirimit.

Nga të dhënat e mësipërme del se shpërndarja e objekteve të mëdha të propagandës monumentale sipas rretheve e periudhave, ashtu siç rezultojn edhe më poshtë, nuk është e rregullt, pse ka qytete të rëndësishëm si Durrësi, Fieri apo Lushnja që s’kanë asnjë monument. Por ka

edhe rrethe si Gramshi e Librazhdit që s’kanë të vendosur asnjë bust.

Përsa i përket tematikës së këtyre objekteve ajo i kushtohet kryesisht ngjarjeve historike, patriotëve, heronjve dhe dëshmorëve të Luftës Nacional–Çlirimtare, rojave të kufirit e dëshmorëve që kanë rënë në përpjekje me bandat diversante. Në gjinin e madhe të propagandës monumentale që përfaqësohet me monumente e komplekse skulpturale, krahas monumenteve të Skënderbeut (në qytetin dhe Kombinatin e tekstilave “Stalin” e në Tiranë), të shokut Enver (në shkollën e bashkuar) janë ngritur edhe 5 monumente e komplekse skulpturale si ai i kooperativës së parë (në Krutje) [ALS–327], i dëshmorëve të Luftës Nacional–Çlirimtare (në Përmet) [ALS–244], i Partizanit (në Tiranë) [ALS–1] etj., që simbolizojnë ngjarje nga e kaluara dhe e tashmja heroike e popullit tonë. Siç del tematika e gjinisë madhe të propagandës monumentale në fushën e skulpturës është ende e kufizuar.

1. Mungojnë mjaft komplekse të tilla që të pasqyrojnë aspektet më të rëndësishme të epopesë së madhe të Luftës Nacional–Çlirimtare e sidomos mungojnë vepra të tilla në të cilat të pasqyrohet heroizmi i ditëve tona dhe monumente që të trajtojnë e përgjithësojnë veprën e partisë. (Për këtë qëllim nga Ministria e Arësimit dhe Kulturës është hartuar një projekt 15 vjeçar).
2. Shumë e pakënaqëshme paraqitet gjendja lidhur me pasqyrimin e tematikës që ka të bëjë me trajtimin e figurës së femrës shqiptare. Në këtë drejtim, përveç bustit të Zoja Çurres në Tragjas dhe Shejnase Jukës në Shkodër, në qytetet tona e sidomos në qytetet e mëdha ku janë ngritur me dhjetra objekte të ndryshme të propagandës monumentale, mungojnë fare objektet që t’i kushtohen kujtimit të grave. Prandaj mbetet që në të ardhmen të pasqyrohet tematika e trajtimit të veprës dhe figurës së gruas shqiptare në të gjitha llojet e objekteve të propagandës monumentale. Tani për tani mendojmë të merren masa urgjente për të ngritur bustet e grave dhe vajsave që janë shpallur heroina dhe gradualisht ndër parqe, lulishte e pika të tjera të vendosen përkujtimore, dhe ku është e mundur, statuje në allçi e çimento, që të simbolizojnë figurën e femrës shqiptare si luftëtare që ka lojtur rol të rëndësishëm në të gjitha periudhat e historisë së popullit tonë.
3. Krahas pasqyrimin të kësaj teme lypset të vendosen më tepër objekte të propagandës monumentale që trajtonjë veprimtarinë revolucionare të fëmijëve e pionierëve tanë, të cilët si dje në luftë ashtu edhe sot për ndërtimin e socializmit, kanë qenë dhe janë krah për krah me prindërit e tyre.



4. Njëkohësisht të plotësohen boshllëqet për zhdukjen e kufizimit në tematikën e përkujtimeve që i kushtohen ngjarjeve para vitit 1939 apo që kanë të bëjnë me emra personash e ngjarjesh të ditëve të sotme. Veçanërisht në propagandën monumentale paraqitemi dobët në pasqyrimin e temës së luftës të klasave. Prandaj në të ardhmen trajtimi i rolit të masave si forcë lëvizëse të zërë vendin kryesor në këtë fushë, duke nxjerrë në pah jo vetëm luftën për çlirim kombëtar, për ndërtimin e socializmit dhe fitoret e arritura, por edhe luftën për çlirim social që kanë bërë masat në vendin tonë. Kjo të pasqyrohet duke vendosur komplekse skulpturale, pano, piktura murale dhe gjini të tjera të këtij profili.
5. Vemendje e posaçme t'i kushtohet ngritjes së objekteve të ndryshme të propagandës monumentale, që lidhen me pasqyrimin e tematikës aktuale sidomos me inisiativat revolucionare të kohës që kanë shpërthyer kudo në vendin tonë, ku në mënyrë të veçantë të spikasë roli dhe vepra e masave për thellimin e mëtejshëm të revolucionit ideologjik e kultural.

Një problem tjetër i rëndësishëm që lidhet me efektin politik dhe edukativ të objekteve të propagandës monumentale është çështja e paraqitjes së tyre të gjithëanëshme. Duke i parë me këtë sy këto objekte rezultojnë se në disa prej tyre mungon përpjekja për originalitet kombëtar, dhe disa të tjera nuk janë të tilla që ta tërheqin dhe t'i ngjallin respektin e vizitorit.

Mjaft nga objektet e propagandës monumentale, sidomos lapidarët, pllakat përkujtimeve e ndonjë bust janë projektuar e vendosur keq. Shumica e lapidarëve janë të ndërtuar njëjloj, me tulla e suvatim të shëmtuar, pa asnjë motiv dekorativ apo bazorelief të goditur dhe që të gjitha, thuajse vuajnë nga uniformiteti. Me ndonjë përjashtim, nuk dallohen lapidarët që përkujtonjë të kaluarën e lashtë nga ato të Luftës Nacional-Çlirimtare apo të ndërtimit socialist. Fjala është që çdo epokë të ketë motivet e saja karakteristike. Nga ana tjetër ka lapidarë që nuk i përgjigjen qëllimit për të cilin janë ngritur, sepse nuk simbolizojnë ngjarje apo aksione konkrete. Ka edhe lapidarë që në fakt i kushtohen kujtimin të dëshmorëve të caktuar, por që në të vërtetë nuk njohin nga vizitori, sepse në to nuk ka asnjë mbishkrim.

Përsa i përket mbishkrimeve në një pjesë të mirë të objekteve të propagandës monumentale ato nuk janë të goditura. Mbishkrimet vuajnë për mungesën e përmbytjes emocionale e politike dhe si të tilla nuk lënë asnjë mbresë në kujtesën e vizitorit. Shpesh mbishkrimet janë të gjata, të shkruara keq e me gabime. Në shumë objekte ato janë bërë të pa lexueshme dhe në disa të tjera po prishen.

Kjo gjendje flet për kujdesin e pakët që tregohet ende për mirëmbajtjen e objekteve të propagandës monumentale sa që në ndonjë rast disa prej tyre janë prishur krejtësisht. Kjo pakujdesi vërehet edhe në mirëmbajtjen e objekteve me material të fortë; siç janë monumentet e bustet me rëndësi, lysterja e të cilëve bëhet nga punonjës jo kompetentë të organeve komunale. Për pasojë disa nga figurat e shquara po dëmtohen dhe po humbasin tiparet e tyre karakteristike. Prandaj, përveç masave serioze që do të merren nga organet përkatëse në këtë drejtim, duke filluar që nga paraqitja e përgjithshme e këtyre objekteve e deri tek sistemimi e zbulimi i ambienteve për rreth, është e nevojshme që çështja e mirëmbajtjes të objekteve të propagandës monumentale të bëhet opinion dhe edukatë e gjithë masave dhe veçanërisht e brezit të ri.

Me këtë rast nga ana e organizatave të frontit dhe rinisë mund të ndërmerren aksione konkrete, duke i konsideruar ato si faktor për edukimin revolucionar të masave. Aksionet që do të merren në këtë fushë të shërbejnë që krahas rregullimit dhe mirëmbajtjes të objekteve ekzistuese të propagandës monumentale të vlejnjë, gjithashtu edhe për ngritjen e objekteve të reja, që lidhen me ngjarjet më të shënuara të popullit tonë, sidomos me ato ngjarje që pasqyrojnë temën e Luftës Nacional-Çlirimtare, temën e ndërtimit socialist dhe atë të thellimit të revolucionit ideologjik dhe kultural.

## 2

Dihet se propagandën monumentale nuk e përbëjnë disa gjini të caktuara, siç janë lapidarët, bustet ose komplekse skulpturale. Këto janë vetëm disa lloje të saj. Çështja është që të gjallërohen gjërësisht të gjitha komponentet e tjera të kësaj dege të propagandës së partisë, që nga parullat e pllakatat e gjer tek panot e pikturat murale të llojeve më të ndryshme.

Ndërkaq për të bërë më militues rolin e propagandës monumentale, ka ardhur koha të merren masa për zhvillimin e disa gjinive më të efektshme artistike, siç janë vendosja e bazoreliefeve, statujëve të llojeve të ndryshme të skulpturës së parqeve, panove, pikturave murale e tjerë. Domosdo vendosja e tyre të bëhet, në radhë të parë, në ato lokale, salla, teatro, qendra pune, reparta ushtarake, sheshe apo lulishte, që frekuentohen më shumë nga masat. Nga ana tjetër Ministria e Ndërtimit dhe organet e saja projektuese në konsultim me Ministrinë e Arësimit dhe Kulturës si dhe me Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, të kenë paraqysh që në veprat më të rëndësishme që do të ndërtohen pas këtaj të parashikojnë vende të posaçme, ku me kohë mund të vendosen objekte të propagandës monumentale.

Puna për zgjidhjen e këtyre kërkesave jo vetëm

duhet të lidhet ngushtë me nevojën për revolucionarizimin e mëtejshëm të propagandës monumentale, por njëkohësisht ajo të shërbejë për zhdukjen e të gjitha ndikimeve të huaja të ideologjisë feudo-borgjeze e fetare që trashëgojmë nga e kaluara në këtë fushë e që në njerën apo tjetrën formë veprojnë në ndërgjegjen e masave. Kuptohet se fjala është për të zhdukur përfundimisht ose për të grumbulluar, sipas rastit apo objekte (si kryqet, statujet etj), që kanë përmbajtje fetare e që ende gjenden të vendosura aty këtu. Nga ana tjetër hiqen nga lokalet publike, restorantet, stacionet e trenit etj, pikturat e bëra me shije e përmbajtje ideo-artistike të pa përshtatshëm dhe të zëvendësohen gradualisht me vepra artistike të përshkuara nga fryma e kohës. Po kështu të pezullohen të gjitha prodhimet (jasteket, tabllot e qëndisura etj) me përmbajtje të keqe, që nxjerr në treg artizanati.

Paralelisht me punën për zhvillimin e mëtejshëm të propagandës monumentale, rëndësi të veçantë merr çështja e shfrytëzimit sistematik të objekteve të kësaj propagande për edukimin e vazhdueshëm të masave. Deri tani në vendet ku janë vendosur këto objekte janë organizuar aktivitete të ndryshme, por megjithatë organizimi i pakët i këtyre aktiviteteve (vetëm me raste fushatash) tregon se përdorimi i objekteve të propagandës monumentale ende nuk kuptohet si nevojë e domosdoshme, që ndihmon për njohjen dhe përvehtësimin e historisë dhe traditave revolucionare të popullit. Këtej e kanë burimin format e kufizuara dhe jo tërheqëse që praktikohen në drejtim të shfrytëzimit të objekteve të propagandës monumentale për edukimin e gjithanëshëm komunist të masave, sidomos të rinisë. Këtu nuk është fjala për të dhënë receta, se çfarë formash e aktiviteteve mund të praktikohen paskëta për edukimin revolucionar të masave nëpërmjet lapidarëve, busteve, monumenteve etj. Këtë çështje çdo organizatë, qendër pune, shkollë apo repart ushtarak mund të zgjidh sipas kushteve dhe mundësive konkrete që ka, duke aplikuar pranë objekteve të propagandës monumentale forma të shumëllojshme, që nga ato që njihen e deri tek betimi ushtarak, organizimi i koncerteve me këngë dhe poezi revolucionare, dhënie flamurësh etj. Rëndësi ka që punën për edukimin e masave me anën e objekteve të propagandës monumentale ta ngremë në sistem dhe ta lidhim ngushtësisht me qëllimin për kalitjen ideologjike marksiste-leniniste të njeriut tonë të ri.

Për të përmirësuar gjendjen dhe për t'i dhënë hov më të madh zhvillimit të propagandës monumentale propozojmë të merren edhe këto masa:

1. Me rastin e festimit të jubileut të madh të 25-vjetorit të çlirimit të Atdheut të shpallet një fushatë e gjërë nacionale për lapidarët dhe objektet e tjera të propa-

gandes monumentale në këto dy drejtime:

- a. Të rregullohen e përmirësohen objektet ekzistuese.
- b. Të vendosen objekte të reja.

Për këtë qëllim Ministria e Arësimit dhe Kulturës në bashkëpunim me organet lokale të marrë masat që brenda një afati sa më të mundshme, të vishen me mermer të gjithë lapidarët që janë vendosura gjatë rrugëve automobilistike, dhe në të njëjtën kohë të zëvendësohen lapidarët e pa përshtatshëm.

Nga ana tjetër Ministria e Arësimit dhe Kulturës të bëjë projekte tip (disa llojesh) për lapidarët që do të ngrihen, duke patur parasysh faktin që çdo model tip të përmbajë motivet karakteristike të epokave të caktuara nga historia e popullit tonë.

2. Krahas objekteve të ndryshme të propagandës monumentale, që do të ngrihen për të kujtuar ngjarjet më të rëndësishme të historisë dhe veprës së partisë e popullit tonë nga epopeja e madhe e Luftës Nacional-Çlirimtare dhe ndërtimi socialist; në kuadrin e jubileut të 25-vjetorit të çlirimit të Atdheut, të vendosen monumente dhe komplekse skulpturale tematike që të trajtojnë disa nga ngjarjet më të shënuara të luftës së klasave që kanë bërë masat popullore për çlirim shoqëror, duke nxjerrë mirë në pah rolin e heroizmit masiv.

Kudjes i veçantë t'i kushtohet sidomos vendosjes së objekteve të ndryshme të propagandës monumentale (pano, piktura murale, komplekse skulpturale etj.) që pasqyrojnë mobilizimin e masave dhe heroizmin e tyre masiv në luftë për realizimin e iniciativave revolucionare që kanë shpërthyer kudo në vendin tonë, si dhe të veprës së tyre për thellimin e mëtejshëm të revolucionit ideologjik e kultural.

Në mënyrë që të përballohen nevojat e mëdha që do të paraqiten në këtë fushë, ashtu si dhe për projektimin e lapidarëve e përkujtimorëve të tjera, krahas angazhimit të skulptorëve dhe arqitektëve, Ministria e Arësimit dhe Kulturës të udhëzojë Universitetin Shtetëror të Tiranës dhe Institutin e Lartë të Arteve, që në detyrat mësimore studentët e Degës së Arteve Figurative dhe ata të Fakultetit të Inxhinierisë të ngarkohen me punë për të bërë projekte kompleksesh skulpturale, lapidarësh dhe objekte të tjera të propagandës monumentale që lidhen me pasqyrimin e tematikës së mësipërme.

3. Në kuadrin e fushatës për përmirësimin e gjendjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të propagandës monumentale, të mos mbetet asnjë ngjarje pa u përkujtuar dhe fiksuar në ndonjë objekt sado të thjeshtë të propagandës monumentale. Me këtë rast të vendosen pllaka përkujtimore në çdo objekt ku janë themeluar celulat e punës, shkollat etj. që të mbajnë emërtime



dëshmorësh apo ngjarjesh.

4. Të gjitha komitetet e partisë dhe organet e tjera përkatëse ta studjojnë gjendjen e propagandës monumentale dhe të përcaktojnë konkretisht detyrat që u dalin atyre për zgjidhjen e këtij problemi. Për këtë çështje të ngrihen komisione të posaçme.
5. Për të disiplinuar më mirë çështjen e vendosjes së objekteve të propagandës monumentale, të mos ngrihen objekte të tilla që kanë në nomenklaturën e vet rrethet, pa u parë dhe konsultuar projektet e tyre me masat dhe komisionet.
6. Të bëhet regjistrimi dhe pasaportizimi i gjithë objekteve të propagandës monumentale dhe të vihen ato nën kujdesin e plotë të komiteteve ekzekutive dhe muzeumeve lokale.
7. Me fillimin e fushatës për rregullimin e gjendjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të propagandës monumentale të shkruhet herë mbas here në shtypin qendror dhe lokal.
8. Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” në prag të 25-vjetorit të çlirimit të Atdheut të nxjerrë një album me veprat artistike më të bukura të propagandës monumentale.

Ne mendojmë se përcaktimi konkret i masave për forcimin e mëtejshëm të rolit të propagandës monumentale bëhet më i domosdoshëm, sidomos tani, kur revolucioni ideologjik e kultural ka hy në një fazë të re zhvillimi.



# Dignified Symbols for Historical Events

Kujtim Buza & Kleanth Dedi

As a direct result of the great care of the party and the government, a healthy social opinion has been created in our country to keep alive the mass and individual heroism and to immortalize the different events of local and national importance.<sup>1</sup> There is a sensible growth in the number of memorials in our country. Nowadays, we have about 500 lapidars, over 300 commemorative plaques, 140 busts, and 27 monuments and memorials.

The study of the number of those symbols also brings out problems that show their appreciation by different regions. We do not pretend that there is an equality in number between regions. There are differences and there have to be. Those are related to the number of events or persons that one or the other region has to be commemorated.

There are regions such as Tiranë, Gjirokastrë, Berat, and the one of Dibër that, taken together, already possess a third of the number of lapidars located in all other regions. The region of Dibër has as many lapidars as Tiranë and Korçë together, or Berat alone has three times as many lapidars as Kukës and Pukë.

The most emphatic distortion occurs in the placement of commemorative plaques. Tiranë alone, with 103 commemorative plaques, has more than ten regions together. Tiranë, Korçë, and Gjirokastrë taken together have more commemorative plaques than the other twenty-three regions.

Incorrect ratios also exist for the erection of busts in comparison with lapidars. So, for example, in the region of Shkodër there are 16 lapidars and 17 busts. There are regions like Librazhd and Gramsh, where no bust at all has been erected, and others which have a very limited number.

We make these comparisons because they show problems that we think the (executive) party commit-

tees of the regions have to stop and bring to an end. There are several causes that have been a negative influence in this direction. We think that not everywhere in the regions the opinion has been created to erect such objects, there is subjectivism, some treat the problem more broadly, some show themselves to be conservative. So there are regions that even for less important events think and take care to place something as a commemorative sign, and they do well. But other regions do not work correctly in the least, leaving the memory of important events to wither. This has been influenced by the level of knowledge. But the lack of the necessary material basis is not without importance either. This last point, apart from the others, explains the fact that several small regions, especially in the north, have a very small number of commemorative works.

We think that what always needs to be kept in mind is that not everywhere symbols have been placed after a thorough study of the history of the region. This has had an influence on both the general number of events within the region and the ratio between historical periods, events, persons, and the type of symbol itself (bust or statue, lapidar or plaque, lapidar or memorial, etc.).

This duty can be realized even better than we have done so far, if we base ourselves fully on precise studies. It is the duty of (executive) party committees to better centralize the work within the region, to secure this study, to choose the order of placement by means of a yearly plan and perspective. The path of subjectivism and a narrow local spirit that creates disorder and anomaly need to be cut off.

It has been a correct action to erect a considerable number of works of this character for the National Liberation War, even though for this grand epic, both on a national and a local level, there are events or persons that are still not commemorated. An similar addition to commemorative plaques will be made this year. Moreover, many regions have foreseen the erection of new lapidars, busts, etc. that belong to that period.

Great attention and appreciation need to be shown to the period of the building of socialism. This can be said both on a national and a local level, because there

---

<sup>1</sup> Originally published in *Zëri i Popullit* (May 31, 1971), p. 3; based on a governmental report by the same authors, "Disa probleme dhe masa për të ngritur me kritire më të drejta monumentet, përmendorët, bustet, lapidarët dhe pllakat përkujtimore." AQSJ, f. 511 v. 1970 d. 86, pp. 2–22.

are regions such as Tiranë, Vlorë, Gjirokastrë, Kolonjë, and Pogradec that do not have any symbol for that period. The region of Dibër is represented relatively well, with 11, as well as the one of Kruijë, with 8. According to us, we are dealing here with a shallow treatment of this problem, with incorrect concepts that have suggested that these are events known by all, let's wait for some years to pass and the events have become "stable," become "historical" and after that let's think about how to commemorate them. It may be too much to comment on the great importance of historical events, mass and individual heroism of our people for the building of socialism. As regards this problem we think that a special study is to be done on a national and local level, determining the events and then considering their commemorations with works of a monumental character.

More attention also needs to be shown for the commemoration and immortalization of the events of the period from ancient times until the year 1939, because as is known, this is a long period full with many heroic events of our ancestors. For this period, the gap (especially the 15th century) has been well filled during the festivities of the 500th anniversary of Skënderbeg's death.

We need to turn our attention also to another aspect of the problem, because, as it seems, commemorative symbols are mainly placed for different battles, martyrs, several political events, etc., and deal less with other events from the people's history, such as problems that illustrate several rare characteristics of our people, e.g., word of honor [*besë*], honor [*nder*], generosity [*bujari*], mass and individual heroism, etc. So, for example, a commemorative symbol for the Assembly of the Highlanders could be erected, in which the word of honor was given and bloodfeud was denounced. The role of the woman is also less evidenced in different periods, the role of children, etc.

Another important aspect of this problem is also the artistic realism of those works with a monumental character. The materialization of important events from the history of our country in monumental works shows a great appreciation for the age-old heroism of the people. Even though some of the symbols erected during the last years do not have the right artistic presentation, they have a great benefit, as they have pinpointed events that show the different stages of our development. Now the time has come and there is every possibility to continue to build (as has been successfully done the last years) dignified symbols. As such we may mention the lapidar dedicated to the First Offensive Brigade in Makërzë, Vithkuq [ALS-147], several lapidars built in the Tiranë region, as well as the one of the Third Brigade, Qemal

Stafa [ALS-4], Misto Mame, Mine Peza [ALS-6], etc. Several lapidars built in the regions of Gjirokastrë, Tepelenë, Berat, Durrës, Librazhd, and Shkodër, etc., are well executed and we honor them. But we also have weakly executed ones without any emotion, built without criteria, and we would say several ugly creations.

An important problem in the execution of those monumental objects is and has been the creation of the spirit of the time to which they are dedicated. Also in this regard we have good examples, such as the lapidars dedicated to Skënderbeg in Kruijë [ALS-594], Lezhë, Librazhd, Vlorë [ALS-476], Gjirokastrë [ALS-394], and Berat [ALS-213]. These are creations permeated by the spirit of the time to which they are dedicated, and unlocking the concrete event over our ideo-artistical requirements.

Other lapidars dedicated to the National Liberation War have in essence an original new idea, and sometimes, for the sake of architectural-sculptural unity, works are executed that present another epoch with a new generalizing force different from the lapidars dedicated to the epoch of Skënderbeg. Nevertheless, it has to be said that the lapidars dedicated to the National Liberation War and the few ones dedicated to our epoch of the building of socialism are works that repeat each other, built according to several inexplicable templates, uniform, without keeping in mind the event that it is dedicated to, the environment, the time, etc.

The mindless erection of lapidars, as high as possible, cut from the earth high into the sky, to be an absolute, columnal lapidar rising upward – this has gone too far and has become a negative criterion in those executions. In several cases the vertical dimension even became the basic criterion to determine the importance of the event.

There are noted tendencies in the practice of lapidar construction to make them approach the roadside or place them inside the city, with the aim to be closer to the passerby. We think that such a solution diverts their meaning itself, degrades howsoever little the atmosphere and emotion that the environment in which the event happened itself would create. Surely, we are not talking here about delimiting the event to exactly where it happened even if the environment is not adequate. They are to be moved from the true location of the event only for the sake of monumentality, identification, and new conditions that can be created in the service of the memorial, and this not kilometers away, but somewhere nearby.

In the monotony created in several lapidars, except the architectural solutions with upright columns, another downside has been the commonplace and mindless usage of marble as a building material, which, be-

ing simultaneously cut in specific formats, creates and dictates by itself templates in terms of dimensions, and consequently, form.

Not everything should be executed in marble. White marble is affixed even to a rock that can be chiseled and stone that can be used, appearing like an esthetically facile and prop material. There are cases, such as the region of Librazhd, which realized a lot of such constructions with chiseled stone, making good use of the conditions, tradition, etc., but also here stones with different dimensions need to be sought and chiseled, according to the place where the memorial would be erected.

And another problem. In general, reading the writings on our memorials, one notices a sort of standardization and unemotional phrase construction, a lack of originality and mania for writing everything on a small plaque. Not only the content of the writing, but also the style of its engraving, the dimensions of the plaques, the material from which they are produced have to be located with care and used in the service of the event.

Also, there is a problem with the content of the writing on the plaques that are dedicated to encounters with the enemy, or assassinations and different actions. In several cases the name of the assassin who accomplished the heroic act is mentioned, in other cases the name of the spy or criminal who was executed, thus immortalizing only the enemy and not the one who condemned him to death.

We think it necessary that on them the two sides are engraved beside one another, emphasizing with an all the more tendentious and emotional language the heroic act of the assassin.

Or how emotionless they speak about a courageous and heroic act such as the one accomplished by Hero of the People Vasil Laçi on the small plaque placed for him in Tiranë! "Here, on May 18, 1941, patriot Vasil Laçi made an assassination attempt against the king of Italy Vittorio Emmanuele III." If one would think about this well, there is a very meaningful saying about this event, an appreciation of the hero and his act, by comrade Enver: "The assassination attempt of the Albanian youth that shot Vittorio Emmanuele III on Durrës Road is the beginning of a great uprising that was being prepared."

It is too much to say that history is not written without names and dates. What is important, is to know how to position them so as to make each passerby stop in front of them, think and take with him the spirit of the time.



# Simbole dinjitoze ngjarjeve historike

Kujtim Buza & Kleanth Dedi

Si rezultat i drejtpërdrejtë i kujdesit të madh të partisë dhe të pushtetit, në vendin tonë, për të mbajtur gjallë heroizmin masiv dhe individual, për të përjetësuar ngjarjet e ndryshme me rëndësi lokale e kombëtare, është krijuar një opinion i shëndoshë shoqëror.<sup>1</sup> Ka rritje të ndjeshme të numurit të përkujtimeve në vendin tonë. Sot kemi rreth 500 lapidarë, mbi 300 pllaka përkujtimore, 140 buste dhe 27 monumente e përmendore.

Nëpërmjet studimit të numurit të këtyre simboleve, dalin edhe probleme që tregojnë vlerësimin që bëhet nga rrethet e ndryshme. Ne nuk pretendojmë të ketë barazi në numur midis rretheve. Ndryshime ka dhe duhet të ketë. Ato janë të lidhura me numurin e ngjarjeve ose të personave që kan njeri ose tjetri rreth për t' u përkujtuar.

Ka rrethe si Tirana, Gjirokastra, Berati dhe ai i Dibrës të marrë së bashku që kanë gati një të tretën e numurit të lapidarëve të vendosur në gjithë rrethet e tjera. Rrethi i Dibrës ka aq lapidarë sa kanë Tirana dhe Korça së bashku, ose vetëm Berati ka trefishin e lapidarëve të Kukësit e Pukës.

Çpërpjesëtime më të theksuara ka në vendosjen e pllakave përkujtimore. Vetëm Tirana, me 103 pllaka përkujtimore, ka më shumë se dhjetë rrethe së bashku. Tirana, Korça, dhe Gjirokastra të marra së bashku kanë më shumë pllaka përkujtimore se njëzet e tri rrethet e tjera.

Raporte jo të drejta ka edhe në ngritjen e busteve në krahasim me lapidarët. Kështu, p.sh., në rrethin e Shkodrës ka 16 lapidarë dhe 17 buste. Ka rrethe si Librazhdi e Gramshi, që s'kanë ngritur as edhe një bust dhe të tjera që kanë një numur shumë të kufizuar.

I bëmë këto krahasime pasi nëpërmjet tyre dalin disa probleme që mendojmë se komitetet e partisë dhe ato ekzekutive të k.p. të rretheve duhet të ndalen dhe të nxjerren përfundime. Ka disa shkaqe që kanë influencuar negativisht në këtë drejtim. Ne mendojmë

se jo kudo në rrethe është krijuar opinionin që të ngremë objekte të ti-lla, ka subjektivizëm, disa e trajtojnë më gjërë problemin, disa tregohen konservatorë. Kështu ka rrethe që edhe për ngjarje më pak të rëndësishme mendojnë e kujdesën të vendosin diçka si shënjë përkujtimore dhe mirë bëjnë, por nuk veprojnë aspak drejt rrethet e tjera që lënë në harresë përkujtimin e ngjarjeve të rëndësishme. Për këtë ka influencuar shkalla e njohjes së ngjarjeve. Por nuk është pa rëndësi edhe mungesa e bazës së nevojshme materiale. Me këtë të fundit, veç të tjerave, shpjegohet fakti që disa rrethe të vogla, sidomos në veri, kanë një numur shumë të vogël veprash përkujtimore.

Mendojmë se ajo që duhet të kihet gjithmonë parasysh është se jo kudo këto simbole janë vendosur pas një studimi të thellë të historisë së rrethit. Kjo ka influencuar si në numurin e përgjithshëm të ngjarjeve brënda rrethit ashtu edhe në raportin midis periudhave historike, midis ngjarjeve, personave dhe vetë llojit të simbolit (bust apo statujë, lapidar apo pllakë, lapidar apo përmendore, etj.).

Realizimi i kësaj detyre mund të bëhet edhe më mirë nga sa e kemi bërë deri sot në qoftë se mbështetemi plotësisht në studime të sakta. Është detyrë e komiteteve të partisë dhe e atyre ekzekutive ta centralizojnë më mirë punën brënda rrethit, ta sigurojnë këtë studim, të zgjedhin radhën e vendosjes nëpërmjet një plani vjetor dhe perspektiv. Këtu u duhet prerë rruga subjektivizmit dhe frymës së ngushtë lokale, që krijojnë çrregullime dhe anomali.

Është vepruar drejt që për Luftën Nacional-Çlirimtare është ngritur një numur i konsiderueshëm veprash të këtij karakteri, megjithatë për këtë epike të madhe, si në rang kombëtar ashtu edhe lokal, ka ngjarje apo persona që akoma nuk janë përkujtuar. Një shtesë e ngjeshme në pllaka përkujtimore (kushtuar dëshmorëve të çdo fshati) do të bëhet që këtë vit. Po kështu, shumë rrethe kanë parashikuar të ngrenë lapidarë, buste, etj. të rinj që i takojnë kësaj periudhe.

Një vëmëndje dhe vlerësim më i madh duhet treguar për periudhën e ndërtimit socialist. Kjo mund të thuhet si në rang kombëtar ashtu edhe lokal, pasi ka rrethe si

<sup>1</sup> Nga *Zëri i Popullit* (31 maj 1971), f. 3; në bazë të raportit "Disa probleme dhe masa për të ngritur me kritire më të drejta monumentet, përmendorët, bustet, lapidarët dhe pllakat përkujtimore," AQSH, f. 511 v. 1970 d. 86, fl. 2-22.

Tirana, Vlora, Gjirokastra, Kolonja dhe Pogradeci që nuk kanë as edhe një simbol për këtë periudhë. Relativisht më mirë paraqitet rrethi i Dibrës, me 11 dhe ai i Krujës, me 8. Për mendimin tonë, këtu kemi të bëjmë me një trajtim të cekët të këtij problemi, me koncepte jo të drejta që kanë sjellë në mendimin se këto janë gjëra të njohura nga të gjithë, të presim të kalojnë disa vjet që ngjarjet të “staxhionohen”, të bëhen “historike” dhe pastaj të mendojmë si t’i përkujtojmë. Është e tepërt të komentojnë rëndësinë e madhe që kanë ngjarjet historike, heroizmi masiv dhe individual i njerëzve tanë për ndërtimin e socializmit. Për këtë problem mendojmë që në shkallë kombëtare dhe lokale të bëhet një studim i veçantë, që të pikëtohen ngjarjet e pastaj të mendohet për përkujtimin e tyre me vepra me karakterit monumental.

Më shumë vëmendje duhet treguar edhe për përkujtimin dhe përjetësimin e ngjarjeve të periudhës nga kohët më të lashta deri në vitin 1939, pasi siç dihet, kjo është një periudhë e gjatë dhe e ngjeshur me plot ngjarje heroizmi të të parëve tanë. Një plotësim i mirë u bë për këtë periudhë (sidomos për shekullin e 15-të) gjatë festimit të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut.

Vëmendjen tonë duhet ta drejtojmë edhe në një aspekt tjetër të problemit, pasi, siç shihet, kryesisht simbole përkujtimore janë vendosur për luftra të ndryshme, dëshmorë, disa ngjarje politike, etj. dhe trajtohen më pak ngjarje të tjera të historisë së popullit, si bie fjala probleme që ilustrojnë disa veti të ralla të karakterit të popullit tonë, si besë, nderin, bujarinë, heroizmi masiv e ai individual, etj. Kështu, p.sh., mund të ngrihej një simbol përkujtimor kushtuar Kuvendit të malësorëve, në të cilin u lidh besa dhe u dënua gjakmarrrja. Më pak evidentohet edhe roli i gruas në periudha të ndryshme, ai i fëmijëve, etj.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij problemi është edhe realizimi artistik i këtyre veprave me karakter monumental. Materializmi në vepra monumental i ngjarjeve të rëndësishme të historisë së vendit tonë është një vlerësim i madh që i bëhet heroizmit shekullor të popullit. Edhe pse disa nga simbolet e ngritura vite më parë nuk kanë paraqitjen e duhur artistike, ato kanë një të mirë të madhe, pasi kanë saktësuar ngjarjet dhe tregojnë statet e ndryshme të zhvillimit tonë. Tani ka ardhur koha dhe janë të gjitha mundësitë të vazhdojmë të ndërtojmë (siç është arritur me sukses këto vitet e fundit) simbole dinjitoze. Si të tilla mund të përmendim lapidarin kushtuar Brigadës së 1-rë sulmuese në Makërzë të Vithkuqit [ALS-147], disa lapidarë të ndërtuar në rrethin e Tiranës, si ai i Brigadës së 3-të, i Qemal Stafës [ALS-4], i Misto Mamës, i Mine Pezës [ALS-6], etj., disa lapidarë ndërtuar në rrethet e Gjirokastrës, Tepelenës, Beratit,

Durrësit, Librazhdit dhe Shkodrës, etj. janë realizime të mira e që na nderojnë. Por kemi edhe realizime të dobëta e fare pa emocion, ndërtuar pa kriter, dhe do të thoshim disa krijime të shëmtuara.

Një problem i rëndësishëm ka qënë dhe është, në realizimin e këtyre objekteve monumentale krijimi i frymës së kohës, së cilës ato i kushtohen. Edhe në këtë vështrim kemi shembuj të mirë, si lapidarët kushtuar epokës së Skënderbeut në Krujë [ALS-594], Lezhë, Librazhd, Vlorë [ALS-476], Gjirokastrë [ALS-394], dhe Berat [ALS-213]. Këto janë krijime që i përshkon fryma e kohës së cilës i kushtohen, zbërthejnë ngjarjen konkrete mbi kërkesat tona ideoartistike.

Të tjerë lapidarë kushtuar Luftës Nacional-Çlirimtare kanë në embrion një mendim të ri origjinal dhe herë-herë, për hir të unitetit arkitekturë-skulpturë, janë realizuar vepra që paraqesin një epokë tjetër me forcë të re përgjithësimi në ndryshim nga lapidarët kushtuar epokës së Skënderbeut. Megjithatë duhet thënë se lapidarët kushtuar Luftës Nacional-Çlirimtare dhe ata të pakët kushtuar epokës sonë të ndërtimit të socializmit janë vepra që përsëritin njera-tjetrën, ndërtuar pas disa shablloneve të pashpjegueshme, uniforme, pa marrë parasysh ngjarjen që i kushtohet, ambientin, kohën, etj.

Ngritje pa kriter, sa më lart, e lapidarëve, shkëputja nga toka lart në qiell, të qënunit pa tjetër një lapidar e një kollone që ngrihet përpjetë. – kjo u tepërua dhe u bë kriter negativ në këto realizime. Bile në disa raste dimensionet në lartësi u bënë kriter bazë për të përcaktuar rëndësinë e ngjarjes.

Në praktiken e ndërtimit të lapidarëve janë vënë re tendenca të afrimit të tyre gjatë rrugës ose brenda në qytet, me qëllim që të jenë sa më pranë kalimtarit. Mendojmë se një zgjidhje e tillë sponon vetë kuptimin e tyre, degradon sado pak atmosferën dhe emocionet që do të krijonte vetë ambienti ku ndodhi ngjarja. Sigurisht, këtu nuk e kemi fjalën që ngjarja të pikëtohet pikërisht aty ku ka ndodhur edhe në qoftë se ambienti nuk është i përshtatshëm. Lëvizja e tyre nga vendi i vërtetë i ngjarjes të bëhet vetëm për hir të një monumentaliteti, evidentimi dhe kushtesh të reja që mund të krijohen në shërbim të përkujtimeve, dhe kjo jo me kilometra larg, por diku aty pranë.

Në monotoninë e krijuar në disa lapidarë, veç zgjidhjeve arkitektonike me kollona përpjetë, një minus ka qënë edhe përdorimi kudo dhe pa kriter i materialit të ndërtimit, mermerit, i cili, duke qënë njëkohësisht i prerë në formate të caktuara, krijoi dhe diktoi vetvetiu shabllone në dimensione dhe, rjedhimisht, në formë.

Jo gjithëçka duhej të realizohej me mermer. Edhe mbi një shkëmb ku mund të gdhëndej e të përdorej guri, u ngjit mermeri i bardhë, që tingëllonte estetikisht si



një material i lehtë dhe butaforik. Ka raste si rreth i Librazhdit, i cili shumë ndërtime të tilla i realizoi me gurë të gdhëndur, duke shfrytëzuar mirë kushtet, traditën, etj., por edhe këtu duheshin kërkuar e gdhëndur gurë në dimensione të ndryshme, sipas vendit ku do të ngrihej përkujtimorja.

Edhe një problem tjetër. Në përgjithësi, duke lexuar shkrimet nëpër përkujtimoret tona, vihen re një farë standardizimi dhe ndërtimi joemocional të frazave, mungesë origjinaliteti dhe mani për t'i shkrojtur të gjitha gjërat në një pllakë të vetme. Jo vetëm përmbajtja e shkrimit, por edhe stili i të gdhëndurit të tyre, dimensionet e pllakave, materiali në të cilin punohen ato duhet gjetur me kujdes dhe përdorur në shërbim të ngjarjes.

Gjithashtu, është problem përmbajtja e shkrimit në pllakat që i kushtohen ndeshjes me armikun, apo atentateve e aksioneve të ndryshme. Në disa raste shënohet emri i atentatorit që kreu aktin heroik, në raste të tjera shënohet emri i spiunit apo kriminelit që u ekzekutua, duke u përjetësuar vetëm armiku dhe jo ai që e dënoi atë me vdekje.

Ne mendojmë se është e domosdoshme në to gdhenden të ballafaquara të dy palët, duke theksuar me një gjuhë sa më tendencioze e emocionale aktin heroik të atentatorit.

Ose sa pa emocion flitet për një akt të guximshëm e heroik si ai që bëri Heroi i Popullit Vasil Laçi në pllakën të vogël me dimensione vendosur për të në Tiranë! “Këtu, më 18 maj 1941, patrioti Vasil Laçi bëri atentatin kundër mbretit të Italisë Vitorio Emanueli i III-të”. Në se do të mendohej mirë, për këtë ngjarje kan një thënie shumë kuptimplote, vlerësim të heroit dhe të aktit të tij, nga shoku Enver: “Atentati i djaloshit shqiptar që qëlloi Viktor Emanuelin III në rrugën e Durrësit, ishte fillimi i një kryengritje të madhe që po përgatitej”.

Është e tepërt të themi që historia nuk shkruhet pa emra e data. Rëndësi ka të dihet si t'i vemë këto për të bërë që çdo kalimtar të ndalet para tyre, të mendojë dhe të marrë me vete frymën e kohës.



# Natural and Cultural Monuments during the Years of Socialism

Muharrem Xhafa

During the years of socialism, the popular government in Albania, even all of Albanian society, gave special importance to the issue and values of cultural monuments and as such held them in high regard. Certainly this is not something accidental, but the result of a realistic politics followed by the Labor Party of Albania in power, which always showed itself concerned toward the sector, life, and problems of cultural monuments, and appreciated this activity with value and great importance for society and Albanian history, in the broadest sense of the word. It did not limit the content, meaning, and role of monuments to the framework of cultural monuments alone. So for the party, state, institutions, and public opinion the concept “monument” included cultural monuments, but also an old artisanal house, a bridge, a building, or something else with artistic, cultural and historical, archeological, or architectural value, as well as works, documents, evidence, and early monuments of the writing of the Albanian language, etc. Also a written work of outstanding historical, cultural, or scientific value for the past or present of country, was understood to be part of this. The Albanian state and population valued all riches inherited throughout the centuries and created during the years of the National Antifascist Liberation War and in the decades of the country’s building of socialism – erected monumental works, completed monumental studies, created monumental compositions, buildings, bridges, and monumental ensembles, pictures, sculptures, monumental tableaus, monumental centers in cities, inhabited zones, and villages. In its endeavors to create grand, monumental works, which left deep impressions with their large dimensions and thoroughly popular–national content, with the greatness they expressed and incredible generalizing features, rising up high, spreading glory to the heroism of the people, its outstanding sons.

The Labor Party of Albania appreciated cultural monuments as buildings and works with historical, cultural, and artistic value, which were protected by the socialist state and fell under its protection. From the year 1948, the Albanian state, as soon as it emerged from the National Antifascist Liberation War, adopted a special

law on cultural monuments and also announced the first list of cultural monuments. Extending this concern, the city–museums of Gjirokastër and Berat, the catacombs of Durrës, and the Old Market of Krujë were brought under the protection of the state. Later, the historical centers of Tiranë, Vlorë, Korçë, and Elbasan were included as well. The cultural monuments in Albania under the care of the state were evaluated, classified, and divided based on rigorously scientific criteria in accordance to their nature and values, historical monuments–buildings, places and things related to historical events and with outstanding figures. In archeological, architectural, artistic, ethnographical, environmental monuments – city and village complexes from different epochs that constitute historical–artistic complexes, together with their natural environment.

In the concept of the state and of institutions specialized in the field, cultural monuments were appreciated as a great national wealth and historical–scientific documents, as art works, which serve the elevation of the culture and civil and patriotic education of the people and the emancipation of society. The legal and actual protection, concretely, of monuments, which was accompanied by their constant maintenance and restoration, constituted a special preoccupation for the popular state during the years of socialism. Any negligence in this field, intentionally or not, was intolerable and punishable by law.

The popular government dedicated special attention to natural monuments. It clearly specified that natural monuments are objects of a living nature with special esthetic, historical, and scientific values, such as different caves, canyons, cliffs, and rocks with uncommon features, unique geological formations, cataracts, forceful underground sources, rare woods and animals, etc. Natural monuments also included territories (an entire territory), which distinguished themselves by original combinations of natural conditions, by natural objects and appearances that are only observed, or are only observed rarely, in other places. During the years of socialism, such territories were declared “national park” or “reserve.” Besides this, natural monuments are objects

that are related to important historical events such as the Plane of Mashkullorë in Gjirokastër, the Cave of Dragobi and the Chestnut of Bajram Curri in Tropojë, the “Cut Rock,” etc. Because of a series of features in its geological and paleogeographical development, Albania has many natural monuments in the lithological make-up of its territory, in its climate, hydrography, biological worlds, etc.

Natural monuments have been forever part of the territory of Albania, but before the liberation of the country, the state’s care for them has been almost inexistent. After the liberation of the country on November 29, 1944, with the establishment of popular government and during the process of the building of socialism, a great, organized work has been done, to carefully bring out and conserve them. Because those, just as other cultural monuments, have a powerful role in the esthetic education of the masses, and serve scholarly, scientific, and educational aims.

It has to be clarified that the objects and territories that were declared natural monuments and that were placed under the protection of the state, as well as cultural monuments in general, were evaluated and verified only by scientific institutions charged by the state and based on rigorously scientific criteria, while the organs of local government took care of their protection. The appreciation of periods, great events, outstanding figures, heroic acts and works of the sons of the people were in the center of the attention of the Labor Party of Albania and the government of Socialist Albania. This is clearly shown by the erection of a large number of monuments, memorials, statues, busts, graves, bas-reliefs, sculptural complexes, lapidars, monumental painted tableaux, etc., extending to all corners of the country. To make this attitude and immortal work of the Albanian socialist state more clear and concrete, we mention, without following the criteria from when they were placed, some of the most well-known monuments, that even nowadays constitute the pride of the country and the people of the Albanian nation. Such as the Monuments of Skënderbeg in Krujë and in Tiranë, the Monument of Bajram Curri in Tropojë, the Monument of the Heroes of Vig in Shkodër [ALS-575], the Monument of the Congress of Përmet [ALS-246], the Monument of Mushqeta [ALS-504], the Monument of Independence in Vlorë [ALS-460], the Monuments of Lenin and Stalin in Tiranë, the Monument of Enver Hoxha in Tiranë, the Monumental Ensemble of the Martyrs’ Graves in Tiranë [ALS-12] and the Martyrs’ Graves in the regions, the Monument of the Partisan in Tiranë [ALS-1], the Museum of Skënderbeg in Krujë, the National Historical Museum, the Monument of the Heroines of Mirditë, not to men-

tion the busts, lapidars, bas-reliefs dedicated to heroic partisan brigades, etc.

The popular government spared no expenses on cultural and natural monuments, on martyrs’ cemeteries, lapidars, and everything else in the honor of the history, culture, and heritage of the Albanian people. One may say that everything has been built and restored in the years of popular government, of socialism. There was not a year that the Albanian state did not give funds to this important sector for the life of the country, there was not a Congress of the Labor Party of Albania that did not determine the concrete duties for the sector of natural and cultural monuments, for the pertinent leading state organizations and for the organs of the national government. The State had established a special Institute, the Institute of Cultural Monuments, a special Sector of the Academy of Sciences, not to speak of the Ministry of Culture. There was also a periodical, half-yearly organ of the Institute of Cultural Monuments – *Monumentet* – which since 1971 published studies on architectural and artistic monuments in Albania, on works and restorations. The articles were also accompanied by many illustrations and a summary in French.

The procedures for the immortalization of important historical events and dates in busts, lapidars, monuments, etc., were thought out well, far from the everyday routine and according to the care of the party and the Albanian state. They predicted the fulfillment of this state task to be a continuous process, which had to be realized bit by bit and year after year, not immediately, in accordance to the economical possibilities of the state, as well as to the cultural growth and increase in national awareness of the people. Ever since the liberation of the fatherland from the foreign nazi-fascist occupiers, the central state organs have tasked the governmental organs in the regions to study and bring out the real situation as regards outstanding figures, martyrs and heroes, and major events, and to plan, on this basis and supported in economic and material possibilities, the annual erection of objects that immortalize the heroic work of the martyrs and heroes of the fatherland and the massive heroism of the people in the struggle for freedom and national independence. This entire process was under control and had the help and support of the highest organs of the party and the Albanian state, which were informed by the lowest dependent organs about the work that was done.

The state organs of culture in the regions had the competence to construct lapidars, busts, and monuments to immortalize the work of those who fell for freedom and the independence of the country in consultation with the Ministry of (Education and) Culture.

In each case, the propositions were made by the Section of (Education and) Culture and the decision was made by the Executive Committee of the regions. The Ministry of (Education and) Culture had the competence to work on the erection of memorial works that crossed regional borders, while there were other works of a great national importance which were decided on by the Council of Ministers, in collaboration with the central organs of the Labor Party of Albania in accordance to its political line and orientations. It may be said that in the decision process regarding the erection of the objects in the honor of the fallen and important events of the history of our country the Committees of Veterans of the National Anti-Fascist Liberation War were also broadly consulted, both in the regions and in the center, as well as the organs of the organization of the Democratic Front in the regions and the center. This was the way of working until the year 1990, when socialism and the people's government in Albania were overthrown. After the establishment of the bourgeois government, the cultural objects that immortalized the heroic deeds of war of the Albanian people for freedom and national independence, especially those of the National Anti-Fascist Liberation War and the building of socialism, were subjected to a criminal vandalism. It is a shame that all this wealth of extraordinary value, well-known within Albania and outside, is currently damaged and destroyed, which without hesitation has to be called a veritable crime, an antinational attitude. The problems regarding the cultural and natural monuments remain unaddressed by the current Albanian government and are treated like problems of little importance, not to say that they are completely ignored. Nowadays there are still the possibilities to restore, as much as possible, what has been damaged, but this depends on the appreciation of this sector of importance to the life of a nation, of a country.

The voluminous study completed by Vincent W.J. van Gerven Oei constitutes, in my opinion, a unique case and an expression of the high level of culture that he possesses, which makes him, without exaggeration, a great personality and scholar. I cannot fail to mention that the fact that through this study of excellent value Vincent expresses respect for the Albanian people and a high internationalist spirit, which he carries as scholar and Dutch citizen to the benefit of a people and nation with an ancient history, such as our nation. Without a doubt, the scholar has had to confront an enormous task, to overcome many obstructions and difficulties, and to make a selection from an endless amount of materials, to arrive at the realization of the work in question, *Lapidari*, which, according to me, he has completed with

the utmost quality. As a professor with an extensive experience in the university, and as an Albanian, I hereby express my highest regard for Vincent W.J. van Gerven Oei, a true European, for the respect and love he has shown for Albania and the Albanian people in preparation of this work as monumental as its title, *Lapidari*.



# Monumentet e natyrës dhe të kulturës në vitet e socializmit

Muharrem Xhafa

Në vitet e socializmit, pushteti popullor në Shqipëri, madje e gjithë shoqëria shqiptare, u jepnin rëndësi të posaçme dhe kishin, po kështu, edhe vlerësim të lartë për çeshtjen e vlerat e monumenteve të kulturës. Sigurisht, kjo nuk ishte diçka e rastit, po ishte rrjedhojë e politikës realiste, që ndiqte Partia e Punës së Shqipërisë në pushtet, e cila gjithnjë tregohej e vëmendshme ndaj sektorit, jetës e problemeve të monumenteve të kulturës, e vlerësonte këtë veprimtari me vlera e rëndësi të spikatur për shoqërinë e historinë shqiptare, në kuptimin më të gjerë të fjalës. Ajo nuk i kufizonte përmbajtjen, kuptimin e rolin e monumenteve thjesht në kuadrin e monumenteve të kulturës. Partia, shteti, institucionet, opinionio shoqëror, në konceptin monument perfishinin, monumente të kulturës, po edhe një ndërtesë të vjetër arti, edhe një urë, një banesë a diçka tjetër me vlera artistike, kulturore e historike, arkeologjike, arkitekturore, edhe veprat, dokumentet, deshmitë e para-monumente të shkrimit të gjuhës shqipe etj. Po kuptohej, gjithashtu, edhe një vepër e shkruar, me vlera të shquara historike, kulturore, shkencore për të shkuaren e vendit e për të tashmen e tij, për qenien e popullit shqiptar. Shteti e populli shqiptar çmonin të gjitha pasuritë e trashëguara në shekuj dhe ato të krijuara në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në dekadat e ndërtimit socialist të vendit – veprat monumentale të ngritura, studimet monumentale të kryera, kompozimet monumentale të bëra, ndërtesat, urat e ansamblet monumentale, pikturat, skulpturat, tablotë monumentale, qendrat monumentale në qytete, zona të banuara e fshatra. Në përpjekjet e saj për të krijuar vepra monumentale, madhështore, të cilat linin mbresa të thella me përmasat e veta të mëdha e me përmbajtjen e tyre të thellë popullore–kombëtare, me madhësinë që shprehnin e trajtat përgjithësuese të papara, që ngrinin lart e i thurnin lavdi heroizmit të popullit, bijve të shquar të tij.

Partia e Punës e Shqipërisë i vlerësonte monumentet e kulturës si ndërtime e vepra me vlera historike, kulturore e artistike, të cilat mbroheshin nga shteti socialist dhe ishin nën kujdesin e tij. Që në vitin 1948, shteti shqiptar, i posa dalë nga LANÇ-i, miratoi një ligj të posaçëm për monumentet e kulturës dhe shpalli li-

stën e parë të monumenteve të kulturës. Në vijim të kësaj përkujdesjeje, në vitin 1961, u vunë nën mbrojtjen e shtetit qytetet-muze të Gjirokastrës e Beratit, nëntoka e Durrësit, Pazari i Vjeter i Krujës. Më pas u përfshinë në këtë përkujdesje qendrat historike në Tiranë, Vlorë, Korçë dhe Elbasan. Monumentet e kulturës në Shqipëri nën kujdesin e shtetit, bazuar në kritere rigorozisht shkencore, vlerësoheshin, klasifikoheshin e ndaheshin në përputhje me natyrën e vlerat e tyre, në monumente historike–ndërtimet, vendet e sendet të lidhura me ngjarjet historike e me figurat e shquara. Në monumente arkeologjike, arkitektonike, artistike, etnografike, mjedisore – komplekset qytetare e fshatare të epokave të ndryshme, që përbëjnë tërësi historike–artistike, bashkë dhe me mjedisin natyror.

Në konceptin e shtetit e të institucioneve të specializuara të fushës, monumentet e kulturës vlerësoheshin si një pasuri e madhe kombëtare e dokumente historike–shkencore, si vepra arti, të cilat shërbejnë për ngritjen e kulturës dhe të edukimit qytetar e patriotik të njerëzve, të popullit, emancipimit të shoqërisë. Për shtetin popullor në vitet e socializmit përbënte një preokupacion të veçantë mbrojtja me ligj dhe në jetë, konkretisht, e monumenteve, e cila shoqërohej me mirëmbajtjen dhe me restaurimin e tyre të vazhdueshëm. Çdo neglizhencë në këtë fushë, me dashje ose jo, ishte e patolerueshme dhe ligjërisht e dënueshme.

Pushteti popullor i kushtonte një vëmendje të veçantë monumenteve të natyrës. Ai përcaktonte qartë se monumentet e natyrës janë objekte të natyrës së gjallë me vlera të veçanta estetike, historike e shkencore, sikurse janë shpellat e ndryshme, kanionet, shkëmbinjtë e guret me trajta jo të zakonshme, zhveshjet gjeologjike unike, kataraktet, burimet hidrike të fuqishmë nëntokësore, drurët e kafshët e rralla etj. Po kështu në monumente të natyrës përfshiheshin edhe territore (një territor i tërë), të cilat dallohen për ndërthurje origjinale të kushteve natyrore, për objekte e dukuri natyrore, që nuk vërehen ose vërehen pak në vende të tjera. Në vitet e socializmit territore të tilla qenë shpallur “park kombëtar” ose “rezervat”. Jo vetëm kaq, monumentet e natyrës janë objekte të cilat lidhen me ngjarje të rëndësi-

shme historike si Rrapi i Mashkullorës në Gjirokastër, Shpella e Dragobisë dhe Gështenja e Bajram Currit në Tropojë, Guri i Prerë etj. Për shkak të një radhe veçorish në zhvillimin gjeologjik e paleogjeografik, Shqipëria në përbërjen litologjike të territorit, në klimën, hidrografinë, botën biologjike etj. ka monumente të natyrës të shumta.

Monumentet e natyrës kanë qenë mot e jetë këtu në territorin e Shqipërisë, po kujdesi për to i shtetit, para çlirimit të vendit, ka qenë thuajse inekzistent. Pas çlirimit të vendit, më 29 nëntor 1944, me vendosjen e pushtetit popullor dhe në procesin e ndërtimit socialist të Atdheut është bërë punë e madhe e organizuar dhe e kujdesshme për nxjerrjen në dukje dhe për vënien në ruajtje. Sepse edhe ato si monumentet e tjera të kulturës kanë një rol të fuqishëm në edukimin estetik e kulturor të masave, shërbejnë për qëllime studimore shkencore e mësimore.

Duhet vënë në dukje se evidentimi e vlerësimi i objekteve dhe territoreve, që shpalleshin monumente të natyrës dhe që viheshin në ruajtjen e shtetit, ashtu si në përgjithësi monumentet e kulturës, bëheshin vetëm nga institucionet shkencore të ngarkuara nga shteti dhe bazuar në kritere shkencore, ndërsa me ruajtjen e këtyre merreshin organet e pushtetit lokal. Ishte në qendër të vëmendjes së politikës së Partisë së Punës të Shqipërisë e të pushtetit në Shqipërinë Socialiste vlerësimi i periudhave, i ngjarjeve të mëdha, i figurave të shquara, i akteve e veprave heroike të bijve të popullit. Për këtë flet qartë ngritja e një numri të madh monumentesh, përmendoresh, shtatoresh, bustesh, varrezash, bazorelievesh, kompleksesh skulpturorë, lapidarësh, tablosh monumentale në pikturë etj., të shtrira në të gjitha anët e vendit. Për të bërë më të qartë e më konkret këtë qendrim e vepër të pavdekshme të shtetit socialist shqiptar po përmendim, pa ndjekur kriterin kohor të vendosjes së tyre, disa prej monumenteve më të dëguara, që edhe sot e kësaj dite përbëjnë krenarinë e vendit, e popullit dhe kombit shqiptar. Si Monumenti i Skënderbeut në Krujë e në Tiranë, Monumenti i Bajram Currit në Tropojë, Monumenti i Heronjve të Vigut në Shkodër [ALS-575], Monumenti i Kongresit të Përmetit [ALS-246], Monumenti i Mushqetasë [ALS-504], Monumenti i Pavarësisë në Vlorë [ALS-460], Monumenti i Leninit dhe i Stalinit në Tiranë, Monumenti i Enver Hoxhës në Tiranë, Ansambli Monumental i Varrezave të Dëshmorëve në Tiranë [ALS-12] dhe Varrezat e Dëshmorëve në rrethe, Monumenti i Partizanit në Tiranë [ALS-1], Muzeu i Skënderbeut në Krujë, Muzeu Historik Kombëtar, Monumenti i Heroinave të Mirditës, pa folur për buste, lapidarë, bazorelieve kushtuar brigadave partizane heroike etj.

Pushteti popullor bënte shpenzime jo të pakta për monumentet e kulturës e të natyrës, për varrezat e dëshmorëve, për lapidarët e gjithçka tjetër në nderim të historisë, të kulturës e të trashëgimisë së popullit shqiptar. Mund të thuhet se gjithçka është ndërtuar e restauruar në vitet e pushtetit popullor, të socializmit. Nuk kishte vit që shteti shqiptar të mos jepte fonde për këtë sektor të rëndësishëm të jetës së vendit, nuk kishte Kongres të Partisë së Punës të Shqipërisë që të mos përcaktoheshin detyra konkrete për sektorin e monumenteve të kulturës e të natyrës, për organizmat drejtuese përkatëse shtetërore dhe për organet e pushtetit vendor. Shteti kishte ngritur një institut të posaçëm, Institutin e Monumenteve të Kulturës, sektor të posaçëm në Akademinë e Shkencave, pa folur për Ministrinë e Kulturës. Kishte dhe një organ periodik gjashtëmujor të Institutit të Monumenteve të Kulturës – Monumentet – që në vitin 1971, në të cilin botoheshin studime për monumentet e arkitekturës e të arteve në Shqipëri, për punimet e restaurimit. Artikujt shoqëroheshin dhe me ilustrime të plota dhe me një përmbledhje në frëngjisht.

Për përjetësimin në buste, lapidarë, monumente, etj. të heronjve dhe dëshmorëve të atdheut, të ngjarjeve dhe datave historike të rëndësishme, procedurat ishin të menduara mirë, larg rutinës së ditës dhe në përputhje me kujdesin e partisë e të shtetit shqiptar. Përmbushjen e kësaj detyre shtetërore, e parashikonin si një proces në vijim, që duhej të bëhej realitet shkallë-shkallë e vit pas viti, jo menjëherë, në përputhje me mundësitë ekonomike të shtetit, si edhe me rritjen kulturore e të ndërgjegjës kombëtare të njerëzve. Qysh pas çlirimit të atdheut nga pushtuesit e huaj nazifashistë, organeve të pushtetit në rrethe u ishte vënë detyrë nga organet shtetërore qendrore, që të studionin e të evidentonin gjendjen reale të figurave të shquara, të dëshmorëve e heronjve dhe të ngjarjeve madhore dhe, mbi këtë bazë, mbështetur në mundësitë ekonomike e materiale, të planifikonin ngritjen vit pas viti të objekteve, të cilat përjetësonin veprën heroike të dëshmorëve e heronjve të atdheut dhe heroizmin masiv të betejave të popullit në luftën për liri e pavarësi kombëtare. I gjithë ky proces ishte i kontrolluar dhe gëzonte ndihmën e mbështetjen e organeve më të larta të partisë dhe të shtetit shqiptar, të cilat edhe informoheshin nga organet më të ulta vartëse për punën që kryhej.

Organet shtetërore të kulturës në rrethe kishin në kompetencë të ndërtonin për të përjetësuar veprën e të rënëve për lirinë e pavarësinë e vendit në lapidarë, buste e monumente, në konsultim me Ministrinë e Kultures ose Ministrinë e Arsimit e Kulturës. Për çdo rast, propozimet bëheshin nga Seksioni i Kulturës ose i Arsimit e Kulturës dhe vendimi merrej nga Komitetet Ekzeku-



tive të rretheve. Dhe Ministria e Kulturës ose Ministria e Arsimit e Kulturës kishte kompetencat e saj për të vepruar në ngritjen e veprave përkujtimore, të cilat i kalonin kufijtë e një rrethi, sikurse kishte vepra të tjera të një rëndësie më të madhe kombëtare për të cilat vendoste Keshilli i Ministrave, në bashkëpunim me organet qendrore të PPSH e në përputhje me vijën e orientimit politike të saj. Mund të thuhet se në marrjen e vendimeve për ngritjen e objekteve në nderim të të rënëve e të ngjarjeve të rëndësishme të historisë së vendit tonë tërhiqej gjerësisht edhe mendimi i Komiteteve të Veteranëve të LANÇ-it në rrethe e në qendër, madje edhe i organeve të organizatës së Frontit Demokratik në rrethe e në qendër. Kështu është vepruar deri në vitin 1990, kur u përmbysën socializmi e pushteti i popullit në Shqipëri. Pas vendosjes së pushtetit borgjez, objektet e kulturës, që përjetësonin veprat heroike të luftës së popullit shqiptar për liri e pavarësi kombëtare, në veçanti të LANÇ-it e të ndërtimit të socializmit, iu nënshtruan një vandalizmi kriminal. Është për të ardhur keq që gjithë kjo pasuri e madhe me vlera të jashtëzakonshme, e njohur në Shqipëri dhe jashtë saj, sot është dëmtuar e shkatërruar, që, pa ngurrim, duhet thënë se përbën një krim të vërtetë, një qendrim antikombëtar. Problemet e monumenteve të kulturës e të natyrës për pushtetin e sotëm në Shqipëri janë lënë në harresë dhe trajtohen si probleme të dorës së fundit, për të mos thënë se injorohen krejt. Sot mundësitë për të korrigjuar, aq sa mund të bëhet, ajo çka është dëmtuar, ekzistojnë, por kjo varet nga vlerësimi që do t'i bëhet këtij sektori të rëndësishëm për jetën e një kombit, e një vendit.

Studimi voluminoz, i kryer prej Z. Vincent W.J. van Gerven Oei, përbën, sipas mendimit tim, një rast unik dhe shprehje të kulturës së lart që ai zotëron, e cila Vincentin e bën, pa e tepruar, një personalitet e studiuës të përmasave të mëdha. Nuk mund të mos vë në dukje faktin që Vincenti shpreh nëpërmjet këtij studimi me vlera të spikatura respekt për popullin shqiptar dhe frymë të lartë internacionaliste, të cilën ai bart si studiuës e qytëtar hollandez në dobi të një populli e kombi me histori të lashtë, siç është kombi ynë. Pa diskutim, studiuësit i është dashur të përballojë një punë voluminoze, të kapërcejë pengesa e vështirësi të shumta, të përziejdhë midis materialeve të pafund, për të dhënë atë çka i duhej për të realizuar, veprën në fjalë *Lapidari*, që, sipas meje, e ka realizuar në mënyrën më cilesore të mundshme. Si profesor me përvojë të gjatë universitare, po dhe shqiptar, unë shpreh konsideratën më të lartë për Z. Vincent W.J. van Gerven Oei, një evropian i vërtetë, për respektin e dashurinë që ai ka treguar për Shqipërinë e popullin shqiptar në përgatitjen e kësaj vepre lapidar, ashtu siç dhe ajo titullohet *Lapidari*.



# The Thanatology of Hope

Gëzim Qëndro

When confronted with an oxymoron like the title “The Thanatology of Hope,” the reader will probably think that it suffers from a referential uncertainty: the words seem to work separately, creating an ambiguous and unconvincing fusion of the two. Furthermore, in our culture death and hope seem to exclude each other (hope dies last!). This is why the cemetery is perceived as a place of sorrow and loss which annihilates any discourse of hope, a *topos* where one thinks that Death was the end of the hopes of the unfortunate inhabitants of the necropolis.

By introducing the concept of the heterotopic space, Michel Foucault enables us to escape from the rigid frame of the conventional time and the phenomenology of death because, as he points out, the cemetery, as a typical heterotopic space: it “represents, reinterprets and re-models the relationship of a person to nature.”<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Michel Foucault, *Le Corps utopique – Les Hétérotopies* (Paris: Lignes, 2009), p. 34.

This relationship is linked to the total break with the conventional time in which we are living, producing what Foucault qualifies as heterochronies, another undeniable proof of the complete annihilation caused by death.

Based on the capacity of the heterotopic space of the cemetery to “display, contest and inverts social relationships.”<sup>2</sup> we would like to widen the concept of the heterotopic space including the Martyrs’ Cemeteries of the National Liberation War which at the time of communist Albania were build in almost every town. The heterotypic quality of these spatio-temporal enclosures combined with their highly complex and ambiguous relationships challenges, beside others, the positivist belief of the Marxist dogma that we live in a unique and homogeneous space. Precisely in the process of the creation of heterotopic spaces we will try to find the potentiality of hope, optimism, and belief in the bright

<sup>2</sup> Ibid.



Fig. 1 Odhise Paskali, *Shokët (The Comrades)* (Përmet, 1964, concrete).

future of the communist society generated by the typology of the Martyrs' Cemetery. They were not only conceptualized as a *memento mori*, a space that "re-models the relationship of a person to nature," but mostly as a space generating a remarkable educational potential through the evocation of the recent past.

11 *Ibid.*, 142–47. Kolevica notes that this design was ultimately abandoned both for aesthetic reasons and because of the technical difficulties presented by the extended horizontal wing. The second version of the project featured an eagle with both wings vertical, and a smaller figural grouping with a partisan standing before it.

of *Mother Albania* in front of it.

According to sculptor Muntaz Dhrami, the preferred design for the monument (among those working at the University) was a version with two stylized flag forms sweeping upward, framing the central figure at the base.<sup>12</sup> It was Shaban Hadëri who was most enthusiastic about the *Mother Albania* figure; the other members of the group felt that such a figure might recall the American Statue of Liberty too closely, and that the party officials would prefer the version with the partisan. This version was indeed that preferred, Dhrami recalls, by Mehmet Shehu. However, when Enver Hoxha examined the various maquettes for the projects, he considered the stylized flags too Modernist, and instead exhibited a strong preference for a lone *Mother Albania* figure. Shehu, falling in line with Hoxha's preference, then exhorted the sculptors to "make her a strong Albanian woman, not a ballerina."<sup>13</sup> The decision to eliminate the surrounding sculptural elements and to focus solely on the single figure made the final design for the Tirana Martyrs' Cemetery unique among such cemeteries.<sup>14</sup> Generally, when martyrs' cemeteries included figural compositions in the round, they were accompanied by geometric, architectonic elements (such as a pillar towering behind the figure) in keeping with the visual vocabulary of lapidars. In the case of *Mother Albania*, the human figure both stands alone and takes the place of the geometric ensemble, essentially become a lapidar itself (a point to

which I will return below).

Work on the cemetery and the *Mother Albania* monument proceeded during a period of intense cultural activity. From 1966 until 1969, Albania's government was focused on the implementation wide-ranging cultural and political changes (modeled partially on Mao's Cultural Revolution).<sup>15</sup> As Hoxha put it in 1966, "The further revolutionization of the life of the country cannot be understood without the development and deepening of the ideological and cultural revolution."<sup>16</sup> This ideological and cultural development included the construction of an impressive number of new monuments, slated for completion in 1969, for the 25-year anniversary of liberation from fascist occupiers. Among the artworks being created at the time were the Monument to the Four Heroines of Mirdita, the Monument to the Five Heroes of Vig [ALS-575], and the Memorial to the Battle of Mushqeta [ALS-504].<sup>17</sup> At the same time, the trio of sculptors tasked with *Mother Albania* were also at work on the massive Vlora Independence Monument [ALS-460]. This monument was also originally intended to be completed by 1969,<sup>18</sup> but – perhaps unsurprisingly – was not finished till 1972, the same year that *Mother Albania* was inaugurated. During the "further revolutionization" of the country that occurred in the late 1960s and into the early 1970s, a number of ideas were surfacing and circulating that shaped both popular and official expectations regarding the meanings of monumental and commemorative sculpture and its role in the New Life of socialist Albania. It is to these ideas and discourses – evident in both archival documents and published materials – that I now turn, in an attempt to understand *Mother Albania* in relation to the overall cultural and social program of Hoxha's regime.

<sup>12</sup> Muntaz Dhrami, discussion with the author, June 16, 2014.

<sup>13</sup> Ibid. Presumably Shehu's association of the initial versions of *Mother Albania* with a "ballerina" stems from the pose of the figure, who stood with her feet together, the wind blowing her dress up around her calves, with arms spread out in a V. For images of some of the initial versions of the *Mother Albania* statue, together with the flag forms, see Faja, "Jetëgjatësia e Simboleve në Arkitekturë," pp. 38–9. The design with the partisan standing before the sweeping flags was subsequently used for the martyrs' cemetery in Kukës [ALS-561]. Sculptor Halim Beqiraj created the figure of the partisan and entered the work in the competition dedicated to the 25th anniversary of Liberation. See "Si një shqiponjë," *Drita*, September 21, 1969.

<sup>14</sup> Enver Faja also recalls that the other members of the University group were dissatisfied with the decision, which they presumably considered conservative and uninspired ("Jetëgjatësia e Simboleve në Arkitekturë," p. 39). However, at least in published materials, there seems to have been no open criticism of the final version of the monument or the cemetery complex – no doubt in part due to Hoxha's intervention in the decision regarding the design. As the recollections of Dhrami, Faja, and Kolevica (ibid., 144) indicate, the decision over the final design for the cemetery complex reiterated the debate – constant during the years of Hoxha's dictatorship – over the influence of Modernism in Albanian art and literature. However, if the decision to opt for the lone *Mother Albania* figure was a turn against Modernism, it is also undeniable that certain Modernist elements were reintroduced into the final treatment of the figure by Rama, Hadëri, and Dhrami.

<sup>15</sup> This set of policies included an emphasis on the abolition of religious practices and the emancipation of women. See Peter Prifti, *Socialist Albania Since 1944: Domestic and Foreign Developments* (Cambridge: MIT Press, 1978), pp. 143–9.

<sup>16</sup> Enver Hoxha, *Mbi Letësinë dhe Artin*, p. 241. I should note that I have found no specific documentation that the choice of the *Mother Albania* allegorical figure was specifically chosen to conform to policies or ideologies outlined as part of Hoxha's Cultural Revolution. My subsequent observations are simply intended to orient our understanding of the monument in the midst of certain new currents in cultural emphasis, not to argue that the monument's content was entirely determined by these currents.

<sup>17</sup> A document from September 19, 1968, signed by Enver Hoxha, indicates nine major projects, including the monuments listed above as well as the completion of the stone foundations for the placement of the *Mother Albania* monument in the Tirana Martyrs' Cemetery (though the completion of the monument itself is not mentioned). See "Vendim: Mbi Vendosjen e Disa Monumenteve, Busteve, dhe Përmendoreve me Rastin e 25-Vjetorit të Çlirimit të Atdheut," AQSH, f. 511 v. 1968 d. 49, p. 1.

<sup>18</sup> "Informacion mbi Masat për Ngritjen e Monumentit të Lirisë në Qytetin e Vlorës," AQSH, f. 490 v. 1967 d. 521, p. 5.

### 3. Monumental commemorative sculpture and society in 1960s and 1970s Albania

Why Mother Albania? While the trope of associating the female form – and the mother, specifically – with the collective entity of the nation and its ideals already had many precedents in monumental sculpture, what was its significance at this point in Albanian history?

It is perhaps easier to begin by answering a related question: why *not* a partisan as the central figure, as the representative of the nation's fallen? In many ways, Enver Hoxha's preference for Mother Albania over the figure of the partisan prefigures a series of ideas put forward by painter Kujtim Buza (together with historian Kleant Dedi) in the early 1970s, ideas which address both aesthetic concerns regarding the construction and placement of monuments and memorials and the ideological implications of the relationship between the nation's past, present, and future. In 1970, Buza and Dedi issued a report on the problems and criteria for the development of commemorative public sculpture. Buza subsequently published an article in *Drita* that outlined several of his central concerns specifically regarding the plethora of new martyrs cemeteries constructed for the anniversary of Liberation and the sculptures placed in them. He explained that these sculptures should

simultaneously honor the fallen and express the optimism that characterized those who fought in the National Liberation War, that they should express that the dream for which they fought and died is now a reality: that socialist Albania [...] marches forward from victory to victory.<sup>19</sup>

However, visualizing this dream meant creating sculptural works that did not simply dwell on the figure of the partisan; Buza saw the proliferation of partisan figures in martyrs' cemeteries as a barrier to the true expression of the revolutionary *present* of the country. Buza and Dedi articulated the idea even more clearly in their report from 1970:

Thus it seems as if only the [figure of the] partisan can honor all the fallen partisans and martyrs. This reduces the historical period of [...] pledging oaths in the name of new victories, as if this time belonged only to the partisans in the years of the war, and not to all of the [Albanian] people today, in their battles to construct socialist society.<sup>20</sup>

19 Kujtim Buza, "Skulptura në Varrezat e Dëshmorëve," *Drita*, August 15, 1971.

20 Kujtim Buza and Kleant Dedi, "Disa Probleme dhe Masa për të Ngritur me Kriteret më të Drejta Monumentet, Përmendoret,

The problem of the partisan as representative of the collective struggle of the nation was not simply a problem of symbols – it was a problem of *time*. The partisan was problematic not simply because it (most often, he) was repeated far too often for Buza's taste, but because it did not express the *continuity* that the "further revolutionization" of the country required. The sculptural centerpieces of martyrs' cemeteries needed to express not simply the past, but the momentum of the present into the future, the building of socialism.

This same sentiment had been expressed by Enver Hoxha himself in 1969, in the context of a letter to Rama, Hadëri, and Dhrami regarding their work on the Vlora Independence Monument. In the letter, which was published on the front page of *Drita*, Hoxha urged that the Independence Monument should commemorate not simply a past event, but also the

forward charge to arrive at other, even more important goals. In it we would see our own revolution moving forward, rising up. The imagination of the people should see [...] that which it realized in the glorious National Liberation War, that which it is realizing today in the building of socialism.<sup>21</sup>

It is not, I think, unlikely that these ideas were also incorporated by the trio of sculptors into the *Mother Albania* monument.

These debates about the figure of the partisan and the attempt to find a symbol that would glorify Albania's present as much as its past coincided with concern over the representation of women in monuments.<sup>22</sup> Central Committee Secretary Ramiz Alia, in a 1968 report on the development of monumental propaganda, expressed "the representation of the thematics that pertains to the treatment of the Albanian woman is very unsatisfactory," chiefly because of the absence of such themes in extant public art. He insisted that it was urgent that

Bustet, Lapidarët dhe Pllakat Përkujtimore," *AQSH*, f. 511 v. 1970 d. 86, p. 20.

21 Enver Hoxha, "Në Gurrën e Pashtershme e Jetëdhënese të Krijimtarisë së Popullit, do të Gjejmë atë Frymëzim të Madh për të Realizuar Vepra të Bukura e Madhështore për Popullin Tonë," *Drita*, July 13, 1969. For an extended discussion of the letter and the Vlora monument, see Raino Isto, "In It We Should See Our Own Revolution Moving Forward, Rising Up": *Socialist Realism, National Subjecthood, and the Chronotope of Albanian History in the Vlora Independence Monument*, Master's Thesis, University of Maryland (2014), 48–78.

22 There remains a vast amount of research to be done on the representation of women in Albanian communist art, both in painting and in sculpture. The present study of *Mother Albania* represents only an initial step towards a full understanding of how the visual arts constructed the roles and understandings of women during Hoxha's regime.



the Albanian woman was symbolized “as a warrior that has played an important role in all periods of our people’s history.”<sup>23</sup> This assessment of the representation of women in monumental works certainly parallels the concerns of Hoxha’s cultural policies, which placed a great emphasis on the emancipation of women and the development of their role in socialist society. However, these ideas can only partially explain why *Mother Albania* might have represented a particularly satisfactory allegory for a monument first commissioned at the outset of Hoxha’s Cultural Revolution.

First of all, *Mother Albania* is not a representation of one of the heroines of the people, nor is she the anonymous figure of the female partisan.<sup>24</sup> If anything, part of the work’s uniqueness is precisely that it avoids the obvious solution of celebrating the present by depicting the New Woman of socialism, instead retaining an almost classical allegorical figure. There was, at the time, no *ex-tant* monumental precedent within Albania for the representation of the nation as a woman, but there was such a precedent in the initial 1962 design for the Vlora Independence Monument, which had initially been conceptualized as a figure of “Albania, strong, wise, brave, a kind mother, an undefeated warrior, with a sword at her waist,” dressed in national costume.<sup>25</sup> This figure would have held aloft a flag in one hand, while the other extended a golden wreath to crown a group of Albanian fighters. Compared to this overtly classical conception of Albania-as-mother, the *Mother Albania* monument does indeed represent a significant attempt to make the theme more “of its time.”

Part of the key to understanding the way in which *Mother Albania* – an allegory with little direct reference to the New Life or the New Woman – could still be a paradigm of the (self-described) innovative tendencies of Albanian socialist realism involves understanding the privileged role of symbol in this type of art. While socialist realism’s stated goal was the reflection of socialist reality (a sufficiently ambiguous aspiration), this reflection reached its highest manifestation in works that represented a metaphorical view of ‘reality.’<sup>26</sup> In a speech

delivered in April of 1972, at the Writers and Artists Union Plenum on aesthetic criticism, historian Andon Kuqali explained that certain types of artworks belong “to the highest level of artistic realism.” These are works that “pass into metaphor, that make figurative associations, that are symbols.”<sup>27</sup> Thus, a statement like that by Agim Shehu, quoted at the outset of this essay (“Albania itself lives in the symbol of the mother”<sup>28</sup>) takes on an additional import: the treatment of *Mother Albania* as a *symbol* – the mother-as-nation – in fact only increased the work’s ability to represent diverse, more “concrete” aspects of socialist life (the emancipation of women, shared national sacrifice, and so forth). This may seem like a straightforward description of the function of symbols, but its significance lies in the recognition that this system described how art and reality coincided, not how art abstracted itself from socialist reality.

If we return to *Mother Albania* as a quintessentially symbolic work, and thus see it as one of the highest manifestations of socialist *realism*, then we might note one additional significant association that the monument suggests: that between the nation and the family. If *Mother Albania*’s function is to aesthetically crystallize – in a way I will address below – a shared national past that at the same time lives on in the shared national struggle to build socialism, then it does so by suggesting a familial bond between the fallen, the living, and future generations. As Luljeta Ikonimi and Shannon Woodcock have pointed out, a significant piece of Hoxha’s cultural policy aimed at the regulation of the family unit and ensuring that the function of this unit supported socialist practices of production and power distribution.<sup>29</sup> Thus, the depiction of the nation as mother is not only (and perhaps, not primarily) explained by the increased focus on women’s issues during the period of Hoxha’s Cultural Revolution, but also by the focus on the family. Imagining the nation as a family strengthened not only the perception of a single ethno-cultural heritage, but also symbolically translated communist policies of family control into the regime of official aesthetic representation and commemoration.

Up to this point, I have attempted to show the *Mother Albania* monument caught up amidst several transitions and currents: between different understandings of socialist realist aesthetics, in the midst of changing social expectations regarding the role of women, and at

23 Ramiz Alia, “Report on the State and Measures for the Development and Further Revolutionization of Monumental Propaganda,” *this volume*, pp. 34–5.

24 The allegorical image of the female-partisan-as-mother was later visualized in the Martyrs’ Cemetery in Lushnja [ALS–194].

25 “Mbi Përmendoren e Pesëdhjetëvjetorit në Vlorë,” AQSH f. 490, v. 1962, d. 992, p. 4. There was, of course, a rich literary tradition of associating the Albanian nation with a woman, with Pashko Vasa’s *O Moj Shqypni* being perhaps the best known example.

26 I place the word ‘reality’ in quotes to indicate, as the quote below demonstrates, that for socialist realism, there was no contradiction between reality and a metaphorical understanding of the world. In fact, the two were equivalent.

27 Andon Kuqali, “Kritika të Orientojë e të Hapë Horizonte për të Ardhenen,” *Nëndori* 4 (April 1972), p. 82.

28 *Ibid.*

29 Luljeta Ikonimi and Shannon Woodcock, “Imoraliteti në Familje: Nxitja e Ankesave të Grave për të Përforcuar Pushtetin e Partisë në Revolucionin Kulturor Shqiptar,” *Përpyekja* 32–3, (Spring 2014), p. 169.

the crux of a new vision of the temporal relationship between past and present. There are almost certainly other such currents that remain to be examined in greater depth. However, I now wish to turn to the monument itself, to consider – concretely – how the work’s aesthetics reflect, imagine, and create the reality of Albanian socialism.

#### 4. *Mother Albania* and the winds of history

It is perhaps ironic that one of the ways that Rama, Hadëri, and Dhrami set about making the figure of *Mother Albania* “of its time”<sup>30</sup> was to reintroduce a decidedly “Modernist” aesthetic. If *Mother Albania* no longer looked like a ballerina, it was in part because the figure itself took on the geometric characteristics generally present in the ensemble accompanying figurative sculptures in martyrs’ cemeteries. In essence, *Mother Albania*’s body itself became a lapidar: her left arm jutting out horizontally, her right arm holding aloft the star nearly always found atop lapidars.<sup>31</sup> To create the feeling of perpetual forward motion and dynamism, and to counter the rigid frontal verticality of the woman’s body, the sculptors extended *Mother Albania*’s robes back, transforming them into angular, almost Futurist waves that terminate in stark, geometric shapes. In doing so, they introduced an entirely new image of the female body: rather than the often quite clingy robes characteristic of classical sculpture, *Mother Albania*’s garb transformed her corporeality into something at once rigid and dynamic. On the one hand, her whole body appears to be dissolving and then reforming, flowing back and out, metamorphosing, abstracting into pure, directed motion. At the same time, however, her starkly vertical poise and stoic visage appear as the coalescence of the abstracted pleats flowing out behind her; in her, the winds of history and change crystallize and become legible. This second reading seems particularly appropriate in light of the sculpture’s place in the martyrs’ cemetery: *Mother Albania* represents the materialization of the sacrifice of those buried in her shadow. The horizontality of historical narrative is elevated to a higher level of meaning, of metaphor, by the upward thrust of her hand raised and grasping the star and laurel branch.

Seen from a distance, winding one’s way up the road leading to Tirana’s Martyrs’ Cemetery, *Mother Albania* is primarily frontal, rising straight and tall like a guardian. However, upon entering the cemetery complex, one

<sup>30</sup> And, one imagines, to solve the problem of no accompanying architectonic or abstract elements, as well as to distance the work conceptually from a sculpture like the Statue of Liberty.

<sup>31</sup> Here, there is a much deeper discussion to be had about the transformation of the female body in the service of socialist realist (and nationalist) aesthetics, but it is beyond my current scope.

mounts the stairs and approaches the sculpture from the side, finally coming around to stand before the work and gaze up. This trajectory emphasizes the latter reading of the figure, from flow of history, forward into coalesced body, and finally upward into symbol (and thus into ‘reality’). The body of *Mother Albania* therefore serves not merely as a symbol of the nation as a whole, but specifically as the visualization of a collective history, creating a unified narrative of the nation.

In 1971, Alfred Çapaliku described the construction underway on the new Martyrs’ Cemetery: “Every piece of marble they lay in place in the beautiful, level surface of the martyrs’ cemetery links together three times. They extend into the past, in the present, and into the future.”<sup>32</sup> *Mother Albania* performs a similar function: it brings together time under the aegis of national history, making the sacrifice of the past tangible and legible even as it gazes with certainty into tomorrow.

#### 5. Enver Hoxha and *Mother Albania*: The dictator, the nation, and history

On May 5, 1985, on the first Martyrs’ Day following Enver Hoxha’s death, a print by Josif Droboniku was published in *Drita* (fig. 3). The image shows the profile of *Mother Albania*, and in her flowing robes the faces of a multitude of partisans, men and women who gave their lives in the struggle to build the nation that communist Albania envisioned. These numerous smaller faces float around one central face, larger than all the others: that of Enver Hoxha. Droboniku’s print visualizes another link in the conceptual chain that *Mother Albania*, as a monument, attempts to create: it establishes the relationship between the dictator and the nation-as-mother, and at the same time between the dictator and the course of the nation’s collective narrative. It is perhaps fitting that Hoxha, who was instrumental in the choice of the *Mother Albania* motif for the cemetery, finds his own image swept up within the symbolic transformation of time. In *Mother Albania*’s robes, in the flows that ebb between the abstract abyss of the past and the conscious realization of national Spirit, Hoxha – together with the nation itself – crystallizes into the comprehensible form of national history.

Nearly three decades later, on May 5, 2014, this very relationship – between the image of the dictator and that of *Mother Albania* – became an object of controversy. While the Albanian heads of state, including Prime Minister Edi Rama (the son of sculptor Kristaq Rama) placed wreaths of flowers before *Mother Albania* to honor the nation’s fallen, several members of the

<sup>32</sup> Alfred Çapaliku, “Duke Medituar për Dëshmorët,” *Drita*, October 3, 1971.




Fig. 3 Josif Droboniku, Untitled print, from *Drita*, May 5, 1985.

its legibility in momentum. In the period following the fall of communism in Albania, history has become – in many instances – unstable, characterized by gaps and forgetfulness, by an often destructive decentering of the past. If the *Mother Albania* monument still stands as a symbol for the nation and its narrative, this narrative is visualized not only in the implacable visage of the mother but also in the abstract and shifting flow of her robes, the flow that sweeps the past into oblivion.

Communist Party of Albania carrying portraits of Enver Hoxha were prevented from entering the cemetery complex by guards.<sup>33</sup> On the previous November 29, for the celebration of national Liberation, the Communist Party had brought their large portrait of Hoxha into the cemetery; it had been seen looming behind the new leaders of Albanian government, and on Martyrs' Day, 2014, a distance needed to be preemptively (re-)established between the image of the dictator and the image of the collective history of the nation. This meant separating Hoxha from *Mother Albania*, extracting him from the flow of history and keeping his representation out of the hallowed space of the Cemetery of the Martyrs of the Nation. This enforcement of distance – begun in April of 1992, when Hoxha's grave was removed from the martyrs' cemetery and relocated to the municipal cemetery – should prompt us to return to the reading of *Mother Albania* that sees her figure dissolving, losing

<sup>33</sup> "Homazhet në Varrezat e Dëshmorëve: Garda nuk lejon komunistët me portretet e Enver Hoxhës," *InfoArkiv*, May 5, 2014: <http://arkivamediatike.com/lajme/artikull/iden/1047574787/titulli/Homazhet-ne-Varrezat-e-Deshmoreve-Garda-nuk-lejon-komunistet-me-portretet-e-Enver-Hoxhes> (Accessed July 28, 2014).



# “Ngremë sytë lart e ndjejmë, se ajo zotëron qiellin”: Monumenti Nëna Shqipëri dhe vizualizimi i historisë kombëtare

Raino Isto

## 1. Hyrje

Mëngjesin e 5 majit 1972, Enver Hoxha dhe kryesia e partisë, së bashku me qindra qytetarë të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, u mbledhën në majën e një kodre prej nga ku mund të vëzhgohej gjithë Tirana nga juglindja, tek Varrezat e Dëshmorëve.<sup>1</sup> Kjo ishte hera e parë që kremtimi i Ditës së Dëshmorëve u mbajt tek varrezat e reja të dëshmorëve, një kompleks ky versioni më modest i të cilit ndodhej një herë e një kohë në kodrën e Shën Prokopit në Parkun e Madh të Tiranës [ALS-8]. Të pranishmit ishin mbledhur në një platformë të hapur përballë figurës imponuese të monumentit *Nëna Shqipëri* [ALS-12], i cili ngrihej 22 metra mbi turmën (fig. 1).<sup>2</sup> Agim Shehu, në reportazhin e tij

1 ARSH, “Miting Përkujtimor në Varrezat e Reja të Dëshmorëve të Atdheut me Rastin e 5 Majit,” *Zëri i Popullit*, 6 maj 1972.

2 Statuja e gjatë 12 metra qëndron mbi një piedestal 10-metërsht.

mbi ceremoninë përkujtimore në gazetën *Zëri i Popullit*, i kushtoi vëmendje të veçantë nënave që kishin ardhur për të nderuar djemtë dhe vajzat që kishin rënë në luftën kundër pushtimit fashist dhe që kishin mbështetur Revolucionin Popullor:

Mbajnë tufa lulesh në duar e i afrojnë herë-herë tek gjiri si t’i kishin bijtë e tyre. Këto lule i kanë sjellë t’ua lënë bijve, bashkë me atë mirënjohje e ngrohtësi nëne me të cilat po i mbështjellnin në gji. Por ato janë më të mëdha se nëna të fëmijëve të tyre. Pamjen e tyre të vërtetë e shohim përballë, lart, në monumentin e madh *Nëna Shqipëria* të dëshmorëve të Atdheut. Është vetë *Shqipëria* në simbolin e nënës. [...] Ngremë sytë lart e ndjejmë, se ajo zotëron qiellin. Në madhësinë e saj është madhështia e luftës që bëri populli, madhështia e




Fig. 1 P. Cici, *Në mitingun përkujtimor*, tek *Zëri i Popullit*, 6 maj 1972.

idealeve të partisë, për të cilat ranë me këngë kaq shume bij të popullit.<sup>3</sup>

Në saj të monumentit dhe varrezave, kjo luftë nuk do të harrohej, përkundrazi, ajo të vazhdonte të jehonte dhe të përforconte ndërtimin e parreshtur të Shqipërisë socialiste. Në fjalën e tij, Sekretari i Parë i Komitetit të Partisë për Tiranën, Manush Myftiu, përshkroi jo vetëm heroizmin e atyre që kishin dhënë jetën për atdheun, por theksoi gjithashtu rolin tejet të rëndësishëm të përmendoreve që ishin ngritur për të rënë. “Ky vend i dëshmorëve dhe mijrat e mijrat e lapidarëve që mbushin Shqipërinë, janë burim i madh frymëzimi sidomos për brezin tonë të ri, që nga e kaluara heroike ai të nxjerrë mësim për të ardhmen [...]”<sup>4</sup>

Ndërsa *Nëna Shqipëri* e kishte drejtuar vështrimin drejt skajeve të qiellit, dhe i varrezës përfaqësonte demokratizimin e të rënëve dhe ruajtjen e origjinës së sintezës që kulminonte në simbolin e nënës-si-komb. Myftiu u shpreh se, “Ja këtu para nesh prehet partizani i thjeshtë krahas udhëheqësve nga më të shquarit të partisë e të popullit, komandanti e komisari, punëtori, fshatari, studenti, [...] komunisti e ai që nuk e kishte taserën e partisë.”<sup>5</sup> Kësisoj, harku i madh i varrezës dhe figura e *Nënës Shqipëri* përfaqësonin, si konceptualisht ashtu edhe vizualisht, dialektikën e përhershme midis qendrueshmërisë dhe harmonisë – “bashkimit monolit të masave”<sup>6</sup> – dhe dinamizmit që shfaqej shpeshherë në skulpturën e realizmit socialist (fig. 2). Megjithatë, vetë monumenti mishëronte një sintezë të dytë, atë midis marshimit të paevitueshëm në linjë të drejtë horizontale të historisë kombëtare, dhe ngjitjes drejt një koaleshence dhe transhendence kolektive, drejt realizimit të një identiteti kombëtar të lindur nga kujtimi i të vdekurve.

Qëllimi i këtij artikulli është që monumentin *Nëna Shqipëri* ta konsiderojmë si materializimin e një sërë idesh rreth kohës, historisë dhe shoqërisë që karakterizonin Shqipërinë komuniste të fundviteve 1960 dhe në fillim të viteve 1970; si vendndodhjen e një kon-

stalacioni transformacionesh dhe sintezash. Në fakt, synimi im është modest: të ofroj një tipologji të këtyre sintezave, të ekzaminoj kuptimin e kësaj veprë në raport me zhvillimin e kulturës komuniste shqiptare prej disa këndvështrimesh, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë përfaqësimit të formës femërore. Do të përqëndrohem kryesisht tek konceptimi dhe ekzekutimi i veprës gjatë periudhës komuniste, duke e marrë në konsideratë periudhën post-socialiste vetëm kalimthi në përfundim të këtij teksti.

Ndonëse disa aspekte të monumentit tërheqin më tepër vëmendje se të tjerat, unë do të përqipem të respektoj karakterin multivalent të domethënies së veprës në kohën që ajo u krijua, të përcjell njëkohësisht karakteristikat monolitike dhe të tjetërlllojshme të saj që gjejmë në cilësitë formale të veprës. Megjithatë, kur përballemi me vepra të realizmit socialist – dhe monumenti *Nëna Shqipëri* përfaqëson një shembull sa unik aq edhe përshtjellues të kësaj rryme – duhet të zbusim vlerësimet që kanë të bëjnë me historinë e artit përkundrajt respektit për aspektin e padukshëm, konceptual dhe ligjërimitor që luan një rol kaq vendimtar në domethënieën e këtyre veprave.<sup>7</sup>

Për aq sa *Nëna Shqipëri* është materializimi konkret dhe formal i Historisë (së Shqipërisë), kjo veprë përfaqëson gjithësesi edhe figurën e nënës si një formë që lëkundet midis të paprekshmes dhe të prekjshmes, një pikë tranziti – siç thoshte Hegel, kjo veprë përfaqëson “gruan [...] si termi nëpërmjet të cilit Shpirti i pavetëdijshëm, ngrihet përtej jo-realititetit të tij në ekzistencën aktuale, përtej një gjendjeje ku ai është i paditur dhe i pavetëdijshëm në domenin e Shpirtit të vetëdijshëm.”<sup>8</sup> Nëse arrijmë të kuptojmë monumentin

3 Agim Shehu, “...Tek Ata që Ranë për Atdhe,” *Zëri i Popullit*, 6 maj 1972. Shehu thekson se nënat zënë një vend të veçantë në ngjarjet përkujtimore si Dita e Dëshmorëve: “Emri i tyre është i pandarë nga ditë të tilla.”

4 Manush Myftiu, “Fjala e Shokut Manush Myftiu, *Zëri i Popullit*, 6 maj 1972. “Mijra e mijra lapidarët” që përmend Myftiu janë padyshim një ekzagjerim; “qindra” do të ishte një numër më i përafërt.

5 Po aty.

6 E kam lënë mënjanë periudhën post-socialiste kryesisht për çështje hapësire dhe fokusi. Megjithatë, siç shpresoj të tregoj nëpërmjet diskutimit të gjenezës së saj, një trajtim i pritjes së mëvonët të veprës do të ishte produktive për të kuptuar si statusin e trashëgimisë kulturore komuniste të Shqipërisë (një nga qëllimet e këtij botimi), ashtu edhe për konceptime në zhvillim e sipër të identitetit modern shqiptar.

7 Kjo nënkupton një diskutim të zanafillës krijuese të veprës dhe të trajtimit të saj në ligjëratën e kohës kur u prodhua. Në shumicën e rasteve, një ligjëratë e tillë është shumë larg pritshmërive të sotme sa i përket ligjëratave “kritike”, dhe për pasojë “poetike” do të ishte një përcaktim më i saktë i saj, që shpesh herë bëhet shkak për shpërfilljen e shkrimeve të tilla si asgjë më shumë se një propagandë lavdëruese qëllimi i së cilës është krentimi i sukseseve të regjimit komunist. Përshkrimi lirik i Agim Shehut i nënave të mbledhura tek këmbët e *Nënës Shqipëri* është një shembull i mire i kësaj lloji ligjërate që privilegjon interpretimin poetik në vend vlerësimit apo “raportimit” kritik. Megjithatë, një nga tiparet dalluese të shtetit komunist në Shqipëri (dhe në vende të tjera) është pikërisht përvetësimi i kësaj lloji *poetike gjithëpërfshirëse*. Për sa kohë që aspekti totalitar i shteteve komuniste (ose staliniste) ka një karakter të pashmangshëm estetik (siç ka argumentuar Boris Groys), atëherë diskutimi poetik, panegjirik i veprave të tilla duhet të konsiderohet si një aspekt i rëndësishëm i domethënies së tyre, përkrah cilësive të tyre formale. Për karakterin estetik të shteteve staliniste shih: Groys, *The Total Art of Stalinism*, përkth. Charles Rougle (Nju-Jork: Verso, 2011).

8 G.W.F. Hegel, *Phenomenology of Spirit*, përkth. A.V. Miller (Nju-Jork: Oxford University Press, 1977), f. 278.



*Nëna Shqipëri*, kjo do të na ndihmonte të kuptonim se si u ndërtua ky Shpirt kombëtar kolektiv në Shqipërinë komuniste: pamjen e tij, domethënien e tij, dhe ndikimin e tij mbi narrativën mbi të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e vendit.

## 2. Lindja e *Nënës Shqipëri*

Vendimi për t'i lëvizur varrezat e dëshmorëve të Tiranës nga Parku i Madh i kryeqytetit në vendodhjen e tyre të re u mor nga Këshilli i Ministrave më 1 prill 1964. Teksa projekti zhvillohej, horizonti i tij u zgjerua: varrezat e reja do të përfshinin jo vetëm varret e partizanëve dhe dëshmorëve të tjerë të luftës kombëtare për çlirim, por gjithashtu edhe varret e figurave të rëndësishme të partisë dhe të dëshmorëve nga Kosova.<sup>9</sup> (Myftiu i aludon këtij interpretimi më demokratik të domethënies së varrezave në përshkrimin e atyre që përkujtohen në hapësirën e tyre.) Konkursi për projektimin e varrezave të reja u shpall në vitin 1966. Paralelisht, u ngritën edhe tri grupe pune me arkitektë dhe skulptorë: një pranë Institutit Shtetëror të Projektimit (ISP), një pranë Departamentit të Arkitekturës në Universitetin e Tiranës (ky grup përfshinte treshen e mirënjohur të skulptorëve Kristaq Rama, Shaban Hadëri dhe Muntaz Dhrami), dhe i fundit pranë Zyrës së Urbanistikës e të Projektimit të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës.<sup>10</sup> Projektet që propozuan grupet e lartpërmendura u ekspozuan në ambientet e Pallatit të Kulturës, dhe u vizituan si nga

9 Enver Faja, "Jetëgjatësia e Simboleve në Arkitekturë," në *Kush e drejton urbanistikën shqiptare* (Tiranë: UFO University Press, 2008), f. 37. Siç shpjegon Faja, kjo u bë shkak për ndryshimin e emrit të varrezave në "Varrezat e Dëshmorëve të Kombit" (në vend të "Tiranës" apo të "Luftës Kombëtare Çlirimtare"). Sipas Fajës, në një moment projekti përfshinte edhe një mauzole që një ditë do të strehonte eshtrat e Enver Hoxhës, ide që më pas u braktis (ndoshta pasi pohonte vdekjen e pashmangshme të udhëheqësit). Shih Faja, f. 39. Megjithatë, kur ndërroi jetë në 1985, Hoxha u varros pikërisht në këto varreza. Kjo ese nuk e adreson drejtpërdrejtë çështjen e arsyeve për spostimin e varrezave, apo kriteret që u përdorën për të përcaktuar "dëshmorët" që do të varroseshin në to. Padyshim që zhvendosja rriti madhësinë e varrezave, duke qenë më lart dhe më e dukshme, dhe duke i ofruar vizitorit një pamje më të gjerë e mbresëlënëse të Tiranës së vendndodhja e mëparshme e varrezave. (Zëvendësimi i obeliskut të thjeshtë në varrezat e vjetra me një skulpturë figurative masive e theksoi akoma më tepër prezencën e rritur vizuale.) Studime të mëtejshme të politikave rreth varrezave të dëshmorëve gjatë periudhës në fjalë do të hidhnin më tepër dritë mbi aspektet e varrezave të dëshmorëve të Tiranës që shkojnë përtej statujës *Nëna Shqipëri*.

10 Petra Kulevica, *Arkitektura dhe Diktatura* (Tirana: Logoreci, 2004), f. 143. Grupi pranë Universitetit të Tiranës përbëhej nga profesor B. Daja, inxhinier I. Papanikolla, arkitektët Enver Faja, V. Ciko dhe R. Kote, si dhe tre skulptorët që kemi përmendur. Grupi pranë Zyrës së Urbanistikës dhe të Projektimit përbëhej nga arkitekti Petra Kulevica dhe skulptorët Perikli Çuli dhe Hektor Dule.




Fig. 2 P. Cici, Varrezat e reja të dëshmorëve të Atdheut, tek Zëri i Popullit, 6 maj 1972.

publiku ashtu edhe nga kryesia e partisë, duke përfshirë Enver Hoxhën. Projekti fillestar i grupit pranë Zyrës së Urbanistikës përqendrohej tek figura e një shqiponje gjigande, një krah i së cilës shtrihej horizontalisht mbi varrezat duke i mbrojtur ato, ndërsa tjetri ngrihej lart triumfues.<sup>11</sup> Grupi pranë Universitetit të Tiranës paraqiti disa projekte, shumica e të cilëve kishin një obelisk ose një flamur në qendër të tyre dhe skulpturën e një partizani ose të një personifikimi të *Nënës Shqipëri* përballë.

Sipas skulptorit Muntaz Dhrami, version i parapëlqyer i monumentit (mes atyre që punonin në Universitetin e Tiranës) ishte ai me figurat e dy flamujve që valëviteshin lart e që vinin në kornizë figurën e tretë në tokë.<sup>12</sup> Shaban Hadëri ishte më entuziasti mes tyre

11 Po aty, f. 142–47. Kulevica vë re se ky version u braktis për arsye estetike por edhe për shkak të vështirësive teknike që paraqiste krahu i shtrirë horizontal. Versioni i dytë i këtij projekti përmbante një shqiponjë krahëlartë dhe një grupim më të vogël figurativ para të cilit ndodhej një partizan.

12 Muntaz Dhrami në diskutim me autorin, 16 qershor 2014.

për figurën e *Nënës Shqipëri*; anëtarët e tjerë të grupit dyshonin se një figurë e tillë mund t'i ngjante pak si tepër Statujës së Lirisë në SHBA, dhe se zyrtarët e partisë do të parapëlqenin versionin me partizanin. Dhe në fakt, pikërisht ky version që ai që u pëlqye më shumë, siç kujton Dhrami, nga Mehmet Shehu. Megjithatë, kur Enver Hoxha shqyrtoi maketet e ndryshme të projekteve, flamujt iu dukën tepër modernistë dhe i pëlqeu shumë më shumë figura e vetmuar e *Nënës Shqipëri*. Shehu ndoqi linjën e Hoxhës dhe i kërkoi skulptorëve ta shndërronin atë në “një grua të fortë shqiptare, jo një balerinë.”<sup>13</sup> Vendimi për të eliminuar elementet e tjera skulpturore dhe për t'u përqendruar tek figura e vetme e *Nënës Shqipëri* bëri që projekti përfundimtar i Varrezave të Dëshmorëve të Tiranës të ishte unik mes strukturave të ngjashme.<sup>14</sup> Në përgjithësi, në ato raste kur varrezat e dëshmorëve përfshinin kompozime figurative përreth, ato shoqëroheshin nga elemente arkitektonike gjeometrike (si për shembull një pilastër që ngrihej pas figurës), gjë që përputhej me fjalorin vizual të lapidarëve. Në rastin e *Nënës Shqipëri*, figura njerëzore është njëkohësisht e vetmuar dhe zë vendin e kompleksit gjeometrik, duke u shndërruar në një farë mënyre në një lapidar (do t'i rikthehem kësaj pike më poshtë).

Puna mbi monumentin *Nëna Shqipëri* u zhvillua gjatë një periudhe të pasur me aktivitete kulturore. Gjatë viteve 1966–1969, qeveria shqiptare u përqendrua në implementimin e ndryshimeve të gjera politike dhe kulturore (bazuar pjesërisht në Revolucionin Kulturor të

Maos).<sup>15</sup> Siç u shpreh vetë Enver Hoxha, “Revolucionarizmi i mëtejshëm i jetës së vendit nuk mund të kuptohet pa zhvillimin e pa thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor.”<sup>16</sup> Këto zhvillime ideologjike dhe kulturore përfshinë edhe ndërtimin e një numri mbresëlënës monumentesh të reja për t'u përfunduar në vitin 1969, me rastin e 25-vjetorit të çlirimit nga pushtuesit fashistë. Mes veprave të artit që ishin duke u përgatitur, qe Monumenti i Katër Heronjve të Mirditës, Monumenti i Heronjëve të Vigut [ALS-575], dhe Monumenti i Musqetasë [ALS-504].<sup>17</sup> Treshja e skulptorëve që po punonin mbi monumentin *Nëna Shqipëri* po punonin gjithashtu edhe mbi Monumentin e Pavarësisë [ALS-460]. Fillimisht, edhe ky monument qe planifikuar për t'u përfunduar brenda vitit 1969,<sup>18</sup> por nuk u përfundua deri në vitin 1972, të njëjtin vit që u përfundua monumenti *Nëna Shqipëri*. Gjatë “revolucionarizimit të mëtejshëm” të vendit, që ndodhi midis fundit të viteve 1960 dhe fillimit të viteve 1970, kishin filluar të qarkullonin një sërë idesh që ndryshuan pritshmëritë e popullit të thjeshtë dhe të zyrtarëve të partisë sa i përket domethënies së skulpturës monumentale dhe përkujtimore dhe rolit të saj në Jetën e Re të Shqipërisë socialiste. Më poshtë do të trajtoj pikërisht këto ide dhe ligjërata, të dokumentuara si në materiale arkivore ashtu edhe në botime, në përpjekje për të kuptuar raportin midis monumentit *Nëna Shqipëri* dhe programit social dhe kulturor të regjimit Hoxha në përgjithësi.

### 3. Skulptura monumentale përkujtimore dhe shoqëria gjatë viteve 1960 dhe 1970 në Shqipëri

*Pse Nëna Shqipëri?* Ndonëse në skulpturën monumentale shqiptare ekzistonin ndërkaq precedentë sa i përket afinitetit midis figurës femërore – e asaj të nënës në

- 13 Po aty. Ka të ngjarë që arsyeja pse versionet e para të *Nënës Shqipëri* i kujtuan Shehut një “balerinë” është poza e figurës, që qëndronte me këmbët e puthitura tekta era që frynte i ngrite lart fustanin rreth pulapve, dhe krahët e shtrirë në formë V-je. Për të parë imazhe të disa prej versioneve të para të statujës *Nëna Shqipëri*, së bashku me format e flamujve, shih Faja, “Jetëgjatësia e simboleve në arkitekturë,” f. 38–9. Versioni me partizanin para flamujve gjithëpërfshirës u përdor më pas për varrezat e dëshmorëve në Kukës [ALS-561]. Figura e partizanit u krijua nga skulptori Halim Beqiraj, që hyri në konkursin kushtuar 25 vjetorit të Çlirimit. Shih “Si një shqiponjë,” *Drita*, 21 shtator 1969.
- 14 Enver Faja kujton gjithashtu se si anëtarët e tjerë të grupit pranë Universitetit të Tiranës ishin të pakënaqur me vendimin, që me sa duket e konsideruan konservativ dhe të pafrymëzuar (“Jetëgjatësia e Simboleve në Arkitekturë,” f. 39). Megjithatë, të paktën në materialet e botuara, nuk rezultojnë të ketë patur kritika të hapura ndaj versionit përfundimtar të monumentit apo të kompleksit të varreza – padyshim për shkak të ndërhyrjes së Hoxhës në vendimmarrje mbi këtë çështje. Siç dëshmojnë kujtimet e Dhramit, Fajës dhe Kolevicës (po aty, f. 144), vendimi për projektin final të kompleksit të varreza përsëriti debatin e vazhdueshëm gjatë viteve të diktaturës së Hoxhës mbi ndikimin e modernizmit në artin dhe letërsinë shqiptare. Megjithatë, nëse vendimi për figurën e vetmuar të Nënës Shqipëri ishte një kthim prapa nga modernizmi, është e pakundërshtueshme se disa elemente moderniste u rifutën në figurën përfundimtare të Ramës, Hadërit dhe Dhramit.

- 15 Këto politika theksonin zhdukjen e praktikave fetare dhe emancipimin e grave. Shih: Peter Prifti, *Socialist Albania Since 1944: Domestic and Foreign Developments* (Cambridge, MA: MIT Press, 1978), f. 143–49.
- 16 Enver Hoxha, *Mbi Letërsinë dhe Artin*, f. 241. Më duhet të sqaroj se nuk kam gjetur ndonjë dokument që vërteton se zgjedhja e figurës alegorike të Nënës Shqipëri u bë pikërisht pasi ajo përputhej me politikat apo ideologjitë pjesë e Revolucionit Kulturor të Hoxhës. Vrojtimet e mia të mëpashme kanë për qëllim thjeshtë të orientojnë leximin e monumentit në kontekstin e rrymave të reja në fushën e kulturës, jo të argumentojnë se brendësia e këtij monumenti qe tërësisht një produkt i këtyre rrymave.
- 17 Në një dokument të nënshkruar nga Hoxha që mban datën 19 shtator 1968, identifikohen nëntë projekte madhore, ku përfshihen monumentet e sipërpërmendura si dhe përfundimi i bazamentit në gur të monumentit *Nëna Shqipëri* në Varrezat e Dëshmorëve në Tiranë (ndonëse përfundimi i vetë monumentit nuk përmendet). Shih “Vendim: Mbi Vendosijen e Disa Monumenteve, Busteve, dhe Përmendoreve me Rastin e 25-Vjetorit të Çlirimit të Atdheut,” AQSH, f. 511 v. 1968 d. 49, fl. 1.
- 18 “Informacion mbi Masat për Ngritjen e Monumentit të Lirisë në Qytetin e Vlorës,” AQSH, f. 490, v. 1967, d. 521, fl. 5.

veçanti – dhe entit kolektiv që ishte kombi dhe idealeve të tij, cila ishte domethënia dhe rëndësia e këtij raporti në këtë moment të historisë shqiptare?

Do të ishte ndoshta më e thjeshtë po të fillonim duke iu përgjigjur në tjetër pyetjeje, që megjithatë lidhet me të parën: pse jo një partizan si figura qendrore që përfaqëson të rënë e kombit? Për shumë arsye, fakti se Enver Hoxha pëlqeu më tepër Nënë Shqipëri se figurën e partizanit i paraprin një sërë idesh të shtruara nga piktori Kujtim Buza (së bashku me historianin Kleanth Dedi) në fillim të viteve 1970, ide të cilat adresojnë si problematikën estetike të ndërtimit dhe vendosjes së monumenteve dhe përmendoreve ashtu edhe atë ideologjike të raportit midis të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes së kombit. Në vitin 1970, Buza dhe Dedi nxorën një raport mbi problemet dhe kriteret për zhvillimin e skulpturës publike përkujtimore. Më pas Buza publikoi një artikull në gazetën *Drita* ku përvijon disa prej shqetësimeve të tij, në veçanti në lidhje me bollëkun e varrezave të dëshmorëve që u ndërtuan me rastin e përvjetorit të Çlirimit dhe të skulpturave që gjendeshin në to. Ai shpjegon në këtë artikull se këto skulptura duhet

të shprehin njëkohësisht edhe nderimin karshi të rënëve por edhe të mbajnë në vetvete atë notë optimiste që karakterizoi luftëtarët e Luftës nacionalçlirimtare, që të shprehin gjithashtu se ëndërra për të cilën ata luftuan dhe dhanë jetën është kthyer në realitet, se Shqipëria socialiste [...] marshon përpara nga fitorja në fitore.<sup>19</sup>

Megjithatë, vizualizimi i kësaj ëndërrë nënkuptonte ndërtimin e skulpturave që nuk përqendroheshin ekskluzivisht tek figura e partizanit; Buza e shihte përhapjen e figurave të partizanëve në varrezat e dëshmorëve si një pengesë ndaj shprehjes së vërtetë të së tashmes revolucionare të vendit. Buza dhe Dedi e artikuluan këtë ide akoma më qartë në raportin e tyre të vitit 1970:

Kështu del sikur partizanet e rënë dhe gjithë deshmoret i nderon vetem partizani duke minimizuar kohen e nderimit dhe betimit për fitore të reja, sikur kjo i takon vetem partizanit ne ditet e luftes dhe jo gjithë popullit sot ne lufte për beteja të reja për ndërtimin e shoqërisë socialiste.<sup>20</sup>

19 Kujtim Buza, "Skulptura në Varrezat e Dëshmorëve," *Drita*, 15 gusht 1971.

20 Kujtim Buza dhe Kleanth Dedi, "Disa Probleme dhe Masa për të Ngritur me Kriteret më të Drejta Monumentet, Përmendoret, Bustet, Lapidarët dhe Pllakat Përkujtimore," *AQSH f. 511*, v. 1970, d. 86, fl. 20. Ë-të janë përdorur në mënyrë të parregullt në tekstin original.

Çështja e partizanit si përfaqësuesi i luftës kolektive të kombit nuk ishte thjesht një problem simbolesh – ai ishte gjithashtu një problem që kishte të bënte me *kohën*. Figura e partizanit ishte problematike jo vetëm sepse ajo (përgjithësisht, ai) ishte ca si tepër e kudo-ndodhur për shijet e Buzës, por sepse ajo nuk shprehte *vijimësinë* që i duhej "revolucionarizimit të mëtejshëm" të vendit. Skulpturat që zinin vendin qendror në varrezat e dëshmorëve duhet të artikulonin jo vetëm të kaluarën, por edhe vullmin e së tashmes drejt së ardhmes, ndërtimin e socializmit.

Vetë Enver Hoxha kishte shprehur pikërisht këtë ndjenjë në 1969, në një letër drejtuar Ramës, Hadërit dhe Dhramit në lidhje me punën e tyre mbi Monumentin e Pavarësisë së Vlorës. Në këtë letër, e cila u publikua në faqen e parë të gazetës *Drita*, Hoxha i mëshonte faktit se Monumenti i Pavarësisë nuk duhet thjesht të përkujtonte një ngjarje të kaluar, por gjith-ashtu edhe

sulmin përpara për të arritur caqe të tjera akoma më të rëndësishme, që të shihet në të se revolucioni ynë ecën përpara, është në ngjitje, imaginata e popullit të shohë në veprën [...] atë që ai realizoi në Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare, atë që po realizohet sot gjatë ndërtimit të socializmit.<sup>21</sup>

Besoj se ka gjasa që këto ide të jenë përfshirë nga treshja e skulptorëve në monumentin *Nëna Shqipëri*.

Këto debate rreth figurës së partizanit, dhe orvatjet për të gjetur një simbol i cili do të përlëvdonte të tashmen e Shqipërisë po aq sa të kaluarën e saj, koinçidian me shqetësimin mbi përfaqësimin e gruas në monumente.<sup>22</sup> Sekretari i Komitetit Qendror, Ramiz Alia, shprehet në një raport të vitit 1968 mbi zhvillimin e propagandës monumentale se "shumë e pakënaqëshme paraqitet gjendja lidhur me pasqyrimin e tematikës që ka të bëjë me trajtimin e femrës shqiptare", kryesisht për shkak të mungesës së tematikave të tilla në artin publik ekzistues. Ai këmbëngulte se ishte urgjente që gratë

21 Enver Hoxha, "Në Gurrën e Pashtershme e Jetëdhënëse të Krijimtarisë së Popullit, do të Gjejmë atë Frymëzim të Madh për të Realizuar Vepra të Bukura e Madhështore për Popullin Tonë," *Drita*, 13 korrik 1969. Për një diskutim më të detajuar të letërës dhe monumentit të Vlorës, shih Raino Isto, "In It We Should See Our Own Revolution Moving Forward, Rising Up": *Socialist Realism, National Subjecthood, and the Chronotope of Albanian History in the Vlora Independence Monument* (Master's Thesis, University of Maryland, 2014), 48–78.

Qëllimi ynë në këtë artikulli është të kontekstualizojmë lapidarin në Qukës–Pishkash, Librazhd, në kuadrin e rrethanave politike e sociale të kohës kur ai u krijua si dhe ato që vijuan. Nëpërmjet kësaj synojmë, pikë së pari, të prezantojmë monumentin; së dyti, të provojmë se lapidarët nuk ishin monumente statike por pika referimi për jetën socio-politike në qendrat e rajoneve dhe të vendit; së treti, do të përpiqemi të tregojmë se si regjimi komunist në Shqipëri, që e kuptonte rëndësinë e pelegrinazhit në praktikat fetare, tentoi të themelonte një fe politike nëpërmjet lapidarit në Pishkash, një pelegrinazh që përqendrohej tek teksti dhe kujtesa për të përkujtuar marshimin e dimirit të 1943–4 të Brigadës së Parë Sulmuese në zonën malore të Çermenikës, Librazhdit, Gramshit dhe Korçës, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të vendit. Për këtë arsye, kemi mbledhur të dhëna faktike dhe empirike rreth monumenteve dhe i kemi kombinuar këto me të dhëna socio-antropologjike nga studimi i pelegrinazhit.

Përpara se të paraqesim studimin tonë, duhet të shpjegojmë domethënien e termave që kemi përdorur në këtë artikull. Eade dhe Sallnow e kuptojnë pelegrinazhin si një “domen ligjëratash konkurruese”.<sup>1</sup> Për ta, “praktika e pelegrinazhit dhe fuqitë e shenjta të një faltoreje mar-rin formën e përfaqësimeve të larmishme dhe madje edhe konfliktuale” nga sektorë të ndryshëm brenda dhe jashtë komunitetit të kultit, që përqendrohen tek trashja “individ”, “vend”, dhe “tekst”.<sup>2</sup> Në një vëllim të mëvonët, Coleman dhe Eade shtojnë “lëvizjen” si një element i katërt në qendër të pelegrinazhit, duke arsyetuar se ajo “përfshin institucionalizimin (ndoshta zbutjen [*domestication*]) e lëvizjes në terma fizike, metaforike dhe/

1 John Eade dhe Michael Sallnow (red.), “Introduction,” *Contesting the Sacred: The Anthropology of Christian Pilgrimage* (Londër dhe Nju-Jork: Routledge, 1991), f. 5.

2 Po aty, f. 9.



Fig. 1 Perikli Çuli and Agim Rada, *Lapidar kushtuar marshimit të Brigadës së Parë Sulmuese*, gurë gëlqeror (1978)



Fig. 2 Perikli Çuli and Agim Rada, *Lapidar kushtuar marshimit të Brigadës së Parë Sulmuese, gurë gëlqeror (1978)*, detaj



Fig. 3 Perikli Çuli and Agim Rada, *Lapidar kushtuar marshimit të Brigadës së Parë Sulmuese, gurë gëlqeror (1978)*

ose ideologjike.”<sup>3</sup> Ndryshe nga studiuesit për të cilët pelegrinazhi ka një qëllim të posaçëm fetar,<sup>4</sup> përkufizimi ynë ndjek një tjetër trajktore: opinionin e Blasi-t për “objektivin themelor ose thujtse themelor” të një pelegrinazhi, me të cilin ndajmë besimin se “jo të gjitha pelegrinazhet janë fetare”.<sup>5</sup> Në këtë artikull, *pelegrinazhin do ta përkufizojmë si një vizitë në një vend të caktuar ku pjesëmarrësit ndajnë besimin se si udhëtimi ashtu edhe destinacioni fuqizojnë individin dhe grupin për të vendosur lidhje me një shkallë më të lartë të qenies dhe të meditojnë mbi çështje si jeta, vdekja e më tej*. Shumë studiues të pelegrinazhit e shohin domethënien e topos-it të tij të pasqyruar në vende në natyrë “që kanë tipare të spikatura si male, shpella, puse, burime lumenjsh, [...] pllaja”,<sup>6</sup> etj., që, për disa, “mbartin domethënien e të shenjtës”,<sup>7</sup> dhe “praninë e të mbinatyrshmes”.<sup>8</sup> Po aq i rëndësishëm është *udhëtimi për tek ose lëvizja drejt topos-it* të pelegrinazhit, shpeshherë qëllimisht i gjatë, i lodhshëm, dhe i rrezikshëm pasi ka si synim larjen e mëkateve dhe pen-

desën.<sup>9</sup> *Nisja*, e studjuar me themel nga Turner<sup>10</sup> dhe të tjerë,<sup>11</sup> dhe/ose *rituali* që kryhet në fillim, gjatë rrugës, dhe/ose në vendin e pelegrinazhit,<sup>12</sup> në përcaktimin tonë është një mjet fuqizimi për të vendosur lidhje me një shkallë më të lartë të qenies dhe për të medituuar rreth tematikave të jetës, vdekjes e më tej.

### 1. Lapidari në Qukës–Pishkash, Librazhd

Lapidari në fjalë ndodhet rreth 23 km në juglindje të qytetit të Librazhdit, në krahun e djathtë të autostradës Librazhd–Përrenjas, pas fshatit të Qukësit në kryqëzimin në hyrje të Pishkashit [ALS-38]. Monumenti (fig. 1) gjendet në fund të një kodre me një pemishte. Rruga për tek monumenti ka tre tarraca që e zbusin disi pjerrësinë e shpatit të kodrës dhe që harmonizojnë monumentin me lartësinë e pashmangshme natyrore. Monumenti arrihet nëpërmjet këtyre tarracave falë tri rradhë shkallësh.

Monumenti u krijua në vitin 1978 nga skulptori i mirënjohur Perikli Çuli dhe nga Agim Rada, një skulptor i ri që sapo kishte mbaruar Akademinë e Arteve.<sup>13</sup> Përzgjedhja e tyre u bë nëpërmjet një konkursi për krijimin e një vepre arti pikërisht në atë pikë, që ishte porositur nga qeveria qendrore. Monumenti u prodhua me gurë gëlqerorë të zonës.

Hapësira skulpturore konsiston në një yll partizan me pesë cepa ku janë gdhendur në relief skulpturat. Kjo është një zgjedhje interesante nga pikëpamja e kompozimit pasi ylli partizan nuk është thjesht sfondi i skulptu-

3 Simon Coleman dhe John Eade (red.), *Reframing Pilgrimage: Cultures in Motion* (Londër dhe Nju-Jork: Routledge, 2004), f. 17.  
 4 Luigi Tomasi, “Homo Viator: From Pilgrimage to Religious Tourism via the Journey,” në William H. Swatos dhe Luigi Tomasi (red.), *From Medieval Pilgrimage to Religious Tourism: The Social and Cultural Economics of Piety* (Westport, CT: Praeger, 2002), f. 3; f. 207.  
 5 Anthony Blasi, “Visitation to Disaster Sites,” në Swatos & Tomasi, *From Medieval Pilgrimage to Religious Tourism*, f. 159.  
 6 Victor W. Turner dhe Edith L.B. Turner, *Image and Pilgrimage in Christian Culture: Anthropological Perspectives* (Nju-Jork: Columbia University Press, 1978), f. 112.  
 7 Tomasi, “Homo Viator,” f. 10.  
 8 M.T. Loveland, “Pilgrimage, Religious Institutions, and the Construction of Orthodoxy,” *Sociology of Religion* 69.3 (2008), f. 320; sh. Stephen D. Glazier, “Caribbean Pilgrimages: A Typology,” *Journal for the Scientific Study of Religion* 22 (1983): f. 316–25; Mircea Eliade, *Patterns in Comparative Religion* (Cleveland, OH: World Publishing Co., 1963).

9 Tomasi, “Homo Viator,” f. 5–6.  
 10 Victor Turner, *The Ritual Process: Structure and Anti-Structure* (Chicago: Aldine, 1969).  
 11 Për shëmbull, shih: Arnold van Gennep, *The Rites of Passage* (Londër: Routledge, 2004).  
 12 Swatos & Tomasi, *From Medieval Pilgrimage to Religious Tourism*, f. 207.  
 13 Intervistë me autorin, 26 tetor 2014.



Fig. 4 Perikli Çuli and Agim Rada, *Lapidar kushtuar marshimit të Brigadës së Parë Sulmuese, gurë gëlqeror (1978)*

rave në relief, dhe “format e veta plastike e voluminoze” e bëjnë atë vetë të duket si një vepër arti.<sup>14</sup> Nuk gjejmë asnjë shembull tjetër në artin e realizmit socialist ku bazamenti i një reliefi të ketë formën e një ylli partizan, një simbol që shfaqet në shumë vepra arti por që asnjëherë nuk përbën një vepër arti në vetëvete.<sup>15</sup>

Megjithatë, dy cepat e poshtëm të yllit nuk u stolisën, dhe statuja u pozicionua në tri cepat e sipërm, duke krijuar idenë e një sinteze kompozicionale që ka formën e një ylli. Duke filluar nga pjesa në qendër të krahut të sipërm të yllit e deri tek pjesa në qendër të krahut të majtë të yllit (fig. 2) shohim figurat e 12 ushtarëve partizanë, një pjesë e të cilëve kanë një pozicion ballor kurse pjesa tjetër janë kthyer drejt krahut të djathtë të skulpturës, si dhe një mushkë të ngarkuar me municione. Ushtarët janë të pajisur me armë dhe me kapele kortezhi. Për të treguar se ushtarët po marshojnë në të njëjtin drejtim, figurat që ndodhen më lartë janë në bazorelief, në kundërshtim me figurat në qendër që duket sikur po e udhëheqin grupin drejt luftës.<sup>16</sup> Në qendër të krahut të sipërm të yllit shohim një mbishkrim me datën 1944. Po këto kritere në lidhje me subjektin, pozën, dhe kalimin nga bazoreliefi tek altoreliefi, i shohim edhe tek grupi i gjashtë ushtarëve që udhëhiqen nga një ushtar në qendër të yllit, si dhe tek grupi prej 11 ushtarësh në pjesën e sipërme të krahut të majtë të yllit (fig. 3), shumica e të cilëve marshojnë djathtas. Në pjesën e sipërme të krahut të majtë të yllit partizan, mbi një kalë të ngarkuar me municione, shohim grupin e katërt të ushtarëve, tri



Fig. 5 Perikli Çuli and Agim Rada, *Lapidar kushtuar marshimit të Brigadës së Parë Sulmuese, gurë gëlqeror (1978)*

prej të cilëve janë në ballore ndërsa i katërti ka kthyer kokën djathtas. Të 27 ushtarët janë të armatosur deri në dhëmb, disa prej tyre i kanë kapur pushkat nga rripi, kurse të tjerët i kanë hedhur pushkat mbi supe si çobanët kërrabat. Asnjë prej ushtarëve nuk e ka drejtuar shikimin drejt vizitorëve, përkundrazi, seriozë e të vendosur pavarësisht marshimit të tyre jo-ceremonial drejt luftës, ata e kanë drejtuar shikimin përmbi kokat e vizitorëve.

Zgavra e krahut të djathtë në pjesën e sipërme të yllit ndan hapësirën dhe atmosferën skulpturore (fig. 4); në fakt, të gjithë ushtarët janë duke marshuar drejt këtij krahu. Këtu skulptorët vendosën të paraqesin fushën e betejës: gjashtë ushtarë me pushkë në dorë të rreshtuar; disa prej tyre janë duke qëlluar mbi armikun, kurse pjesa tjetër janë gati për të shtënë ose, në pamundësi, gati për t'u ndeshur trup-më-trup. Armiku, që në fakt nuk e shohim, do të duhej të kishte qenë pak më djathtas. Kjo teknikë, që thekson tensionin e një momenti të fuqishëm pikërisht duke mos shfaqur armikun, është trashëguar nga arti i Rilindjes, si për shembull statuja e Davidit të Michelangelo-s.

Episodet e ndryshme për të cilat flasin grupet e ushtarëve janë mjaft të kapshme dhe të kuptueshme, dhe mund të transmetohen në mënyrën më të thjeshtë. 33 ushtarë, 31 burra dhe 2 gra, marshojnë drejt frontit të betejës, për të përforcuar 6 ushtarët, 5 burra dhe 1 grua, që ndodhen aty. Mbishkrimi (fig. 5) nën krahun e djathtë në pjesën e poshtme të monumentit të monumentin nuk lë vend për dyshim mbi ngjarjen të cilës skulptura i referohet. Ndarë në dy rreshta, me përjashtim të fjalës së parë që është dyfish e lartë, gdhendur me shkronja të mëdha, shkruhet: “LAVDI BRIGADES [SE] PARE | HEROIKE SULMUESE”.

14 Gogollari Dhimo, “Një Vepër e Re e Skulpturës Monumentale,” *Drita* (27 gusht 1978), f. 7.

15 Po aty.

16 Gogollari argumenton se, bazuar në atmosferën e qetë, kemi të bëjmë me një pamje pas përfundimit të luftës (“Një Vepër,” f. 7). E megjithatë, kjo nuk shpjegon pse shumica e ushtarëve e kanë kthyer kokën djathtas, d.m.th. në drejtimin e fushës së betejës.





Fig. 6 Kompleksi i shtëpive në Galigat, Gramsh, ku u strehua Enver Hoxha. Kasollja e Galigatit, që dikur ka qenë monument kulture i mborjtur nga shteti nuk ekziston më, pasi u shkatërrua nga vetë pasardhësit e fshatarëve që mikpritën Enver Hoxhën.

## 2. Konteksti ekonomiko-social i monumentit

Monumenti hyn tek iniciativat e elitës komuniste të fundviteve 1970 me qëllim përvetësimin e hapësirave natyrore dhe simbolike, duke krijuar pika referimi sociale dhe duke “kultifikuar” figurat e larta të Partisë si Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu. “Kasollja e Galigatit” (fig. 6), versioni shqiptar i kasolles Razliv dhe hangarit të N. Emelyanov, ku u strehua Lenini në fund të verës së 1917, është një shembull i mirë i këtij fenomeni.<sup>17</sup> Galigati është një fshat në zonën malore të Gramshit, ku Enver Hoxha gjeti strehim në kasollen e Ymer Çohës në fillim të vitit 1944, dhe për të cilën Artisti i Popullit Avni Mula kompozoi një këngë për vargjet “Galigat, Galigat, kurrë nuk do ta harroj zemrën e ngrohtë e të zjarrtë.”<sup>18</sup> Sipas banorëve të zonës, ditën e lindjes së Enver Hoxhës (16 tetor 1908), delegacione nga shkollat e Elbasanit, Gramshit dhe fshatrave rrethuese marshonin drejt kasolles, që mbrohej nga shteti si Monument Kulture, për të mbajtur fjalime, për të kënduar këngë, për të recituar vjersha, d.m.th. një ritual i ngjashëm me një pelegrinazh fetar.

Gjatë viteve 1970, Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu hodhën në letër kujtimet e tyre të luftës antifashiste<sup>19</sup>; mbi të cilat u bazuan një sërë librash me kujtime të Enver Hoxhës që u botuan në fillim të viteve 1980 (p.sh. *Kur lindi Partia*, 1981; *Kur u hodhën themelet e Shqipërisë*

*së re*, 1984; *Mes njerëzve të thjeshtë*, 1984), ndonëse emri dhe roli i Mehmet Shehut nuk përmendeshin pasi në vitin 1981 ai u diskreditua si agent i dyfishtë dhe u detyrua të vriste veten. Në fakt, emri i tij u hoq nga të gjitha botimet dhe regjistrat. Në librin e dytë diskutohet gjerë e gjatë dimri vendimtar i vitit 1943, kur luftëtarët komunistë të Brigadës së Parë Sulmuese ku bënte pjesë edhe Enver Hoxha, mbetën të bllokuar nga i ftohti polar në zonën malore të Çermenikës, Librazhdit, Gramshit dhe Korçës,<sup>20</sup> ndërsa gjysma e librit të tretë i kushtohet takimeve të thjeshta me partizanët dhe fshatarët e zonave malore ku kaloi Brigada, si për shembull Kasollja e Galigatit.

Në janar të vitit 1979, Kryeministri Mehmet Shehu, komandanti i Brigadës së Parë Sulmuese dimrin e vitit 1943, urdhëroi rezervistët e Brigadës të ri-inskenonin itinerarin e dimrit 1943 në formën e një “aksioni” ushtarak. 1500 rezervistë u mobilizuan në një stërvitje ushtarake të ngjashme me një pelegrinazh në gjurmët e Brigadës së mëhershme. Për shkak të kushteve të rënda klimatike, keqorganizimit dhe logjistikës së dobët, si dhe mungesës së planeve të sigurisë, katër veta humbën jetën dhe dhjetra të tjerë u dëmtuan. Të tjerë u qortuan rëndë dhe madje u ndëshkuan nga Mehmet Shehu, pasi nuk e treguan veten të denjë për historinë e Brigadës; për më tepër, ata u detyruan ta ripërsërisnin marshimin katër javë më pas, një udhë që u anulua në momentin e fundit nga Enver Hoxha për shkak të situatës së tensionuar që kishin krijuar ngjarjet e rënda që ndodhën gjatë marshimit të parë.<sup>21</sup>

Lapidari në Qukës–Pishkash, që përfundoi në vitin 1978, është një ndër përpjekjet e Mehmet Shehut për të rijetëzuar dhe “kultifikuar” kujtesën e Brigadës së Parë Sulmuese që ai e kishte udhëhequr personalisht. Në korrik të vitit 1978,<sup>22</sup> ndarja e zvarritur prej kohësh mes Kinës dhe Shqipërisë kishte arritur pikën e saj kulmore, dhe Shqipëria po hynte në një periudhë të gjatë vetizo-

20 Enver Hoxha, *Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re: Kujtime dhe shënime historike* (1984): [http://enver-hoxha.net/librat\\_pdf/shqip/kur\\_u\\_hodhen.pdf](http://enver-hoxha.net/librat_pdf/shqip/kur_u_hodhen.pdf)

21 Shih Skifter Këllici, “Shkatërrimi i Brigadës së Parë Sulmuese në Marshimin e Vitit 1979 dhe Ndëshkimet e Mehmet Shehut,” *Gazeta Dita* (21–25 shkurt 2013), në <http://gazetadita.al/shkaterrimi-i-brigades-se-pare-sulmuese-ne-marshimin-e-vitit-1979-dhe-ndeshkimet-e-mehmet-shehut/>, <http://gazetadita.al/marshimi-i-zi-banoret-e-fushe-studes-na-hapen-portat-e-shpetuan-dhjetera-jete-njerezish-gjysme-te-ngrire/>, <http://gazetadita.al/fillim-shkurti-1979-si-u-shpartallua-brigada-e-pare-dhe-si-humben-jeten-4-veta-gjate-marshimit/>, <http://gazetadita.al/mehmet-shehu-kercenon-1500-rezervistet-turperuat-emrin-e-brigades-heroine-do-shkoni-ne-burg/> and <http://gazetadita.al/perplasia-per-marshimin-e-zi-enver-hoxha-anulon-urdhrin-e-mehmet-shehut-per-perseritjen-e-tij/>

22 Enver Hoxha, *Shënime mbi Kinën*, 2 (Tirana: 8 Nëntori, 1979), f. 715.

17 Cecelia Bobrovskaya, *Lenin's Road to the October Revolution* (Londër: Modern Books Limited, 1932), f. 42–3.

18 Shih Enver Hoxha, *Mes njerëzve të thjeshtë* (Tiranë: 8 Nëntori, 1984), f. 275–99.

19 Cf. Konstantinos Giakoumis, “From Religious to Secular and Back Again: Christian Pilgrimage Space in Albania,” në J. Eade and M. Katić, *Pilgrimage, Politics and Place-Making in Eastern Europe: Crossing the Borders* (Londër: Ashgate, 2014), f. 103–18, dhe Konstantinos Giakoumis, “An Enquiry into the Construction, Deconstruction, Transubstantiation and Reconstruction of Christian Pilgrimages in Modern Day Albania,” *Ημερολόγιο* 32 (2013), 267–318.



limi; prej vitit 1978, Kina, një aleat mjaft i rëndësishëm tregtar dhe teknologjik i Shqipërisë qysh prej ndarjes së Shqipërisë me BRSS, nuk kishte dërguar më specialistë në Shqipëri dhe kishte pezulluar të gjitha marrëveshjet ekonomike dhe ushtarake.<sup>23</sup> Për të parandaluar ndonjë pakënaqësi që mund të ndjehej për shkak të largimit të papritur të Kinës, dhe për të përgatitur popullin për udhën e dhimbshme të një autarkie të vetimponuar, Mehmet Shehu dhe Enver Hoxha u detyruan t'i riktheheshin historisë së vonët komuniste për të mbrojtur ngjarjet ku forcat më të vogla partizane kishin mundur forcat më të mëdha e më të fuqishme të ushtrisë gjermane, me mesazhin “mund t'ia dalim vetë(m)”.

Kjo nuk ishte një gjë e lehtë. Në fund të viteve 1970, brezi që i kishte rezistuar fashizmit, të paktën ata që kishin mbetur nga rradhët e partizanëve komunistë, po plakeshin. Brezi i ri nuk kishte një lidhje të drejtpërdrejtë me këto ngjarje. Pra, këto “faqe” të së kaluarës duhet të merrnin një domethënie të re për brezin e ri, dhe kjo ishte arsyeja pse u krijua pelegrinazhi i ri i tekstit-dhe-kujtesës. Lapidari që jemi duke shqyrtuar patjetër që ishte një pikë ku u zhvilluan rituale të ndryshme të lidhura me komunizmin që e shfrytëzonin atë si qendër pelegrinazhi. Siç do të tregojmë më poshtë, problemi i shkyçjes së ngjarjeve të së kaluarës me brezin e ri është i vjetër sa vetë krishtërimi, që shpeshherë shërbente si model.<sup>24</sup>

### 3. Origjinat të krishtera të pelegrinazhit të përqëndruar tek teksti dhe kujtesa

Qysh në fillimet e tij, mësimi i krishterë e kishte kuptuar se ata që ishin pagëzuar në Krishtin ishin “veshur me Krishtin” (*Gal. 3:27*). Megjithatë, kjo paraqiste një problem, pasi pjesa dërrmuese e rritjes dhe zhvillimit të krishtërimit kishte ndodhur pas jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Krishtit, dhe, pra, gjatë një periudhe ku ai – themeltari dhe udhëheqësi i tyre – nuk ishte më i pranishëm, as fizikisht e as historikisht. Problemi u ndërlikua edhe më tepër pas vdekjes së Dishepujve dhe dëshmitarëve të tjerë okularë. Në fund, çështja u zgjidh me arsyetimin se besimtarët mund të merrnin pjesë në mënyrë të menjëhershme, ndonëse mistike, në jetën e Krishtit nëpërmjet sakramenteve të Kishës (*mysteria*), dhe kësaj të identifikoheshin me të. Patjetër që kjo u pasqyrua rrënjësisht në mësimin e Palit se të krishterët ishin “gjymtyrë” të trupit të Krishtit, por edhe nga vetë Krishti, që deklaroi se ai ishte një “hardhi” prej nga ndjekësit e tij do të mbinin si “shermend” (*Rom. 12:5; 1 Kor. 12;*

*Gjoni 15:1–8*). E thënë ndryshe, për shkak të mungesës fizike të Krishtit, të krishterët i konsideronin sakramentet si një mjet mistik për t'u bërë përjetësisht pjesë e jetës së tij; po nëpërmjet tyre ata identifikoheshin me Krishtin dhe bashkoheshin me të.<sup>25</sup> Me kalimin e kohës, kjo u shndërrua në një medium të fuqishëm nëpërmjet të cilit të gjithë brezat e mëpasshëm mund të kishin pronësi të barabartë mbi jetën e Krishtit, punën e tij, dhe mësimet e tij: dhe kjo vlente – sipas *Letrës drejtuar Hebrejve* – “njëherë për të gjithë” (*Heb. 10:10*).

Kjo perspektivë e përjetshme mbi jetën dhe punën e Krishtit hapi rrugën për një qasje të sofistikuar simbolike ndaj të gjitha riteve dhe ritualeve kristiane, gjë që manifestohet më qartë në kremtimin e Kungimit. Ndërkaq, Kungimi bazohej edhe tek motive në tekstin biblik, ku Krishti udhëzon dishepujt e tij: “bëni këtë në përkujtimin tim” (*Luka 22:19*). Kujtesa e Krishtit si një figurë qendrore e kremtimit të Kungimit u bë shkak që me kalimin e kohës të krishterët ta identifikonin vetë ritualin e Kungimit me jetën dhe punën e Krishtit në mënyra të posaçme dytësore e ilustrative. Liturgjisti i mirënjohur ortodoks Fr. Alexander Schmemmann ka argumentuar se këto tendenca janë simptomë e degradimit të simbolit si një manifestim i fuqishëm e i menjëhershëm i realitetit,<sup>26</sup> por kjo megjithatë nuk anulon faktin se aspekti ilustrativ i elementeve të ndryshme të riteve dhe ritualeve të Krishtërimin Lindor në fakt e përforconte ndjesinë e pjesëmarrjes së përjetshme mes komunitetit të besimtarëve dhe shpëtimtarit të tyre, Krishtit. E gjithë kjo u bë shkak më vonë për një pelegrinazh statik e të përjetshëm ku pjesëmarrësit, duke ri-inskenuar dhe rijetuar ngjarjet e jetës së Krishtit në mënyrë të drejtpërdrejtë, përpiqeshin të bëheshin pjesë e atyre ngjarjeve tek të cilat nuk kishin qenë historikisht dhe fizikisht të pranishëm.<sup>27</sup>

25 Për një shpjegim më të detajuar se si ortodoksët mendojnë që marrin pjesë dhe ndajnë jetën e Krishtit shih: Behr John, *The Mystery of Christ: Life in Death* (Crestwood: svS, 2006).

26 Kritikat e Schmemmann-it mbi qasjen ilustrative ndaj liturgjisë mund t'i gjeni këtu: Alexander Schmemmann, *The Eucharist: Sacrament of the Kingdom*, përkth. Paul Kachur (Crestwood: svS, 2003), f. 38–40.

27 Gabrielle Spiegel ka shkruar një tekst të shkëlqyer në të cilin bën një lidhje të ngjashme midis përodimit të liturgjisë nga hebraizmi dhe efektin e kësaj mbi kohën. Ai shpjegon se “... për hebrejtë, eksperiencia historike bëhet pjesë e ri-inskenimit ciklik të ngjarjeve paradigmatiche në ritualin e shenjtë hebraik. Eksperiencat e vonëta apo ato bashkëkohore marrin kuptim vetëm për sa kohë që ato mund të përfshihen në kategoritë biblike të ngjarjeve dhe interpretimi i tyre mund t'i kalohet komunitetit të besimtarëve nëpërmjet Shkrimeve të Shenjta, që do të thotë, vetëm për sa kohë që ato mund të shndërrohen, nëpërmjet ritualeve dhe liturgjisë, në përsëritje dhe ri-inskenime të ngjarjeve antike. Në përkujtime liturgjike të kësaj natyre, e kaluara ekziston vetëm nëpërmjet recitimeve, dhe qëllimi i këtij recitimi është që e kaluara të jetojë sërish në të tashmen, që e kaluara dhe e tashmja të shkrihen, recituesi dhe dëgjuesi, në një ent të vetëm kolektiv.

23 Elez Biberaj, *Albania and China: A Study of an Unequal Alliance* (Boulder, CO: Westview Press, 1986), f. 134–5.

24 Giakoumis, “From Religious to Secular,” f. 112–13 dhe Giakoumis, “An Enquiry,” f. 299–301.

Gjë që mundësoi ndjenjën e pronësisë dhe përforcoi identitetin kristian dhe lidhjen midis besimtarëve të të gjitha kohrave.

Për më tepër, kjo qasje simbolike dhe ilustrative ndaj jetës së Krishtit u përhap më pas edhe në praktika të tjera, si kortezhi i *epitaphios* (qefinit të vdekjes) mbremjen e së Premtes së Madhe dhe pelegrinzhi në faltoret e shenjtorëve të ndryshëm të krishterë. Kësisoj, pelegrinazhi pasqyrore dëshirën e komunitetit të besimtarëve për të ndarë jetën dhe ndodhitë e heronjve të kristianizmit, duke i ri-inskenuar ato pafund. Kjo u mundësua falë një procesi të hollë teksti dhe kujtese, por shpesh edhe nëpërmjet afërsisë me objektet ose vendet që konsideroheshin të rëndësishme ose të shenjta nga besimtarët.

#### 4. Përvetësimi i pelegrinazhit të krishterë nga regjimi komunist i Shqipërisë

Regjimi komunist i Enver Hoxhës është përgjegjës për ndalimin e fesë në vitin 1967. I mbështetur nga pikëpamjet markstiste-leniniste mbi fenë, Enver Hoxha përvetësoi qëndrimet radikale maoiste të Revolucionit Kulturor mbi çështjen e fesë. Gjatë viteve 1966–7, regjimi ndërmori një nismë sistematike për të shkatërruar të gjitha zakonet dhe monumentet fetare, si mbeturina të prapambetjes së vendit; njëkohësisht, u ndaluan të gjitha aktivitetet fetare dhe Shqipëria u vetëdeklarua vendi i parë ateist në botë (Neni 37 i Kushtetutës së vitit 1976).<sup>28</sup>

Ajo që është e habitshme është fakti se shteti komunist, në vend që të shkatërronte gjithçka që i ngjante fesë, ndryshoi përmbajtjen e pelegrinazheve të krishtera dhe i shndërroi ato në pelegrinazhe komuniste, duke ruajtur formën, strukturën dhe tipologjinë e tyre, duke kapërcyer kështu pengesa të ngurta idologjike.<sup>29</sup> Në botimin e dytë të *Historisë së Partisë së Punës së Shqipërisë*, që u përgatit në vitin 1981 nën censurën maksimale, i kushtohet një seksion “lëvizjes kundër fesë, kundër pa-

ragjykimeve fetare dhe zakoneve prapanike”, në kuadrin e luftës së Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit (1966–1971).<sup>30</sup> Duke iu referuar radikalizimit të politikave të Partisë komuniste ndaj aktiviteteve fetare pas vitit 1967, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, pohoi me guxim se jo vetëm që bindjet dhe botëkuptimet fetare nuk ishin çrrënjësuar për shkak të rezistencës së besimtarëve, veçanërisht në zonat rurale, por edhe se kjo nuk do të arrihej dhunshëm për të mos “fyer ndjenjat e një masë punonjësish”, dhe se partia komuniste po ndiqte politikën e asimilimit të festave dhe zakoneve fetare duke i dhënë atyre normat dhe aromën e përmbajtjes socialiste.

Ka disa ngjashmëri shastisëse midis kësaj politike dhe mënyrës se si në epoka të mëparshme Krishtërimi ishte përpjekur të ndryshonte përmbajtjen e paganizmit duke ruajtur format e tij, siç evidentohet (dhe ka shumë të tillë<sup>31</sup>) në një letër të Papës Gregor I (v. 604) abatis Mellitus, siç paraqitet në historinë kishtarë të Shën Bedës i Nderuari (v. 735). Këto ngjashmëri bëhen edhe më të dukshme nëse e lexojmë këtë letër përbri një pasazhi nga *Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*:

Nuk duhen shkatërruar tempujt (*fana*) e idhujve në mesin e asaj popullsie, por vetë idhujt që janë brenda tyre. Le të bekohet uji e të spërkatet në këta tempuj, le të ndërtohen altarë brenda tyre e të vendosen relike. Sepse nëse ata tempuj janë ndërtuar mirë, duhet të ndryshojnë nga kulturi i demonëve në adhurimin e Zotit të vërtetë, në mënyrë që, teksa ajo racë e sheh me sytë e saj që tempujt e saj nuk po shkatërrohen, ndoshta do ta çrrënjësonte gabimin në zemrat e njerëzve, dhe duke njohur dhe adhuruar Zotin e vërtetë, ata mund të mblidhen bashkë në vendet e tyre të zakonshme më miqësisht. Dhe meqë ata janë mësuar të vrasin shumë buaj (*boves*) gjatë sakrificimeve për demonët e tyre, duhen ndryshuar disa rite solemne për ta mbi këtë pikë. Kështu ditën e përkushtimit, ose ditën e festivaleve të dëshmorëve hyjnorë, reliket e të cilëve janë vendosur në tempujt që janë shndërruar në kisha, ata duhet të ndërtojnë kasolle rreth këtyre kishave me degë pemësh, dhe duhet të kremtojnë festivalin me një gosti fetare. Mos i lejoni të sakrifkohen kafshë për djallin, por lëroni të therin kafshë dhe t'i hanë për lavdinë e Zotit... Padyshim që jo gjithçka mund të hiqet nga mendjet e tyre kokëforta menjëherë...

Historia, sipas mënyrës që e kuptojmë ne, që konsiston në ngjarje unike që shpalosen në një kohë lineare të pakthyeshme, përthithet në kujtesën ciklike liturgjike.” Shkëputura nga, “Memory and History: Liturgical Time and Historical Time,” *History and Theory* 41 (maj 2002), f. 149–62.

28 Enver Hoxha, *Vëpra*, 35 (Tiranë: Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH), f. 103–13; cf. Neni 55 i Kushtetutës së vitit 1976.

29 Polina Tserkassova që trajton një temë të ngjashme nga Estonia (Polina Tserkassova, “Sterilisation and Reconstruction of the Places of Secular Pilgrimages: Moving Monuments, Meanings and Crowds in Estonia,” në John Eade dhe Mario Katic, *Pilgrimage, Politics and Place-Making in Eastern Europe: Crossing the Borders* [Londër: Ashgate, 2013], k. 5) parapëlqen përdorimin e termit “pelegrinazh laik” në ato raste ku unë kam përdorur “pelegrinazh komunist” dhe termat “sterilizim” dhe “rishenjtërim” aty ku unë kam përdorur “dekonstrukcion” and “rikonstrukcion.”

30 Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, *Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*, bot. i 2-të (Tiranë: 8 Nëntori, 1981), f. 430–3.

31 Për një shembull tjetër, shih *Levitiku* 17:1–9.

Kështu Zoti bëri izraelitët e Egjiptit me dije për ekzistencën e tij; megjithatë ai ruajti tek adhurimi i tij format e sakrificës që ata ishin mësuar t'i ofronin djallit, dhe i urdhëroi të vrisnin kafshë kur të sakrifikonin për të (*Levitiku 17:1–9*). Kësisoj ai ndryshoi zemrat e tyre... dhe meqë populli po ia ofronte ato Zotit të vërtetë dhe jo idhujve, ato nuk mund të quheshin të njëjtat sakrifica.<sup>32</sup>

Partia dhe shteti nuk ndaluan besimet fetare, [...] ndonëse në thelb reacionare [...]. Partia nuk mund të fyente ndjenjat e një mase punonjësish. Sidomos në fshat, që ishin lidhur ngushtë me Partinë dhe me pushtetin popullor, por që vazhdonin të besonin në njërën ose tjetrën fe, megjithëse nuk tregonin ndonjë fanatizëm të tepruar. Çrënjësja e botëkuptimit fetar do të vinte si pasojë e bindjeve ideologjike të masave. [...] *Shqipëria u bë kështu vendi i parë në botë pa kisha e pa xhami, pa priftërinj e pa hoxhallarë*. Duke mbështetur lëvizjen popullore të luftës kundër fesë, kundër paragjytimeve fetare dhe zakoneve prapanike, Partia udhëhiqte atë me kujdes. Ajo nuk lejonte të bëheshin shtrembërime dhe mënjanoi me kohë çdo veprim të nxituar e të pabazuar në vullnetin e masës së popullsisë. Ajo e orientoi popullin që të kremtet dhe zakonet e tjera të lidhura me fenë t'i zëvendësonte me festa, me zakone e me norma të reja mepërmbytje socialiste. Aksionet e masave për prishjen e bazave të fesë u shoqëruan me një punë të dendur sqaruese dhe ateisto-shkencore të Partisë. [...] Zhdukja e kishave dhe xhamive nuk e kishte zhdukur fenë si botëkuptim. Feja i ka rrënjët shumë të thella. Ajo është përzier, është lidhur [...] me zakonet prapanike që e kanë burimin ndër shekujt e largët, [...] “Ne duhet të jemi realistë, – mësonte shoku Enver Hoxha, – lufta kundër zakoneve, traditave, normave të vjetra, kundër botëkuptimeve fetare [...] nuk ka marrë fund. Kjo është një luftë e gjatë, e ndërlikuar dhe e vështirë.”<sup>33</sup>

Ballafaqimi i tyre vë në pah pesë pika të spikatura të përbashkëta:

1. Shkatërrimi i pjesshëm ose lustrimi i zakoneve të vjetra (idhujt ose kishat).
2. Kalimi i “adhurimit” nga “kulti i demonëve” ose “reagimi” (tjetërkund quhet “helm”, “prapambetje”, “ideologji e klasave shfrytëzuese”, “armiku i socializmit”,

32 Bede, *Ecclesiastical History of the English People*, Introduction, Life and Notes by A.M. Sellar (Londër: George Bell and Sons, 1907): f. 102–4.

33 Instituti, *Historia e Partisë*, f. 430–3.

“opiumi i popullit”, etj.) ndaj “adhurimit të Zotit të vërtetë” ose normave dhe zakoneve komuniste.

3. Paralajmërimi se ky proces do të jetë gradual dhe jo i dhunshëm, në mënyrë që “ajo racë e sheh me sytë e saj që tempujt e saj nuk po shkatërrohen”, duke mos fyer kështu “ndjenjat të një mase” njerëzish apo punëtorësh.
4. Ndërgjegjësimi mbi vështirësitë e procesit të “konvertimit”, pasi “padyshim që jo gjithçka mund të hiqet nga mendjet e tyre kokëforta menjëherë”, sepse “feja i ka rrënjët shumë të thella”, dhe zëvendësimi i përmbytjes së saj do të jetë “një luftë e gjatë, e ndërlikuar dhe e vështirë”.
5. Pohimi se e vetmja mënyrë për ta arritur këtë është duke fituar “zemrat e tyre” me “një punë të dendur sqaruese dhe ateisto-shkencore”, në mënyrë që “duke njohur dhe adhuruar Zotin e vërtetë [ose mësimet e partisë komuniste], ata mund të mblidhen bashkë në vendet e tyre të zakonshme më miqësisht”.

Pavarësisht nëse partia komuniste e Shqipërisë kishte reflektuar mbi thënien e Krishtit “unë nuk erdha për t'i shfuqizuar, po për t'i plotësuar.” (*Mat. 5:17*), dhe sado të çliruar mund të dukeshin nga ndikimet fetare, komunistët e kuptonin mirë ambivalencën e manifestimeve fetare dhe i përdorën ato për qëllimet e tyre qysh në krye të herës. Siç thotë Enver Hoxha kur përshkruan vitet e para formative të partisë komuniste gjatë rezistencës antifashiste (nga vitit 1942 e më pas):

Përpara një studimi të tillë ishte vënë Partia gjatë kësaj periudhe edhe për sa u përket besimeve fetare në Shqipëri. Besimet fetare i analizuam në dy drejtime: influenca konkrete e feve në masat e gjera të popullit dhe rrezikshmëria e hierarkisë fetare. [...] Pra, çështjen e besimeve fetare Partia e pati në qendër të vëmendjes gjatë gjithë kohës së Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe pas luftës, pse nuk duheshin prekur ndjenjat e njerëzve për të arritur ngritjen e popullit në luftë për çlirimin e adheut e ndërtimin e një Shqipërie të re. [...] Përpara kësaj detyre imperative duhej të kalonin në plan të dytë të gjitha ndryshimet në bindjet ideologjike e në simpatitë politike, ndasitë fetare e krahinore.<sup>34</sup>

Në fakt, ky studim çoi në simulimin e ritualeve fetare me norma dhe përmbytje socialiste. Pra toni u përcaktua nga Enver Hoxha që në vitet e para. Kur Baba Mustafa (Faja) Martaneshi shprehu gadishmërinë për të hequr petkun fetar për t'u bërë pjesë e partisë komuniste, përgjigja e vendosur e Enver Hoxhës qe

34 Enver Hoxha, *Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re: Kujtime dhe shënime historike* (1984), f. 14, 17, 26.

Jo, rrobat që ke, t'i mbash, [...] pse ne duhet t'i respektojmë sentimentet e besimtarëve dhe të shfrytëzojmë simpatinë që ka populli ndaj teje dhe ndaj teqesë së Martaneshit. Pra, derisa ti je i vendosur për luftë dhe e do Partinë, respekton dhe zbaton vijën e saj, atëherë ne të pranojmë anëtar partie.”<sup>35</sup>

Në këtë kontekst, nuk është e habitshme që regjimi komunist i Shqipërisë studioi dobinë dhe funksionet e pelegrinazhit të krishterë dhe arriti të përvetësonte një pjesë të mirë të strukturës së tij. Pikërisht bazuar në këtë u përpoqëm të tregojmë në këtë artikull se lapidari në Qukës–Pishkash dhe tentativa për marshimin e vitit 1979 të përqëndruar tek teksti dhe kujtesa, u përpoqën të imitojnë pelegrinazhe fetare të kësaj natyre.

---

<sup>35</sup> Po aty, f. 271–2.

# Lapidars and Socialist Monuments as Elements of Albania's Historic Cultural Landscapes

Matthias Bickert

“With the passage of years, time corrodes the memory and lays down its patina, and the past, whether remembered in the mind, or visible around us, becomes more and more obscured and fragmented.”

Fatos Lubonja, “The Ironies of Transition”<sup>1</sup>

## Introduction: The collective memory on cultural landscapes

Once, while buying olives at Tirana's Pazar i Ri (New Market), I discerned an abstract shape behind the sellers (ALS-2). “What is this?” a friend who was visiting from Germany asked me. After I tried to explain him briefly what a “lapidar” is, my friend wanted to take a picture of it. The surrounding sellers' faces clearly expressed incomprehension about why a foreigner would care about this concrete structure, against which they used to stack up their cardboard boxes and fruit trays. A little later, on the way to Krujë, we again encountered several of those strange sculptures and obelisks of different sizes, shapes, and forms, dominating the Albanian landscape that passed by our bus window. Some of them were in bad shape (e.g., ALS-596) another one had been recently transformed into a stele covered with smiling, ghost-like faces (ALS-594). “Why are they in such different conditions if they are all from the communist period?” was my friend's legitimate question.

In order to approach an answer to this question, this paper deals with lapidars and socialist monuments as elements of Albania's cultural landscapes and discusses the role of lapidars and socialist monuments in the perception of the historic cultural landscapes of contemporary Albania, the necessity of starting a discussion about its material socialist heritage, and its meaning for the conservation and valuation context of the lapidars and socialist monuments as elements of the historic cultural landscapes and the context.

Most of the lapidars and other monuments built during the communist period still exist today, making them anything but a “lapidary” element in the Albania land-

scape. They are much more than mere constructions of stone, concrete, and metal. Following Maurice Halbwachs's thoughts on what he called *collective memory*, it may be suggested that they are an element of common knowledge, common memory, and foremost of a common Albanian identity.<sup>2</sup> Jan Assmann further differentiates collective memory into *communicative* and *cultural* memory. Communicative memory refers to orally transmitted, individual memory.<sup>3</sup> Therefore, it endures no longer than 3–4 generations or around 80–100 years.<sup>4</sup> Cultural memory refers to an objectified, physically present culture that transmits knowledge about past and present societies. It includes, for example, stamps, posters, pictures, costumes, monuments, buildings, or in fact entire cities, as well as landscapes. Lapidars and other socialist monuments, together with the cultural landscapes they shape, are thus part of Albania's cultural memory. Although cultural memory may be based on materialized objects, this does not imply that they are also perceived objectively. Like communicative memory, cultural memory is group- and identity-specific as it represents the expression of just one group, transmitting the message of “this is us” or the opposite (“these are the others”).<sup>5</sup> Thus a native citizen would perceive the same cultural landscape different from a foreigner, an urban citizen different from a rural citizen, or a socialist different from a democrat, and so on. But at the same time, the production of an object-based culture is used to selectively support and (re)produce identities; they create “fixed points” of history and figures of remembrance that become “islands of time,” which induce a retrospec-

1 Fatos Lubonja, “The Ironies of Transition,” introduction to C. Kleineidam & H.P. Jost, *Albania in Transition 1991– [Shqipëria në tranzicion 1991–]* (Zürich: Benteli, 2011), pp. 7–17, at p. 7.

2 Maurice Halbwachs, *La mémoire collective* (Paris: Presses Universitaires de France, 1950): [http://www.psychanalyse.com/pdf/memoire\\_collective.pdf](http://www.psychanalyse.com/pdf/memoire_collective.pdf) (Accessed July 21, 2014).

3 Jan Assmann, “Kollektives Gedächtnis und kulturelle Identität,” in *Kultur und Gedächtnis*, ed. Jan Assmann (Frankfurt am Main: Suhrkamp, 1988), pp. 9–19; Jan Assmann, “Communicative and Cultural Memory,” in *Cultural Memory Studies: An International and Interdisciplinary handbook*, ed. Astrid Erll and Ansgar Nünning (Berlin & New York: De Gruyter, 2008), pp. 109–18.

4 Jan Assmann, “Kollektives Gedächtnis und kulturelle Identität,” p. 11.

5 *Ibid.*, p. 13.



tive consideration.<sup>6</sup> Another attribute of cultural memory is its reproduction of memory itself. Therefore, the perception of cultural memory evolves over time.<sup>7</sup> So, neither by perceiving objectivized legacies of the past, nor by communicating about them, we are able to reach absolute “truth.”

### On cultural landscapes

To discuss lapidars and their role in Albania’s contemporary, post-socialist cultural landscapes, it is necessary to understand the definition of cultural landscape. The term *cultural landscape* is highly amorphous, owing to an often significant discrepancy between the scientific and general use of both the terms “culture” and “landscape.” For the purposes of this paper, we will define “culture” as every creation of mankind, regardless of the idiosyncracities of its creator. Although there are many scientific definitions of “landscape,” which often describe a landscape as a piece of the earth’s surface that is dominated by a distinct “total character,” it should be pointed out that these definitions never consider a landscape to be predefined and bordered by nature but always as existing as a manifestation of human assessment.<sup>8</sup> Cultural landscapes are therefore pieces of the earth’s surface that form sources and testimonials of the past and present cultural production. Hence their inventory, according to functional connections of their elements, historic layers, and risk potentials, is one of the most important aspects of knowing cultural landscapes. These aspects can be only partially observed through physiognomic examination, as older and newer elements are often layered like a palimpsest. Only through the consultation of maps, writings and statistics, these different elements can be distinguished from one another, as has been done in case of the Albanian Lapidar Survey.<sup>9</sup>

Cultural landscapes may be distinguished from *natural landscapes*, which are untouched by any cultural influence. But as nowadays nearly the entire habitable surface of the earth is or once was significantly changed by human influence, it should be considered cultural landscape,<sup>10</sup> including post-socialist landscapes that are

containing elements of melioration, terraces, and other land processing influences.

There is a growing understanding of the concept of cultural landscape, and particularly relevant to the present paper are the numerous publications that have appeared about socialist architectural heritage. Czepczyński’s *Cultural Landscapes of Post-Socialist Cities* offers a scientific discussion on the topic, while Kulić et al.’s *Modernism In-Between* is one of many recently published illustrated books on socialist cultural heritage.<sup>11</sup> That the time is more than right for an intensive discussion about the future role of Albania’s lapidars and socialist monuments as part of the country’s cultural landscapes, is also shown by the recently initiated “International Scientific Committee on Twentieth Century Heritage,” where ICOMOS (UNESCO most important advisory organization on cultural heritage) discusses the possibilities of declaring certain representatives of “socialist heritage” as World Heritage Sites.<sup>12</sup>

Following the theory of collective memory, cultural landscapes are mainly generated by discourses of different actors. This, in turn, requires matched forms of governance.<sup>13</sup> This constructivist perspective is also backed by the so-called “European Landscape Convention” (ELC),<sup>14</sup> an international treaty that aims at the protection, planning, and management of the specifics of the European landscape. Within this treaty, a landscape is defined as “an area, *as perceived by people*, whose character is the result of the action and interaction of natu-

11 Roman Bezjak, *Socialist Modernism* (Ostfildern: Hatje Cantz, 2011); Frédéric Chaubin, *CCCP: Cosmic Communist Constructions Photographed* (Cologne: Taschen, 2011); Mariusz Czepczyński, *Cultural Landscapes of Post-Socialist Cities: Representation of Powers and Needs, Re-materialising Cultural Geography* (Aldershot, England & Burlington, VT: Ashgate, 2008); Jan Kempnaers and Willem Jan Neutelings, *Spomenik* (Amsterdam: Roma Publications, 2010); Vladimir Kulić, Maroje Mrduljaš, and Wolfgang Thaler, *Modernism In-Between: The Mediatory Architectures of Socialist Yugoslavia* (Berlin: Jovis, 2010); Katharina Ritter, *Soviet Modernism 1955–1991: An Unknown History* (Zürich: Park Books, 2012).

12 ICOMOS, “Invitation to Participate in ISC20C Project for Conserving Socialist Heritage” (International Council on Monuments and Sites, 2013; [http://www.docomomo.de/attachments/387\\_B\\_ICOMOS\\_20C\\_LETTER%20Project%20for%20Conserving%20the%20Socialist%20Heritage%20of%20the%20Post-War%20World.pdf](http://www.docomomo.de/attachments/387_B_ICOMOS_20C_LETTER%20Project%20for%20Conserving%20the%20Socialist%20Heritage%20of%20the%20Post-War%20World.pdf)).

13 Gailing & Röhring and Fürst et al. as quoted by Winfried Schenk, “Merkmale urbaner Kulturlandschaft im Kontext aktueller Planungsdiskurse um ‘Kulturlandschaft,’” in *Stadt – Kultur – Landschaft*, ed. Deutsche Bundesstiftung Umwelt (DBU) and Deutsche Gesellschaft für Gartenkunst und Landschaftskultur (DGGL) (Berlin: Deutsche Gesellschaft für Gartenkunst und Landschaftskultur [DGGL], 2009), pp. 11–4, at p. 12.

14 Ibid.

6 Ibid., p. 12.

7 Ibid., pp. 13–4.

8 Uta Steinhardt, Heiner Barsch, and Oswald Blumenstein, “Landschaft als Gegenstand wissenschaftlicher Erkenntnis,” in *Lehrbuch der Landschaftsökologie*, ed. Uta Steinhardt, Heiner Barsch and Oswald Blumenstein (Heidelberg: Spektrum Akademischer Verlag, 2012), pp. 23–69, at p. 32.

9 Andreas Dix, “Vorindustrielle Kulturlandschaften. Leitlinien ihrer historischen Entwicklung,” in *Die Veränderung der Kulturlandschaft: Nutzungen, Sichtweisen, Planungen*, ed. Günter Bayerl and Torsten Meyer (Münster, New York, Munich, Berlin: Waxmann, 2003), pp. 11–31, at p. 13.

10 Ibid., p. 11.



Fig. 1 Stereotype of the socialist Albanian landscape: Vilson Halimi, "Kudo jemi ne ballë," 1976, oil on canvas, 145 × 200 cm. Courtesy Galeria Kombëtare e Arteve, Tirana. A lapidar can be seen on the right edge of the picture

ral and/or human factors."<sup>15</sup> Thus, landscapes should be perceived as cradle of cultural identity, common heritage, and expression of the European variety.<sup>16</sup>

Following the suggestion of Freytag that "history is objectified into the landscapes in which it took place, and now it is visibly in-situ, the thousand year old in the same presence as of yesterday and today,"<sup>17</sup> we may now turn to *historic cultural landscapes*. A historic cultural landscape is an excerpt of an existing cultural landscape, dominated by historic cultural landscape elements. These elements are defined as witnesses of the works of past generations, which under present conditions would not appear in the same way (or at all) as they did under

former socio-economic and political settings.<sup>18</sup> Therefore, all cultural landscape-shaping elements from the socialist period automatically become elements of historic cultural landscapes in a post-socialist environment. Furthermore, a historic cultural landscape that mainly consists of or is dominated by a high density of socialist cultural landscape elements might then be called a *historic socialist (cultural) landscape*.

During the last years the Albanian bunkers have become a stereotypical element of the country's historic socialist landscape. This is connected to the significant number of recent publications in varying quality about those "concrete mushrooms."<sup>19</sup> Although their sheer

15 "European Landscape Convention: ETS No. 176," Council of Europe: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/176.htm> (Accessed July 19, 2014). My emphasis.

16 Schenk, "Merkmale urbaner Kulturlandschaft," p. 12.

17 Carl-Hans Hauptmeyer, "Kulturlandschaften aus regionalhistorischer Sicht," in *Siedlungsforschung: Archäologie – Geschichte – Geographie*, ed. Klaus Fehn (Bonn: Siedlungsforschung, 1996), pp. 301–13, at p. 310. My translation.

18 Andreas Dix, "Grundsätze zur Definition und Bewertung historischer Kulturlandschaften," in *Historische Kulturlandschaft und Denkmalpflege: Definition, Abgrenzung, Bewertung, Elemente, Umgang*, ed. Birgit Franz and Achim Hubel (Holzwinden: Mitzkat, 2010), pp. 22–9, at p. 25.

19 E.g. Alicja Dobrucka, "Mapping Bunkers": <http://www.domusweb.it/en/photo-essays/2012/04/03/mapping-bunkers.html> (Accessed July 19, 2014); David Galjaard, Slavenka Drakulić, and




Fig. 2 Layers of cultural landscapes in Albania

(Modified and translated according to Schenk, "Anmerkungen zum Verhältnis von Politik und Kulturlandschaftsentwicklung in Albanien," p. 71)

22 Shih p.sh. Oliver Jens Schmitt, *Die Albanen: Eine Geschichte zwischen Orient und Okzident* (Mynih: Beck, 2012).

23 Shih p.sh. Winfried Schenk, “Anmerkungen zum Verhältnis von Politik und Kulturlandschaftsentwicklung in Albanien,” në *Jüngere Fortschritte der regionalgeographischen Kenntnis über Albanien: Beiträge des Herbert-Louis-Gedächtnissymposiums*, red. Hans Becker, Karsten Garleff dhe Wilfried Krings (Bamberg: Fach Geographie an d. Univ., 1991), f. 69–81, në f. 78–9.

24 Gazmend Bakiu, *Tirana e vjetër: Një histori e ilustruar* (Tiranë: MediaPrint, 2013).



munist, duket se qasja ndaj trashëgimisë së ndërtuar të kësaj periudhe është një çështje shumë më e ndërlikuar. Ndërhyrjet groteske hapësinore të kësaj periudhe janë ende elementi dominues në imazhin që të huajt krijojnë për Shqipërinë. Ndonëse për shumicën e shqiptarëve ato janë kujtesa e një diktature shtypëse, shumë prej tyre përfaqësojnë gjithashtu kontributin e vetë popullit në formimin e vendit falë orëve të pafundta harxhuar për “punë vullnetare”. Për të tjerë, lapidarët dhe monumentet socialiste janë thjeshtë pika orientimi, shpeshherë edhe në mungesë, d.m.th. pasi janë shkatërruar. Për të rinjtë shqiptarë që u rritën pas përfundimit të komunizmit, peizazhet socialiste kulturore historike janë më së shumti kronika që luajnë rolin e kujtesës së një historie të vonët, ndonëse ajo nuk diskutohet hapur. Nëse i referohemi materialit të mbledhur gjatë Hulumtimit mbi Lapidarët e Shqipërisë, mund t’i kategorizojmë lapidarët si më poshtë:

- a. Të shkatërruar, pjesërisht apo plotësisht, ose të vandalizuar;
- b. Të harruar ose të lënë pas dore;
- c. Të ruajtur e të mirëmbajtur;
- d. Të transformuar ose të restauruar.

Ndonëse është e pamundur që çdo lapidar të futet në një prej këtyre kategorive nëse marrim parasysh format hibride të disave prej tyre, ky kategorizim i përgjithshëm na lejon të arrijmë në disa përfundime fillestare sa i përket kushteve të ndryshme në të cilat ndodhen këto struktura. Një analizë e mirëfilltë e kujtesës komunikuese, që do të thotë, e gamës së opinionëve të publikut sa i përket perceptimit të elementeve të peizazhit kulturor socialist, luante një rol kyç në punën kërkimore mbi peizazhet kulturore post-socialiste. Duke qenë se studimet cilësore mbi këtë temë nuk ekzistojnë, ka gjasa që kërkimi ynë nuk do të shkonte përtej fazës së hipotezës. E megjithatë, mund të propozojmë që tani disa konjektura bazuar në materialin e mbledhur dhe në kategoritë e sipërpërmendura. Gjendja e një lapidari ose monumenti socialist varet, hipotetikisht, sipas rëndësisë nga:

1. Mesazhi;
2. Vendndodhja;
3. Forma (paraqitja artistike dhe përmasat).

1) Mesazhi që përcjell një lapidar apo monument socialist është ndoshta faktori më i rëndësishëm sa i përket mënyrës se si ai trajtohet në një shoqëri post-socialiste. Lapidarët dhe monumentet socialiste që përcjellin një mesazh i cili konsiderohet me vlerë për kuptimin aktual të historisë në periudhën post-socialiste mund të jenë më të mirëmbajtur. Ndonëse lufta e partizanëve kundër pushtimit fashist është plot e përplot me propagandë komuniste, për shumë shqiptarë ajo mbetet pjesë e identitetit kombëtar

dhe një fakt historik që nuk është pasqyruar në mënyrë aq kritike sa do duhej. Për këtë arsye, lapidarët dhe monumentet socialiste që përkujtojnë partizanët në përgjithësi, veçanërisht në kontekstin e ngjarjeve të rëndësishme, si për shembull monumenti i Drashovicës [ALS-438], ose emrat e individëve të caktuar, mirëmbahen. Varrezat e dëshmorëve hyjnë në këtë kategori, duke qenë se shteti, shoqëria, si dhe familjarët e partizanëve ndjejnë përgjegjësi për të ruajtur kujtimin e të rënëve. Assman thotë se nëpërmjet ruajtjes së kujtesës kulturore, një grup i caktuar stabilizon dhe transmeton identitetin e tij.<sup>25</sup> E anasjellta qëndron po aq: neglizhimi dhe shkatërrimi i objekteve të kujtesës kulturore është simptomë e një identiteti të ri, të ndryshëm nga i mëparshmi. Kështu, lapidarët më abstraktë, ku mungon lidhja me një apo më shumë partizanë, apo lapidarët që përkujtojnë arritjet e komunizmit si një ideologji në vetvete ka gjasa të mos mirëmbahen, madje të vandalizohen e shkatërrohen, pjesërisht ose plotësisht (p.sh. lapidari në Gorrë, ALS-324). Këto janë procese të ngjashme me ato të *damnatio memoriae* (mallkimit të kujtesës) që i ndodhi shumë busteve e statujave që përkujtonin udhëheqësit komunistë në vende të tjera ish-socialiste.

2) Vendndodhja e një lapidari dhe monumenti socialist është gjithashtu e një rëndësie të veçantë sa i përket gjendjes së tij por për arsye të tjera, më konkretisht, distancën nga zonat e populluara, dhe nëse bëhet pengesë për ndërtimet formale apo informale që u kryen gjatë periudhës së tranzicionit. Nga njëra anë, ndërtimi i një pallati shumëkatësh, parkingu, rruge, etj. (p.sh. ALS-162) mund të bëhet shkas për shkatërrimin e një lapidari. Nga ana tjetër, në shumë raste lapidarët janë kursyer me ndërgjegje, ose të paktën janë vendosur diku tjetër në vend që të shkatërroheshin (p.sh. ALS-200). Kur vëllai i zv. kryebashkiakut të Krujës shkatërroi një lapidar pasi “i pengonte fushëpamjen”,<sup>26</sup> ppati reagime edhe nga media madje. Akti në vetvete mund të lidhet edhe me vendin ku ndodhi. Hipoteza këtu është se në veriun e Shqipërisë, tradicionalisht bastion i PD-së, veçanërisht gjatë viteve të tranzicionit kishte më shumë gjasa që lapidarët të shkatërroheshin dhe që ikonat e tyre komuniste të hiqeshin ose të vandalizoheshin me shkrime politike se sa në jugun e vendit, tradicionalisht bastion i PS-së (p.sh.

<sup>25</sup> Assmann, “Kollektives Gedächtnis und kulturelle Identität”, 15.

<sup>26</sup> “I pengonte fushëpamjen, vëllai i kryetarit të Bashkisë shkëlqoi lapidarin, reagojnë veteranët”, *NOA.al*: <http://www.noa.al/artikull/i-pengonte-fushëpamjen-vellai-i-kryetarit-te-bashkise-shkëlqoi-lapidarin-reagojne-veteranet/406034.html> (Hyre 21 korrik 2014).



lapidarët në Kalis, ALS-645, dhe Bajram Curr, ALS-540). E megjithatë, duke qenë se lapidarët në veri në shumicën e rasteve përkujtojnë luftën kundër otomanëve ose “shovinizmin serb” (p.sh. lapidari në Topojan, ALS-566), hipoteza mund të jetë arsyeja pse niveli i përgjithshëm i shkatërrimit të lapidarëve është i ngjashëm si në veri ashtu edhe në jug.

3) Së fundmi, jo të gjithë lapidarët dhe monumentet mund të hiqen, edhe kur bllokojnë një ndërtim (shpesh herë informal), për shkak të përmasave të tyre. Ashtu siç ndodhi me bunkerët, shumica u integruan në ndërtimet e reja, si në mure apo edhe shtëpi (ALS-563), ose u transformuan për të përcjellë një mesazh të ri. Lapidari në aksin rrugor Fushë-Krujë – Krujë (ALS-594) si dhe ai afër Çaushit (ALS-423) janë shembujt më të spikatur të këtyre të fundit. Mund të ndodhë edhe që lapidarët dhe monumentet socialiste të jenë mirëmbajtur ose të paktën të mos jenë zhvendosur për shkak të paraqitjes artistike origjinale. Monumentet e mëdha në veçanti, që kanë një paraqitje më komplekse e më të spikatur ka shumë të ngjarë që ende ekzistojnë.

### Vlera të tjera të trashëgimisë për një zhvillim strategjik

Siç përmendëm më sipër, faktori kohë luan një rol të rëndësishëm në mënyrën se si trajtohen strukturat e ndërtuara. Alois Riegel, një pioner i vërtetë i ruajtjes së trashëgimisë moderne, e ka shprehur këtë nëpërmjet konceptit të tij të *vlerës kohore*, që përcakton se si një monument ngjall ndjesi dhe kujtime vetëm falë vjetërsisë së tij. Nuk duhet të harrojmë megjithatë se ka disa *vlera trashëgimie* po aq të rrënjësura, të cilat edhe ato përcaktojnë rëndësinë e një monumenti.<sup>27</sup> Vlerat e trashëgimive ekzistuese apo të ardhme konsistojnë në aspektet estetike, artistike, shkencore dhe sociale të tyre. Një vlerë më e ngushtë, por më e njohur në komunitetin shkencor, është *vlera historike*. Sipas kësaj të fundit, një trashëgimi është një dokument historik ose dëshmi e një të kaluarë që përfaqëson një periudhë tashmë të mbyllur të veprës njerëzore.<sup>28</sup> Vlen të përmendim këtu ndër shumë të tjera edhe *vlerën relative artistike*. Kjo vlerë presupozon se një monument mund të gjykohej jo sipas një shijeje estetike tërësisht individuale dhe për pasojë subjektive, por sipas një opinioni “relativ” që është më objektiv. Nëse e shohim zhvillimin e artit, arkitekturës dhe modës ndër vite, është e qartë se ato i nënshtrohen një procesi të vazhdueshëm ndryshimi. Rrjedhimisht,

një trashëgimi duhet të vlerësohet jo në bazë të standardeve estetike bashkëkohore por në bazë të aftësive artistike që u investuan në krijimin e saj.

Vijat e drejta dhe abstrakte, shpesh herë të ftohta ose brutale në pamje të parë, të artit dhe kulturës së realizmit socialist, dallojnë fort nga format e epokave të mëparshme. E megjithatë, mjeshtëria artistike që nevojitej për projektimin e një lapidari apo monumenti socialist është e vyer nëse marrim parasysh udhëzimet mjaft strikte të regjimit komunist. Riskun që shoqëronte kapërcimin e atyre kufijve e shohim në rastin e arkitektit dhe artistit Maks Velo dhe të piktorit Edison Gjergo, të cilët u burgosën për vepra të cilat u konsideruan tepër moderniste. Për më tepër, nëse shohim strukturat artistike komplekse të monumenteve në Mushqeta [ALS-304] ose Pishkash [ALS-38], nuk është vetëm *vlera e tyre relative artistike* që bie në sy. Edhe në rastin e strukturave më të vogla, si lapidarët në Frashër [ALS-243] dhe Pilur [ALS-430], ato karakterizohen nga një thjeshtësi unike dhe një thellësi kuptimplotë që fare mirë mund të provokojë një interes të posaçëm tek vrojtuesi.

Pa dashur të shndërroj një periudhë vërtetë të dhimbshme të së kaluarës së Shqipërisë në eufemizëm, lapidarët dhe monumentet socialiste në këtë katalog arrijnë megjithatë të sensibilizojnë njerëzit ndaj këtyre vlerave. Për më tepër, duke paraqitur gjendjen aktuale të këtyre trashëgimive potenciale, imazhet na bëjnë të reflektojmë në mënyrë kritike rreth asaj që do të ndodhë apo duhet të ndodhë më pas. Qëndrimi shpeshherë shpërfillës në raport me to ka çuar në krijimin e ambienteve unike në mjedisin post-socialist. Varrezat e dëshmorëve të Sarandës [ALS-424], për shembull, gjenden midis pishinës së një hoteli, shtëpive tradicionale shqiptare dhe ndërtimeve të reja informale.

Situata komplekse që skicuam më sipër bëhet shkak për shfaqjen e strategjive të ndryshme për trajtimin e monumenteve; *ruajtja* e monumenteve nga degradimi i mëtejshëm është gjëja më e rëndësishme për ata që i japin një rëndësi të veçantë vlerës kohore, d.m.th. vjetërsisë së një monumenti. Të tjerë deklarojnë se *restaurimi* i monumenteve ndihmon në ruajtjen e potencialit të tyre për të shërbyer si dokumente historike, dhe për këtë arsye i japin një rëndësi të veçantë vlerës historike. Në praktikën e ruajtjes së trashëgimisë këto dy filozofi janë vazhdimisht në konflikt. Edhe në rastin e një marrëveshjeje globale, si “Karta e Venecias për Ruajtjen dhe Restaurimin e Monumenteve dhe Parqeve Arkeologjike”,<sup>29</sup> ende mungon një udhëzim i pranuar botërisht se si duhen trajtuar monumentet bazuar në

27 Alois Riegl, *Der moderne Denkmalkultus, sein Wesen und seine Entstehung* (Vienë, Leipzig: W. Braumüller, 1903), f. 22.

28 Achim Hubel, *Denkmalpflege: Geschichte – Themen – Aufgaben. Eine Einführung* (Stuttgart: Reclam, 2006), f. 78–81.

29 ICOMOS, International Charter for the Conservation and Restoration of Monuments and Sites (The Venice Charter 1964): [http://www.icomos.org/charters/venice\\_e.pdf](http://www.icomos.org/charters/venice_e.pdf) (Hyre 19 korrik 2014).

hierarkinë e vlerave të trashëgimisë. Ndërsa motoja e Georg Dehio, që së bashku me Riegl është “babai” i ruajtjes së trashëgimisë moderne në Evropë, është “mos restauroni, ruani!”;<sup>30</sup> në shumë vende aziatike, për shembull, ndodh e kundërta. Një tjetër praktikë që është popullarizuar së fundmi shkon edhe më tej se restaurimi: *rikonstruksioni* i monumenteve të shkatërruara. Dresden Frauenkirche në Gjermani, apo pjesa e qytetit të vjetër të Varshavës, që u shkatërruan gjatë Luftës së Dytë Botërore, janë rikonstruksione, dhe të dyja u bën shkas për debate të forta mes specialistëve të fushës. Ndonëse janë kundërshtuese dhe në pamje të parë problematike, këto qëndrime kanë një të përbashkët: potencialin që paraqesin për një dikutim të hapur mbi të ardhmen e lapidarëve dhe monumenteve socialiste në Shqipëri, si dhe për ndërtimin e politikave të qëndrueshme mbi peizazhet socialiste historike të vendit.

### Zhvillimi i politikave të trashëgimisë kulturore për lapidarët dhe monumentet socialiste

Ndërtimi i një baze për të reflektuar në mënyrë kritike mbi elementet e peizazhit kulturor socialist do të luante një rol kyç në procesin ende të munguar të përbaljes me të kaluarën socialiste.<sup>31</sup> Rritja e ndërgjegjshmërisë mbi peizazhet kulturore në përgjithësi, pohimi i dimensionit edukativ që kanë dhe i rolit që luajnë në prodhimin e identitetit, si dhe sensibilizimi i popullatës mbi lapidarët dhe monumentet socialiste si një pjesë e peizazheve kulturore historike do të kontribuonte në reflektimin mbi të kaluarën e vonët e problematike të vendit. Për ta arritur këtë, mbështetja institucionale është thelbësore. Rrjedhimisht, mbrojtja e lapidarëve dhe monumenteve socialiste duhet të ketë një bazë ligjore. Pikë së pari, vjetërsia e një monumenti nuk duhet të bëhet pengesë për cilësimin e tij si të tillë. Në pamje të parë, një draft i kohëve të fundit për ndryshime në ligjin “Për Trashëgiminë Kulturore” (Nr. 9048), që propozon uljen e pragut të vjetërsisë për objektet e trashëgimisë nga 100 në 50 vjet, duket si një fillim pozitiv.<sup>32</sup> Megjithatë,

edhe në këtë rast do të përfshihej vetëm një pjesë e trashëgimisë socialiste, kurse pjesa tjetër do të përjashtohej në mënyrë krejtësisht arbitrare, që është akoma më alarmante. Do të kishte më tepër kuptim të përcaktohej një vjetërsi relative për monumentet potenciale. Kjo do të nënkuptonte që për t’u cilësuar si monument një objekt duhet të konsiderohet si dëshmi e një periudhe të mbyllur të historisë, dhe vetëm pasi ka kaluar një periudhë e caktuar kohore, që zakonisht është një brez ose e thënë ndryshe ±30 vjet.<sup>33</sup> Për më tepër, ligji “Për Trashëgiminë Kulturore” duhet të identifikojë e të përcaktojë edhe mundësitë për mbrojtjen e peizazheve kulturore historike. Një gjë e tillë jo vetëm që do të reflektohej në planifikimin e peizazheve, por do të kontribuonte në mbrojtjen më efektive të ndjenjës së identitetit dhe të përkasjes (të qenurit “në shtëpi”) në një botë me hope të mëdha ndryshimi.

Përveç mbrojtjes së tyre ligjore, duhen valorizuar edhe aspektet edukative të lapidarëve dhe monumenteve socialiste si elemente të peizazheve kulturore historike. Kjo mund të marrë formën e ekskursioneve në rastin e kurrikulave shkolllore e universitare, dhe formën e pllakave informuese në rastin e publikut të gjerë. Ajo nënkupton gjithashtu edhe rritjen e aksueshmërisë të vendeve të rëndësishme, si varrezat e dëshmorëve në Tiranë, për të gjithë, pikërisht duke i promovuar këto vende si të tilla. Fatmirësisht, ka plot shembuj se si mund të trajtohen e paraqiten përmendoret e “vështira”. Përveç vendngjarjeve të terrorit fashist, si “Documentation Centre Nazi Party Rally Grounds” në Nyrëmberg, përkujtimore të së kaluarës socialiste mund të vizitohen në disa shtete ish-komuniste, si për shembull “Memento Park” në Budapest, apo “Muzeu i Artit Socialist” në Sofje.

Për ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm në ruajtjen dhe promovimin e peizazheve kulturore historike, nevojitet gjithashtu një inventar i elementeve të tyre. Edhe në këtë rast, përvoja e vendeve të tjera nuk mungon. Një inventar modern ka avantazhin që mund të aksesohet prej kudo, jo vetëm në një hapësirë të caktuar. Një shembull i mirë këtu është KuLaDig, një sistem GIS (Geographic Information System), i peizazhit kulturor të pjesës së zonës së Nordrein-Westfalen në Gjermani. Hulumtimi mbi Lapidarët e Shqipërisë përbën një bazë të shkëlqyer për angazhim të mëtejshëm në këtë fushë, pikërisht sepse i gjithë dokumentacioni është publikuar online dhe është i aksesueshëm nga kushdo.

Përveç kornizës ligjore dhe asistencës teknike, nuk duhet të harrojmë se mbrojtja e lapidarëve dhe monumenteve socialiste nuk do të ishte e qëndrueshme

<sup>30</sup> Shih Georg Dehio dhe Alois Riegl, *Konservieren, Nicht restaurieren: Streitschriften zur Denkmalpflege um 1900* (Braunschweig, Wiesbaden: Friedr. Vieweg & Sohn, 1988).

<sup>31</sup> Oliver J. Schmitt, “Die Herrschaft des Horrors: Albanien tut sich schwer mit der Bewältigung seiner Vergangenheit,” *Neue Zürcher Zeitung*, 23 korrik 2012; Idris Idrizi, “Zwischen politischer Instrumentalisierung und Verdrängung: Die Auseinandersetzung mit dem Kommunismus in Öffentlichkeit, Geschichtspublizistik und Historiografie im postkommunistischen Albanien,” në *Jahrbuch für Historische Kommunismusforschung 2014*, red. Ulrich Mählert et al. (Berlin: Metropol-Verlag, 2014), f. 93–106, në f. 105–6.

<sup>32</sup> Christoph Heuter, “Zu nahe dran? Bauten der 1960er Jahre als Herausforderung für die Denkmalpflege,” në *denkmal!moderne: Architektur der 60er Jahre: Wiederentdeckung einer Epoche*, ed. Adrian v. Buttlar and Christoph Heuter, Jovis Diskurs (Berlin: Jovis, 2007), f. 28–35, f. 28.

<sup>33</sup> Carl-Hans Hauptmeyer, “Kulturlandschaften aus regionalhistorischer Sicht,” in *Siedlungsforschung: Archäologie – Geschichte – Geographie*, f. 301–13, në f. 309.

pa mbështetjen e opinionit publik dhe pa pjesëmarrjen e gjërë të shoqërisë në këtë proces. Në Shqipërinë post-socialiste në veçanti, ku shteti ligjor dhe instrumentat e planifikimit lënë shumë për të dëshiruar, impakti i shoqërisë shqiptare mbi paraqitjen e peizazheve kulturore, kryesisht në saj të nivelit të lartë të ndërtimeve informale, është shumë më i konsiderueshëm në krahasim me vende të tjera. Për pasojë, nevojitet edhe një studim empirik mbi perceptimin e lapidarëve dhe monumenteve socialiste si elemente të peizazhit kulturor historik që merr parasysh edhe kategoritë e ndryshme të shkatërrimit, shpërfilljes, mirëmbajtjes dhe transformimit të tyre.

### **Përfitimet e mbrojtjes aktive të peizazheve socialiste historike**

Në rastet kur peizazhet kulturore mbrohen, nevojiten indikatorë për ruajtjen e tyre duke qenë se funksioni i tyre original ka pushuar. Kur tha se “të ruash” atë që ka humbur çdo funksion ekonomik në një shoqëri kapitaliste do të thotë “të subvencionosh”, Hauptmeyer identifikoi një sfidë madhore për ruajtjen e peizazheve kulturore historike. Aspekti edukativ është ai që do duhej ta bënte këtë sfidë të kapërcyeshme. Ruajtja e peizazheve socialiste kulturore historike presupozon gjithashtu pranimin dhe vlerësimin e atyre që kanë punuar për to dhe se ato mund të jenë shprehje të varfërisë, shtypjes ose cënimit. Nëse nuk valorizojmë aspektin e tyre edukativ, peizazhet kulturore mund të shndërrohen nga vende të kujtesës në objekte estetike.

Lapidarët dhe monumentet socialiste janë vepra arti të cilat, sidomos në zonat rurale, zënë një vend të zgjedhur dhe në disa raste përbëjnë elementin më të spikatur të një peizazhi. Kështu ato transformohen në ekuivalentin rural të një *strukture urbane dominante* që në thelb përcakton karakterin tërësor të një peizazhi. Po të hiqeshin ose shpërfilleshin ato patjetër që do të shkaktonin ndjenja mungese dhe tjetërsimi. Kështu pra, ruajtja e lapidarëve dhe monumenteve socialiste presupozon ushqimin e ndjenjës së përkatësisë dhe të identitetit shqiptar. Mbrojtja e ndjenjës së përkatësisë është e një rëndësie të veçantë, sidomos në kontekstin e dinamikave të zhvillimit post-socialist dhe ndryshimit e shpejta që pasuan. Peizazhe të reja kulturore prodhohen qëllimisht për të stimuluar procese të reja të formimit të identitetit në shoqëritë post-socialiste. Një shembull i spikatur është “Disney-fikimi” i Shkupit në kuadrin e një projekti masiv për rishikimin historicist të kryeqytetit të Maqedonisë. Edhe në Shqipëri, në kuadrin e 100-vjetorit të pavarësisë në 2012, u ndërtuan një numër i konsiderueshëm monumentesh të reja. Njëkohësisht, shohim edhe një ri-shenjtërim të hapësirës (publike) që nxitet

nga donatorët e huaj – p.sh. ndërtimi i qindra xhamive dhe kishave. Për shkak të elementeve arkitektonike më të spikatura të këtyre të fundit, si minaretë dhe kullat e kishave, ky proces ka patur një ndikim të madh tek peizazhet kulturore aktuale. E gjithë kjo ka shkaktuar humbjen e shpejtë të asaj që shumë njerëz e quajnë “shtëpi”. Fakti që në këtë rast nuk kemi të bëjmë thjesht me çështjen e bukurisë së një peizazhi vërtetohet edhe nga vendet e trashëgimisë industriale, si dhe në punën e të ashtuquajturëve “arkeologë të qendrave tregtare”: grupime individësh që studiojnë qendra tregtare të braktisura në Shtetet e Bashkuara. Nëse marrim parasysh debatet emocionale rreth degradimit të këtyre ish-tempujve të konsumerizmit, vëmë re se është potenciali i këtyre vendeve për të na kujtuar fëmijërinë që krijon ndjesinë e të qenurit si-në-shtëpi [*homeliness*].<sup>34</sup> Kjo nuk kundërshton në asnjë rast historinë problematike që mund të përfaqësojnë elemente të caktuara të këtyre peizazheve kulturore. Shembuj nga Gjermania tregojnë se si ruajtja e trashëgimisë fashiste funksionon si një trashëgimi “pohuese” që kontribuon në përcaktimin thelbësor të një identitetit (kombëtar) i cili në tërësinë e tij është antifashist. Lapidarët dhe monumentet socialiste, duke qenë një element kaq i dukshëm i peizazhit të Shqipërisë, duhen parë jo vetëm si një strukturë e rëndësishme për prodhimin e identitetit për vendasit, por edhe si një faktor në prodhimin e imazhit që të huajt krijojnë për Shqipërinë kur e vizitojnë atë.

Kjo e fundit i jep peizazheve kulturore historike socialiste një potencial të madh ekonomik. Pjesa dërrmuese e të huajve vijnë në Shqipëri pikërisht për shkak të historisë së periudhës komuniste, dhe jo pavarësisht asaj. Kurioziteti rreth një sistemi politik për të cilin ka patur shumë pak informacion është pjesë e asaj që e bën Shqipërinë e sotme tërheqëse. Përveç një historie antike të pasur dhe një vije bregdetare mbresëlënëse, që megjithatë është mjaft e kërcënuar, shumë turistë duan të shohin dhe të kuptojnë më tepër rreth të kaluarës socialiste të vendit. Peizazhet socialiste historike luajnë një rol të rëndësishëm në transmetimin e këtyre njohurive. Kështu pra, neglizhimi i tyre përveçse do të ishte humbja e një shansi për t’u përballur me historinë, do të nënkuptonte gjithashtu edhe shpërfilljen e potencialit të tyre ekonomik. Kjo nuk do të thotë që çdo bunker, çdo taracë, dhe çdo lapidar duhet ruajtur dhe restauruar me çdo çmim. Ekzistojnë ama shumë vende të përshtatshme të cilat mund të cilësohen si trashëgimi kulturore dhe që si të tilla mund të mbrohen, veçanërisht ato që kanë një densitet të lartë elementesh të peizazhit kulturor historik. Nëse marrim parasysh se ICOMOS ka themeluar një

34 Dix, “Grundsätze zur Definition und Bewertung historischer Kulturlandschaften,” f. 24.

“task force” për përfshirjen e dëshmimeve të sistemit socialist në listen e Vendeve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, Shqipëria ka të gjitha mundësitë për t’u bërë lider global në këtë fushë.

### **Përfundimi**

Ndonëse u ndërtuan gjatë komunizmit dhe përfaqësojnë historiografinë komuniste, lapidarët nuk perceptohen ekskluzivisht si struktura që përfaqësojnë komunizmin. Rrjedhimisht, nuk ka një konsensus të gjerë rreth çështjes nëse lapidarët ose monumentet socialiste duhen shpërfillur apo hequr. Lapidarët dhe monumentet socialiste që tematizojnë elemente të caktuara apo të gjithë linjën e historiografisë komuniste, nga ilirët tek partizanët nëpërmjet Skënderbeut, vazhdojnë të thonë “këta jemi (ende) ne”. Përkundrazi, ata që përfaqësojnë ideale më abstrakte të komunizmit thonë “këta nuk jemi më ne”, dhe probabiliteti që këta lapidarë dhe monumente socialiste janë shpërfillur apo shkatërruar është më i madh. Së fundmi, lapidarët e mirëmbajtur dhe herë-herë të restauruar kundër “shtypjes otomane” apo “shovinizmit serb” thonë “këta kanë qenë gjithmonë ata” ose “këta vazhdojnë të jenë ata”, që sidomos në rastin e shembullit të dytë mori vull falë luftës në Kosovë. Në fund të fundit, e gjithë kjo dëshmon se historiografia komuniste jo vetëm që është ende e pranishme në Shqipërinë post-socialiste por edhe se ajo ende pranohet pa ndonjë reflektim publik kritik.

Për këtë arsye, trajtimi i trashëgimisë së ndërtuar të periudhës komuniste është një temë tërësisht e shpërfillur në Shqipëri. Rrjedhimisht, thjesht ekzistenca e këtij botimi dhe sistemit dixhital të informacionit që lidhet me të përbën një pasurim të rëndësishëm të kujtesës kulturore mbi lapidarët dhe monumentet socialiste. Në të njëjtën kohë, ato krijojnë një bazë për rijetëzimin e kujtesës komunikuese nga harresa e plotë ku ka rënë. Edhe pse kujtesa komunikuese ka një kohëzgjatje prej vetëm 3–4 brezash, çdo debat kritik mbi këtë temë është një element i rëndësishëm për mirëmbajtjen e historisë gojore të Shqipërisë.

Siç dëshmojnë edhe intensifikimi kohët e fundit i hulumtimeve ndërkombëtare dhe diskutimeve publike rreth peizazheve kulturore dhe monumentalizmit socialist, nuk është tepër vonë për Shqipërinë për t’u angazhuar në këtë fushë. Mund të themi madje se tani është momenti i duhur për të filluar punë. Kjo kërkon grumbullimin e të dhënave dhe njohurive empirike, krijimin e një diskutimi të gjerë shkencor, politik dhe publik, krijimin e kornizës së duhur institucionale dhe mbrojtjen dhe promovimin e potencialit turistik të lapidarëve dhe monumenteve socialiste si pjesë e peizazheve kulturore historike të Shqipërisë. Dhe duke qenë se

humbja e dëshmimeve të së kaluarës së vonët është një proces në vazhdim, domosdoshmëria për të bërë sa më sipër është e fortë dhe urgjente.



# About the Film Lapidari

Julian Bejko

The sounds of war and partisan songs accompany the first shots of the film *Lapidari*.<sup>1</sup> Perched on a hill top, the cameraman shows the entire green valley, partially filled with the smoke clouds of the battles. So we are somewhere in the years '43-'44 of the previous century, when all of humanity and Albania were involved in the horrible events of the Second World War. On the one side the partisans, and on the other the Nazi occupiers, in a bloody battle for freedom or death on the land of the Albanian people, completely exhausted by the centuries of occupations and occupiers.

The film carries the signature of the most important directors and members of the cinema of the dictatorial regime. Its length of 10 minutes classifies it as a short film, but as we will see below, in those few minutes the director synthesizes shy of half a century of Albanian socialist history.

In the above war, there is a village cradled in the valley, and next to it a small plateau where a partisan loses his life. A solemn moment, his friends from the partisan brigade build his final abode. His grave rests on and is surrounded by several rounded river stones, while on top there is a large rock on which one of the partisans inscribes the martyr's name. A red scarf – symbol of the partisan resistance – covers his underground chest as his fellow warriors give him the honors of the moment by

placing springtime flowers, whose aroma can unfortunately no longer be smelled (*fig. 1*). In a tracking shot, the camera makes an inventory of the flowers along the grave-monument, continuing to the next shot. A shepherd chiseling a double-headed eagle onto a plaque to add it to the mass of furnishings belonging to the martyr. Two women, one dressed in black, most certainly the partisan's mother, another, younger one, his wife, with a red overskirt, approach the grave to place some other flowers. The mother caresses her son's head, while his wife touches his feet, then touching her pregnant belly, as if to suggest the force of life over death.

The next scene opens with the agrarian reform of 1946, when the farm grounds were confiscated from the land owners of the old regime and distributed among simple villagers. Meanwhile the martyr's child has been born and has grown enough to accompany his mother to work the soil. Happy villagers sow around the grave-monument.

From far we hear the sound of railroad construction. We are in a new stage of social development, the train, the locomotive, the industrialization of the economy. In the meanwhile the monument seeks to update itself according to these new criteria. From the form composed of river stones, ordered and sculpted by artisans, the monument takes on the form of a small pyramid (*fig. 2, 3*)

Not much time passes before the film touches upon another chapter of history, the completion of the modernization objectives of socialism. Albania is shown as

<sup>1</sup> Director Esat Ibro, screenplay Viktor Gjika, 1984–6. AQSHF 1/2–941.



Fig. 1 *Lapidari* (screenshot).



Fig. 2 *Lapidari* (screenshot).



a country of well-being, mechanized means of production, population growth, electrification, a railway and road network, etc. Owing to this further progress, the monument will reformulate itself anew as something resembling the form of an obelisk built from marble plaques (fig. 4). People from around the country assemble near it to honor and pay respect to the figure of the martyr. His son has grown up and has become a man. Reminiscences of the past pass before his eyes as he plows the field near the lapidar, not by means of a plow and oxen but with a tractor.

Final fragments of the film: the village celebrates the marriage of the martyr's son in the abundance of socialist realism. The monument on top of the hill has transformed into a place of pilgrimage for the young generations and children accompanied by the kindergarten teacher.

The film *Lapidari* was practically unknown to the Albanian public of the time and even more so in our days. Nonetheless, this art work possesses some very special elements in terms of sociology, philosophy, and politics. In Albania there exists a large variety of lapidars built throughout the entire territory, near cities, villages, motorways, but also far away in remote hilly and mountainous areas. The present publication of photographs, created by Vincent W.J. van Gerven Oei and Marco Mazzi, is proof of that.

If we ask about the reasons of their construction during the dictatorial regime, we will be able to list the most important ones. First, lapidars have a simple function; to commemorate the battles against the occupiers, partisan martyrs, but also those massacred in revenge by the occupiers. In this sense, the lapidar aims to be a monumental work related to a place and a concrete event of the past. As a work that is both artistic and especially monumental, the lapidar becomes a sign and carrier of

the heroic history of the country. But not only that. A monumental work related to historical events is a point of unchangeability sculpted in time. Through the importance of the event, it seeks immortality as a monumental work on the condition that nothing threatens or touches – if not the content of the event, then at least its monumental form.

Second, as a consequence, the lapidar or monument acquires another function as a storage of collective memory or the people of past events, whom one tries to relate to the living that assemble around them in their remembrance and honor. This is not something extraordinary, but a phenomenon that we encounter any time that we visit the graves of regular mortals. Only the lapidar posits something deeper, the struggle and death of several people whose identities and characteristics are extinguished relatively to the main symbol that embodies their labor. The same happens with martyrs' cemeteries or monuments of the unknown soldier. War monuments have a heavier concrete and symbolical weight than regular graves. That is one of the reasons to bury the body of the former dictator near the martyrs' cemetery in Tiranë in 1985, and the same holds in our times for people fallen on duty, mainly police officers.

Third, thanks to this contact with the memory of the fallen, the lapidar fulfills a necessary ethical function in the moralization, disciplining, and education of society. Except informing, commemoration, and respect, this rapport touches upon people's affects toward martyrs, a cathartic process that on the one side pacifies the spirits as happens in cemeteries, while on the other side mobilizing individuals who not only guard the memory, event, history, but who also behave in such a way that their actions are considered worthy toward the blood spilled for freedom. Honoring monuments implies humility, respect, and engagement with the continuation



Fig. 3 *Lapidari* (screenshot).



Fig. 4 *Lapidari* (screenshot).

of the heroic act of the martyrs.

Fourth, the lapidars are built with another aim, this time *metaphysical*. As cultic and sacred places, they cause a spiritual feeling throughout the body. If we focus on the commemorative rituals surrounding monuments, the entire behavior resembles a religious ceremony. There we find a sacred place, a cause, martyrs, and later a monumental constructions in their honor, as compensation for the absent body. In the ideology of the time, metaphysical approaches were strictly prohibited, above all after the legal ban on religious institutions and practices as well as the constitutional sanction that God did not exist. But like any ideological machinery, it needs new motives, one of which is the ritualization and sacralization of places of those who fell during the war. In fact, this phenomenon is completely metaphysical albeit patched and camouflaged with concrete elements: a simplified esthetic in the construction of lapidars in order not to give them artistic properties detached from major events; uniformization of the majority of lapidars according to the same architectural and artistic stylistics. A regime may halt the functioning of several institutions but not of concepts and mentalities. The metaphysical language serves to form a dichotomy of the event between the concrete act and its politicization.

And so we arrive at the fifth reason. A regime conceived to live for a long time, even planned as infallible, well-constructed once and for all on its principles and ideology, stubborn, which after several decades takes on the form of immortality and the cult of a charismatic leader, needs to dig in the past of its country to find different ways to legitimize its existence as a consequence of the historical stages of the country, and naturally as the final prophet of the realization of the infant nation itself. To fulfill its own prophecy, the regime needs a new archeology not only of knowledge but of its interpretation and construction, there where things do not go according to the vision of the regime, by means of monuments. A part of the partisans have fallen in battle. Their bodies no longer exist. The scientific–stalinist ideology of the regime confirms that after death there is nothing else. But here metaphysics intervenes and expresses itself with romantic and sentimentalist overtones about the martyrs that live in our hearts and minds. But this virtual life full of affects alone is not enough. That's why who knows how many lapidars need to be built to give life to the absent bodies, to materialize and congeal in a pile of inert matter called a lapidar. The annual pilgrimage to the martyrs' places is a politicization and continuous manipulation of the living by means of the dead who occupy the figures of apostles and ecumenical disciples. The construction of monuments substitutes

for the churches and mosques destroyed after 1967. This phenomenon is not articulated as a simple substitution of one form of sacredness with another. In the eyes of the regime, religious metaphysics is related to superstitious forms, whereas lapidars and monuments signify something true; the loss of life for freedom. The politicization of the martyr's body through religio-ideological ritualization and ceremony has been so strong, that in our days a part of society still treats the lapidar as symbol of the dictatorial communist regime, that is, as a farce, as an image without body.

In the film several events are intertwined in a complex and parallel manner. The main event in the first shot is of course related to the death of a partisan and the construction of his lapidar. Other events are fluid and transitory. Between the first shot and the fragmentary images, the process of construction the country happens, which in truth is the fundamental aspect of the film. Our film resembles a polyphony composed of three voices, two allegedly occupying the spotlight, and the third one articulated according to the moment and need. But which is the more interesting aspect of the film?

When we listed some of the functional aspects of lapidars above, we stressed that their role as commemorative monuments and signifiers of past events, and, as a consequence, the monument as work and as event, does not need to change in form. The approaches, sensitivities, or interpretations of society may change over time. But a monument, whether this or that lapidar, art work, historical building, etc., never. Thanks to them, people have the possibility to touch the past, to understand the conditions that brought something to life, to penetrate into norms and concepts of a society that is no longer alive. This, among others, is the reason why people admire a Roman aqueduct, a Byzantine church, a Mona Lisa, an amphitheater from antiquity, etc. Their untouchability often has a universal value allowing us to understand and experience the pains and sufferings of mankind at a distance. Monumental objects relating to a bitter or pleasant event derive their value precisely from the embodiment of the invulnerability of existence in form and mentality, even though the current stage of civilization, in crisis situations and overturning, has preferred to hide the victims together with the necessary traces to build a commemorative object – the case of mass annihilation (*Shoah*) is a witness to the criminal schizophrenia that claimed not only the disappearance of a people but especially the disappearance of the process of disappearance.

In the film, by contrast, we notice that the martyr's monument finds itself in a wave of constant metamorphosis. It is increasingly modified in tandem with the

progressive development of the country. First a grave surrounded by stones. Then a lapidar of about three meters high. And finally, an obelisk consisting of marble plaques of about ten meters. Maybe the director wanted to give a message about the martyr's life, where the lapidar, as vital extension of his body, grows according to the progress of Albanian modernity – a message that is extremely explicit in the film. The entire life of the village is organized around the monumental body as if the latter lies waiting to see whether or not the work of society coincides with the ideals of the war and the loss of life. A dialectic relation. Society seems to give account for everything it does in daily life. So the idea is understandable that memory unfolds in terms of social frameworks and that beyond them individuals cannot relate between generations, as the dead live together with the living in terms of collective memory and that the problems of the dead weigh continuously upon the living. The *martyr-monument* serves as a pivot around which not only society exists but remembers its past. On another level of the film, the entire development of the country is presented fragmentarily, which on the one hand seeks to be the authoritative voice of innovations, while on the other to show the living and the dead the continuous struggle for the preservation of the martyrs' monumental work. We see here summarized the entire evolution of society from the conditions of an enslaved and occupied people into a society that enters the modern world of industrialization without forgetting the effort of their martyr fathers.

The great need to give monuments the metaphysical attributes of a living being maybe falsifies unintentionally the notion itself of the unchangeable monument as work related to an event and a place. In truth, we do not stand in front of a technical lapsus of the film, but rather an artistic artifice that shows something else: the politicization of history, life, man, aims, and usage of emotions to serve governmental power. There where governmental power is unable to threaten a historical object, this object is given another interpretation according to the vision of the regime with the help of historiography and ideology.

But in our case this metastable situation of the monument as never-ending process serves governmental power in an instrumentalization that we also encounter in other societies, and which is supported by the figure of the martyr and his capture in the strategic mechanism of governmental power. The growing intensity of the events of the past, thanks to the euphoric-victimizing metaphor, serves the broadening of governmental power over a multitude of events that no longer belong to the past but to the present and the future. In a com-

pletely banal way, there exist current trends to dedicate further attention to the National Liberation War for political reasons, consisting in the growth of the party electorate and militance, simply exploiting affects and emotions related to the figure of the martyr. But the dictatorial regime acted according to the same technique. The emphasis on the role of the partisans and martyrs in daily life, in slogans, books, educational and disciplinary methodology, in cinema and literature, did not have to do directly with the deceased, but with the impact that they have on the living, who need to be governed and manipulated through all kinds of means and manners.

In conclusion, we would emphasize that totalitarian governmental powers are distinguished by yet another feature, by the aim and practice that they have in maintaining their hegemony over the entirety of life in all its variety. Fixated on the ideals of progress and advancement, of war for the domination of territories and ever greater populations, the victim's body has to live continually as an embalmed body within a half amorphous monument. So a part of the state crimes are realized not only in the name of the living people but also of the *living martyrs*, which maybe would be extraordinarily ashamed if they would have been able to foresee what would happen after the liberation. The political control over the dead is a control over memory and thus the continuous control over the living is realized. It is this fundamental reason why the lapidar in *Lapidari* is constantly in a state of construction, because governmental power never ends in a stadium or stage, and even should not be thought as a monolithic structure but as a dynamics that needs new energy to maintain its self-existence.

# Rreth filmit Lapidari

Julian Bejko

Tinguj lufte dhe këngë partizanësh shoqërojnë imazhet e para të filmit *Lapidari*.<sup>1</sup> Operatori i vendosur majë një kodre fokuson gjithë luginën e gjelbër pjesërisht e mbuluar nga tymnaja e luftimeve. Jemi pra diku rreth viteve '43-'44 të shekullit të kaluar kur mbarë njerëzimi dhe Shqipëria ishte e përfshirë nga ngjarjet e tmerrshme të Luftës së Dytë Botërore. Në njërën anë partizanët, në tjetrën pushtuesit nazistë, në një betejë të përgjakshme për liri a vdekje në truallin e popullit shqiptar, tejet i drobitur nga vazhdueshmëria e pushtimeve dhe pushtuesve ndër shekuj.

Filmi mban firmat e regjisorëve dhe pjesëtarëve më në zë të kinemasë së regjimit diktatorial. Kohëzgjatja e tij prej 10 minutash e bën të klasifikohet si metrazh i shkurtër por siç do e shohim më pas, në këto pak minuta regjisorit sintetizon rreth gjysëm shekulli të historisë së Shqipërisë socialiste.

Në luftë e sipër, në gjirin e luginës ndodhet një fshat dhe krahë tij një rrafshnaltë e vogël ku një partizan humb jetën. Çast solemn, shokët dhe shoqet e brigadës partizane ndërtojnë banesën e tij të fundit. Varri i tij qëndron mbi dhe rrethuar nga disa gurrë të rrumbullakosur lumi ndërsa në krye ndodhet një shkëmb i madh mbi të cilin njëri prej partizanëve gdhend emrin e dëshmorit. Një shall i kuq – simbol i rezistencës partizane – mbulon kraharorin e tij nën dhe teksa bashkëlufëtarët e tjerë i japin nderimet e rastit duke vendosur lulet e një stine

1 Regjisor Esat Ibro, skenari Viktor Gjika, 1984–6. AQSHF 1/2–941.



Fig. 1 *Lapidari* (kapje ekrani).

pranvere, aroma e së cilës fatalisht nuk do shijohet më (fig. 1). Kalimthi kamera bën një inventar të luleve buzë varrit monument për të kaluar në planin e radhës. Një bari që gdhend shqiponjën dykrenare mbi një pllakat për t'ia shtuar korpusit së orendive të dëshmorit. Dy gra, njëra veshur me të zeza, mesiguri nëna e partizanit, dhe një tjetër më e re në moshë, e shoqja e tij, me një mbulesë të kuqe mbi fustan, i afrohen varrit për t'i vendosur disa lule të tjera. Nëna përkëdhel birin e saj në kokë ndërsa e shoqja te këmbët dhe më pas prek barkun e saj të shtatzanisë, si për të nënkuptuar forcën e jetës mbi vdekjen.

Skena tjetër hapet me reformën agrare të vitit 1946 ku toka bujqësore konfiskohej pronarëve të mëdhenj të regjimit të vjetër për t'iu shpërndarë fshatarëve të thjeshtë. Sakaq fëmija e dëshmorit ka lindur dhe është rritur aq sa për të shoqëruar të ëmën në punimin e tokës. Fshatarët e lumtur mbjellin rreth e rrotull varrit monument.

Tutje dëgjohet zhurma e ndërtimit të hekurudhës. Jemi në një etapë tjetër të zhvillimit shoqëror, treni, lokomotiva, industrializimi i ekonomisë. Ndërsa monumenti kërkon të përditësohet sipas kriterëve të reja. Nga forma e përbërë më gurrë lumi të renditur e skalitur në mënyrë artizanale, monumenti merr formën e një piramide të vogël (fig. 2, 3).

Nuk do kalojë shumë kohë dhe filmi do të prekë një tjetër kapitull të historisë, përmbushjen e objektivave



Fig. 2 *Lapidari* (kapje ekrani).



modernizuese të socializmit. Shqipëria shfaqet si një vend me mirëqenie, mjete të mekanizuara prodhimi, shtim i popullsisë, elektrifikim, rrjedh hekurudhor e rrugor etj. Falë këtij progresi të mëtejshëm monumenti do të riformulohet rishtaz, diçka që ngjan me formën e obeliskut i ndërtuar me pllaka mermeri (fig. 4). Njerëz nga të gjitha anët e vendit mbliidhen pranë tij për të nderuar dhe respektuar figurën e martirit. Djali i tij është rritur e bërë burrë. Para syve të tij kalojnë remineshencat e së shkuarës ndërsa lëron arën pranë lapidarit jo më me anën e parmendës dhe buajve por autokombanjës.

Fragmentet e fundit të filmit. Fshati feston martesën e djalit të dëshmorit në begatinë e realizmit socialist. Monumenti majë kodrës është shndërruar në një vend pelegrinazhi për brezat e rinj dhe fëmijët që shoqërohen nga edukatorja e kopshtit.

Filmi *Lapidari* është pothuajse i panjohur për publikun shqiptar të asaj kohe dhe sidomos të ditëve tona. Megjithatë kjo vepër artistike zotëron disa elementë tejet të veçantë në terma sociologjikë, filozofikë dhe politikë. Në Shqipëri ekziston një mori e madhe lapidarësh të ndërtuar në gjithë territorin, pranë qyteteve, fshatrave, rrugëve automobilistike por dhe larg tyre në zona të thella kodrinore e malore. Dëshmi e këtij realiteti është dhe ky album i veçantë me fotografi i krijuar nga Vincent W.J. van Gerven Oei dhe Marco Mazzi.

For similar reasons, the graves of martyrs are usually found organized in the cemeteries; in a time that lapidars and similar monuments cannot be visualized separately from the geographical place where the commemorated event has happened; so much so, that in the case of someone who has fallen in the battlefield, the displacement of the body toward a cemetery is well-tolerated (“they took him to lie with his friends”), as long as the grave does not refer to a certain place, but only to the imaginary body of the person, whereas the link of the lapidar sign with the spatial referent would be lost as soon as the lapidar were to be moved – even if only because of the immediate shift in the meaning of the indexical demonstratives *here*, *in this place*, etc. On the contrary, in the inscription of a grave, the expression “here rests...” does not gain a different meaning even when the grave is displaced, because this displacement

14 Even from a merely geometrical perspective, the distance  $a-b$  between the commemorated event and the moment of the erection of the lapidar will, in a relative sense, continue to shrink or go toward zero with the passage of the years, or with the increase in distance between the current moment and the period in which the lapidar was erected ( $a-c$ ), for the simple reason that the first one is fixed and unchangeable, whereas the second progressively increases by definition. This means that, with the passing of time, the moment of the erection of the lapidar ( $b$ ) will seem to coincide with the historical date it refers to ( $c$ )

15 Speaking about the historical monuments of the Soviet Union, Michael Yampolsky notices that “It is quite possible that the greatest achievement of Soviet culture was the maximal suppression of chronological time and the creation of illusion of stability and stasis indispensable for the functioning of the masses” (“In the Shadow of Monuments: Notes on Iconoclasm and Time,” in *Soviet Hieroglyphics: Visual Culture in Twentieth-Century Russia*, ed. Nancy Condee [Indiana University Press, 1995], p. 98).



would also presuppose the transfer of the buried body.

This notwithstanding, the functional similarity of lapidars with border stones, milestones, and other topographical signs of the administrative organization of the territory helps to better understand the role these monuments used to, and maybe continue to fulfill, within the collective rituals of historical commemoration.

As an indexical sign the lapidar only does as much as pointing with a finger, saying “here”; codifying the past and anchoring it in a territory, it sanctions the historical truth for the audience, simultaneously constituting and reproducing an interaction of governmental power with the geography.

The lapidar and other similar monuments fulfill this sanctioning or **certifying** function of history by connecting the descriptive text to the indexicality of the lapidar sign, which is attached to the territory like a thumbtack or a little flag on a map. This also means that the inscriptions on such monuments can and should be included in the category of documents that authenticate a fact as true, i.e., certificates – which have a use value to the extent that they are issued by an official authority. Actually, the erection of lapidars has always been a prerogative of the organs of local power; and the epigraphic texts have been approved by a constellation of authorities, including here the organs of propaganda of the Party Committees, the Institute of History of the Academy of the Sciences of the Republic, the Committee of War Veterans, the State Archive, the Archive of the Central Committee of the People’s Republic of Albania, and other sides interested in building and maintaining a *definite* version of the history of the National Liberation War, which would also support the present political situation *in detail*.<sup>16</sup>

From the perspective of textual typology, several formal features, such as proper nouns, dates, other numerical data (such as number of deaths or captured en-

emies), and verbal forms of the simple past characteristic of the *constative* modality, bring the inscriptions on lapidars and other monuments significantly close to certificates. As is known, certificates are constructed based on a formulary text, which is completed with specific information by the drafter during the compilation of the document. So a typical form for an inscription would as follows:

HERE ON (date), THE PARTISANS OF (name of military formation) UNDER THE COMMAND OF (name of a known commander) WAGED FIERCE BATTLE WITH (name and type of enemy). DURING THE BATTLE (name of martyrs) FELL HEROICALLY, WHEREAS THE ENEMY LEFT (number in arabic numerals) KILLED AND WOUNDED ON THE BATTLEFIELD.

What is lacking on this form, compared to a normal certificate, is the initial performative (“I, the undersigned N.N., certify that...”) as well as the identifying data of the issuance of the certificate – date and signature, together with the stamp of the pertinent authority.

And yet this lack does not deprive the inscription of its heuristic force, because, under a totalitarian regime, each unsigned (unauthorized) public inscription either conveys state authority, or is immediately seen as hostile and destroyed. It remains open for discussion whether this certification embodies also another illustration of the saying that history is written by the victors. However, the fact remains that the empty signature, characteristic for all these monuments, can function only under a totalitarian regime, where the state owns not only the territory, but also the public space of communication.<sup>17</sup>

<sup>16</sup> Whether or not this formal sanction of historical discourse through the inscription is helpful for the preservation of collective memory can and should be discussed. In *La Mémoire, l'histoire, l'oubli* (Éditions du Seuil, 2000), Paul Ricœur more than once returns to this term, starting with the myth of Teuth who gave the writing signs to the Egyptians – at the occasion of which he asks whether writing has harmed man’s capacity to remember, which from now on will be delegated to external signs. In fact, the historiography of the National Liberation War, codified in writing in official historical texts, school texts of the regime, central and local archives, central and local museums, and in monumental inscriptions, commemorative plaques, and lapidars, was always in conflict with the *private* memory of the generations that had lived through the War; those generations that, to a large extent, chose not to convey this personal memory to their successors, to protect them from the risk of ambivalent public and political experiences, as long as the problematization of the history of the War would in itself represent a thoughtcrime.

<sup>17</sup> Otherwise, a similar monument erected after 1990 would need an inscription from the pertinent authority, or would remain private and irrelevant, such as the lapidars that commemorate traffic accidents or other private events without interest to the public – as in the meanwhile, to say it with Yurchak, there had occurred a *performative shift*, and the constative dimension of discourse was detached from its reference and exposed to uncontrolled interpretations (op. cit., p. 67). However, the *current or post-totalitarian* reading of the inscriptions on lapidars and other monuments erected during the totalitarian period will remain to be investigated in a later study, which will need to consider the absence of a certifying authority, the pluralist reading of history, the damaging of lapidars and the inscriptions themselves as contestation of the official historiography, but also as a continuation of a social and political conflict, and, at the same time, as a *sign* that stands for this conflict and, finally, additions or “additions” that have been made to monuments (without excluding vandalism), which can and must be dealt with as an undertaking of anonymous agents in the rewriting of history.



# Tekste të gdhendura në kalendar: Një lexim semiotik i mbishkrimeve në monumentet përkujtimore të periudhës së Luftës Nacional-Çlirimtare

Ardian Vehbiu

*Mbishkrimet në pllakat përkujtimore, lapidarët dhe përmendore të tjera historike përmbushin një funksion të dyfishtë: ato përcjellin informacion për ngjarjet historike që përkujtohen ose kremtohen, por janë edhe pjesë e kompleksit monumental përfshirës. Janë, pra, edhe shenja edhe përbërëse sistemesh të epërme shenjash. Për këtë arsye, çdo përpjekje për të studiuar strukturën e këtyre teksteve dhe mënyrën si ato përfojnë diskurse historike nuk mundet veçse t'i kapërcejë caqet e një analize thjesht gjuhësore. Në vijim do të parashtrohet një përpjekje e parë, deri më sot, dhe sado paraprake, për të ndriçuar mënyrën si pushteti politik në Shqipëri, gjatë periudhës totalitare 1945–1990, u mbështet në këto makro-shenja për të normalizuar historinë e periudhës së Luftës II Botërore edhe nëpërmjet përpunimit të teksteve zyrtare që kënaqnin kritere të caktuara formale dhe funksionale, me qëllimin final që të legjitimonte veten në sytë e publikut.*

Mbishkrimet në pllakat përkujtimore dhe lapidarët ndryshojnë sipas një tipologjie që ka të bëjë me çfarë përkujtohet: një akt heroik, një betejë ose ngjarje tjetër me rëndësi, dëshmorët e një fshati ose një zone apo Lufta Nacional-Çlirimtare në përgjithësi. Megjithatë, nga një mbishkrim në tjetrin, mund të përcaktohen disa rregullsi, që kanë të bëjnë me strukturën e tekstit.

Kështu, shumë prej mbishkrimeve përmbajnë një element deiktik, që i përgjigjet ndajfoljes së vendit *këtu*, dhe që mund të marrë forma të ndryshme, duke u plotësuar edhe nga emra vendesh – si “këtu në Ngurëz” [ALS-328], “këtu në qafën e Kashit” [ALS-341], “këtu në Vëlush” [ALS-231], “këtu në Çarçovë” [ALS-254] – ose duke u nyjtuar në togjalësh “në këtë vend” [ALS-255], “nga ky vend” [ALS-165], “në këtë zonë” [ALS-198]. Në fakt, ankorimi hapësinor nëpërmjet deiksimit është një nga funksionet themelore të lapidarit, pllakës ose monumentit; pse vetë këto vepra janë, para së gjithash, shigjetëza që tregojnë një vend të caktuar ose flamurka të ngulura drejtpërdrejt në territor.<sup>1</sup> Kjo, pavarësisht se,

në shumicën e rasteve, funksionin deiktik e luan lapidari, pllaka ose monumenti vetë; dhe përforcimi i tij në mbishkrim, nëpërmjet elementeve thjesht gjuhësore, është redundant.

Deiksimit vendor u kundërvihen shifrat; duke filluar me datat e tipit “më 6 korrik 1943” [ALS-260], të cilat ankorojnë, këtë herë në kalendar, ngjarjet për të cilat bën fjalë teksti dhe që synon të përkujtojë mbishkrimi dhe monumenti vetë. Si rregull, data ndjek menjëherë gjymtyrën deiktike: “në këtë vend më 11 korrik 1943” [ALS-255], “Këtu më 2 korrik 1943 ra heroikisht...” [ALS-280], “këtu më 10-7-1943...” [ALS-596]. Kësisoj, vendi ku është ngritur lapidari, pllaka a monumenti lidhet, nëpërmjet tekstit, me një datë unike në kalendar, ose një vend unik në vijën kohore të historisë. Kjo lidhje, midis vendit ku ka ndodhur diçka dhe datës përkatëse nuk ka ndonjë kuptim në vetvete, por vetëm shërben për të certifikuar vërtetësinë e ngjarjes.<sup>2</sup>

Brenda teksteve, datave u bashkëlidhen edhe shifra të

---

paraqitje të përmbledhur të konceptit të *shifter-ëve* (*embrayeurs*) të Émile Benveniste, shih Gérard Dessons, *Émile Benveniste: L'Invention du discours* (In Press, 2006), f. 105-107.

2. Në versionin zyrtar të Historisë së Shqipërisë të miratuar nga regjimi totalitar i Enver Hoxhës, periudha e Luftës Nacional-Çlirimtare paraqitet si veçanërisht e pasur në ngjarje dhe data të shënueshme; ose me *dendësi të madhe kronologjike dhe mnemonike*, për ta thënë me një term të Eviatar Zerubavel-it, *Time Maps: Collective Memories and the Shaping of the Past* (The University of Chicago Press, 2003), f. 25–34. Hartat e shpërndarjes gjeografike të lapidarëve e konfirmojnë dhe e certifikojnë këtë dendësi, duke përkujtuar në çdo rast se e sotmja është produkt i një së djeshmeje historikisht *intensive*. Për këtë arsye, gjithnjë sipas kornizimit që ofron Zerubavel-i, Lufta Nacional-Çlirimtare do të përfaqësojë një periudhë “sakrale” në historinë e Shqipërisë dhe të shqiptarëve, krahas – të themi – periudhës së rezistencës anti-osmane të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Këto asimetri, ose shpërndarje të pabarabarta të historisë në vijën kronologjike, nuk kanë të bëjnë vetëm me kalendarin dhe paraqitjet materiale të historisë, si librat, monumentet (përfshi këtu edhe lapidarët) dhe muzeumet; por prekin drejtpërdrejt edhe vetë kujtesën kolektive. Zerubavel-i vëren edhe që, Lévi-Strauss, duke folur për këtë oshilacion të dendësisë së ngjarjeve të kujtuara në kronologji, e krahasonte atë me sinusoidat e përfuara nga matjet e një manometri të trysnisë historike.

---

<sup>1</sup> Për deiktikën e tekstit jam mbështetur në Catherine Kerbrat-Orecchioni, *L'Énonciation* (Armand Colin, 2013), f. 39–78. Për një



Fig.1 ALS-179 (detaj)




Fig.2 ALS-165 (detaj)

tjera, të cilat ndonjëherë u referohen të rënëve: “u vranë 14 partizanë” [ALS-198], “ranë në fushën e betejës 302 dëshmorë” [ALS-231], “në kujtim të 65 dëshmorëve e viktimave të rënë në Orman Çiflig” [ALS-103]; ndonjëherë tjetër humbjeve në radhët e armikut: “u kapën robër 25 gjermanë” [ALS-254], “armiku u çorientua dhe la 60 të vrarë” [ALS-260]; dhe më tej viktimave të Luftës: “nazistët gjermanë masakruan 27 burra” [ALS-255]; dhe më tej numrit të luftëtarëve: “rreth 300 vullnetarë të fshatrave të Kolonjës” [ALS-260]; ose numra të tjerë identifikues të formacioneve ushtarake: “një batalion i Brigadës së parë” [ALS-179], “u formua Brigada e 7-të” [ALS-231], “forcat e Brigadës së dytë” [ALS-266], etj.

Për shkak të rolit të tyre identifikues, të gjithë numrat dhe veçanërisht datat, funksionojnë si emra të përveçëm; dhe për këtë arsye mund edhe të përfshihen në grupin e madh të emrave të përveçëm që shfaqen në tekstet e lapidarëve, pllakave dhe monumenteve – zakonisht si emra njerëzish (antroponime) dhe vendesh (toponime). Këto të fundit lidhen drejtpërdrejt dhe shpesh rimarrin deiksisin e ndajfoljes përkatëse, ose të vetë monumentit; por mund të emërtojnë edhe një zonë më të gjerë, dhe që lidhet me komunitetin që e ka vendosur dhe e mirëmban pllakën: “populli i zonës së Shijakut” [ALS-164], “nga rajoni mali i Nemërçkës deri në qafë të Qarrit” [ALS-254], “lavdi dëshmorëve të fshatit Lekdush” [ALS-367].

Antroponimet përfaqësojnë një grup të dytë të rëndësishëm mes emrave të përveçëm – duke dalë kryesisht si emra dëshmorësh, ndonjëherë në lista të gjata dhe të numëruara (që ndonjëherë metaforizojnë rreshtat dhe kolonat e formacioneve luftarake). Edhe pse lapidarët, pllakat përkujtimore dhe monumentet e tjera të ngjashme janë funksionalisht të ndryshme nga varrezat e dëshmorëve, ngjashmëritë tipologjike mes këtyre dy llojeve të shenjave nuk mund të vihen në diskutim. Dëshmorëve më të rëndësishëm – nëse mund të shprehemi kështu – u kushtohen pllaka më vete: “në

këtë vend në qershor 1944 në përleshje me nazistët gjermanë ra në fushën e nderit dhe të lavdisë Heroi i Popullit Zaho Koka” [ALS-432]. Në dallim nga një pllakë varri, e cila përmban të dhëna anagrafike për të varrosurin, të tilla si viti i lindjes dhe i vdekjes, tekstet në pllaka kanë lidhje me aktin heroik të rënies, jo me trupin e të vrarit vetë. Emra të tjerë të përveçëm janë ato të formacioneve luftarake: batalioni “Naim Frashëri” [ALS-285], çeta e Mokrës [ALS-496], batalioni Krujë-Ishëm [ALS-601], batalioni “Misto Mame” [ALS-401]; ose të komandantëve ushtarakë si shoku Enver [ALS-328], Mehmet Shehu [ALS-179] dhe Hysni Kapo [ALS-634].

Përndryshe, tekstet që shfaqen në monumente të tilla ngërthejnë në vetvete një pjesë thjesht informative, që lidh mes tyre vendet, kalendarin dhe njerëzit në një diskurs të ngjeshur narrativ me natyrë në thelb historio-grafike; dhe një pjesë tjetër retorike, emocionalisht të ngjyrosur dhe të pasur në klishe leksikore gjithfarësh, e cila mëton të përcjellë qëndrimin e subjektit të tekstit, ndaj ngjarjeve të përkujtuara.

Që ky qëndrim do të jetë pak a shumë solemn, këtë e përcakton njëfarësoj vetë natyra përkujtimore e tekstit – i cili synon të lartësojë një akt a një ngjarje historike, duke e nderuar thjesht me praninë e vet, por edhe nëpërmjet fjalëve. Shumë rrallë ndodh që kjo pjesë e dytë, shprehëse, të mungojë në tekst:

MË 1.6.1944 NJË BATALION I BRIG. PARË S. DHE NJË BATALION I DUMRESË NËN UDHËHEQJEN E MEHMET SHEHUT I ZUNË PRITË AUTO-KOLLONËS GJERMANE. I SHKAKTUAN ATYRE DËME TË MËDHA NË NJERËZ E MATERIALE. [ALS-179] (fig. 1)

Të krahasohet kjo me:

NGA KY VEND ME 20 NËNDOR 1943, BIJTE E POPULLIT TONË, TË ARRESTUAR PREJ NAZISTEVE GJERMANË, U INTERNUAN NË KAMPET E PËRQEN-

DRIMIT. LUFTA E TYRE PËR IDEALET E SHENJTA TË  
LIRISË SË ATDHEUT DO TË MBETET GJITHMONË  
NË MENDJET DHE ZEMRAT TONA. [ALS-165] (fig. 2)

Këtu fjalja e dytë, e shënuar me të zezë, i largohet narrativës, për të shprehur qëndrimin e subjektit të tekstit.

Si elemente vlerësuese dhe shprehëse përdoren zakonisht klishetë “ra heroikisht”, “do të frymëzojnë në shekuj”, “idealet e shenjta të lirisë së atdheut”, “në shenjë mirënjohje të thellë”, “vranë barbarisht”, “torturuan barbarisht”, “ranë me trimëri”, “për mbrojtjen e kufijve të shtrenjtë të atdheut”, “luftuan trimërisht”, “vepra juaj burim frymëzimi”, “ra në fushën e nderit dhe të lavdisë”. Edhe vetë përdorimi i foljes *bie*, me kuptimin “vritem në betejë e sipër”, është stereotipik dhe karakterizues për stilin solemn të këtyre teksteve.<sup>3</sup> Në disa raste më të rralla, krejt mbishkrimi konsiston në tekst me karakter shprehës dhe vlerësues, ndërsa informacioni historik mbetet implicit, ose jepet me mënyra të tjera:

PËR ATA QË U BETUAN VETËM NJË HERË:  
O NDËRTOJMË BOTËN E RE  
O S’MBETET ASNJË MBI DHE [ALS-235]

JU KISH LINDUR NËNA PËR NJË BOTË TË RE  
LULE MORE TRIMA  
QË RATË PËR ATDHE [ALS-419]

ATA NUK VUNË LULE TË FRESKËTA  
NË ALTARIN E LIRISË  
POR GJAKUN DHE JETËN E TYRE [ALS-81]

Një pjesë e mirë e klisheve ekspresive kanë të bëjnë me vdekjen në betejë e sipër, në atë masë që shumë nga këto tekste përkujtojnë dëshmorët, ose ngjarje ku dikush është vrarë *heroikisht* duke luftuar *me trimëri* kundër pushtuesit ose tradhtarëve.<sup>4</sup> Vdekje të tilla, derisa përkujtohen, janë gjithnjë heroike; në kuptimin që të vrarët janë shndërruar në heronj nëpërmjet mënyrës si kanë vdekur. Mes këtyre klisheve, *ra heroikisht* rezulton të jetë më e përdorura në tekstet – dhe aty heroizmi i atribuohet drejtpërdrejt aktit, dhe vetëm tërthorazi personit të vrarë.<sup>5</sup>

3 Për klishetë në ligjërimin publik të shqipes totalitare, shih Ardian Vehbiu, *Shqipja totalitare* (Botime Çabej, 2007), f. 179–83.

4 Për kultin e vdekjes në ligjërimin publik të shqipes totalitare, shih Vehbiu, *vep. cit.*, f. 215–18.

5 Dr. Vincent W.J. van Gerven Oei pati mirësinë të më dërgojë fragmentin e një dokumenti zyrtar të nxjerrë nga AQSh, ku dy specialistë të fushës, Kujtim Buza dhe Kleanthi Deda, ngrënë disa shqetësime në lidhje me natyrën e mbishkrimeve në “përkujtimoret” dhe qortojnë “standardizimin”, “ndërtimin joemocional të frazave”, “mungesën e originalitetit”, dhe “maninë për të shkruar të gjitha gjërat në një pllakë të vogël”: Kujtim Buza

Disa nga mbishkrimet përmbajnë edhe elemente tekstuale me natyrë meta-gjuhësore, të cilat i referohen jo më historisë, as vendit ku është ngritur lapidari ose monumenti, por vetë lapidarit, pllakës ose monumentit, duke eksplicituar arsytet pse këto janë ngritur.

Të tilla elemente janë formula të tipit “Kushtuar kujtimit të...”, “Kushtuar dëshmorëve...”, “Në shenjë mirënjohjeje të thellë...”, “Në kujtim të...”, ose edhe formula tjetër, më e shpeshtë e tipit “Lavdi partizanëve trima...”, “Lavdi dëshmorëve...”, etj. Ndërtime të tilla janë zakonisht eliptike, pse u mungon folja; çka është përndryshe karakteristikë sa e mbishkrimeve funerare aq edhe e teksteve në parullat publike dhe në mbishkrimet e tjera me natyrë politike. Arsyeja, me aq sa mund ta hetojmë në kontekstin tonë, ka të bëjë me nevojën për ta mbajtur në një farë distance agjencinë që ka mundësuar monumentin dhe mbishkrimin vetë.

Formula të tilla, të cilat shpesh enkapsulojnë një performativ të ndërlidhur me aktin përkushtues të monumentit, shprehin edhe subjektivitetin; në atë masë që përçojnë drejtpërdrejt subjektin e thëniesimit në tekst.<sup>6</sup> Këtu ka vend të pyetet se cili është pikërisht ai që ia kushton lapidarin “kujtimit të...”, ose thërret “lavdi...” ose që shpjegon se monumenti është ngritur “në shenjë mirënjohjeje të thellë...”. Përgjigjja e thjeshtë dhe, në dukje, logjike se këtë e thonë ndërtuesit e monumentit është, në fakt, cirkulare. Më tej akoma, subjekti i thëniesimit shfaqet edhe në krejt pjesën ekspresive ose retorike të teksteve në mbishkrimet, përfshi këtu epitetet dhe

(Sektori i Arteve Figurative) & Kleanth Dedi (Sektori i Traditave e Muzeumeve), *Disa probleme edhe masa për të ngritur me kritere më të drejta monumentet, përmendorët, bustet, lapidarët, dhe pllakat përkujtimore*, AQSH f. 511, v. 1970, d. 86, fl. 2–22, në f. 9–11. Shih edhe këtë vëllim, f. 51.

6 Me “subjekt të thëniesimit” kam parasysh atë çka teoricienët francezë të analizës së tekstit e quajnë *objet de l’énociation* ose *objet discoureur* dhe që, pa u futur në debate dhe analiza teorike, do ta përkufizoj si “instancën gjuhësore ku prodhohet teksti” (edhe pse, më e saktë do të ishte, “instancën ku prodhohet teksti, në bazë të të dhënave kontekstuale që ka në dispozicion konsumatori i tekstit”). Më tej për këtë çështje, Catherine Kerbrat-Orecchioni, *vep. cit.*, f. 190 dhe vijim. Për analizën tonë ka rëndësi të dallohet ky subjekt i thëniesimit (ose procesit përfutës të thënies) nga subjekti ose kryefjala e thënies; me të parin merret pragmatika, me të dytin sintaksa. Edhe pse, për qëllime praktike, mund edhe ta identifikojmë këtë subjekt të thëniesimit me autorin “real” ose rrefimtarin e një teksti, sërisht është më mirë të mbajmë parasysh se subjekti i thëniesimit gjithnjë manifestohet nëpërmjet elementeve të caktuara në tekst – përemrat vetorë dhe pronorë, *shifter*-ët dhe fjalët e tjera me kuptim relational, kohët dhe vetat e foljeve, mënyrat e foljeve (p.sh. habitorja), trajtat e shkurtra (p.sh. dhanorja etike) etj. Si kategori gramatikore (në kuptim të gjerë) subjekti i thëniesimit është gjithnjë i pranishëm gjatë praktikës së leximit të tekstit. Një term tjetër për këtë kategori, ashtu siç manifestohet në tekstet letrare, do të ishte *intentiono auctoris*, i Umberto Eco-s; që ndonjëherë e dëgjon edhe si *auctor in fabula*.

figura të tjera retorike; dhe fakti që këto elemente retorike janë, në masë të madhe stereotipe, të llojit “ra heroikisht”, ose “u torturua barbarisht”, etj., atëherë ka vend të mendohet ky subjekt si përfaqësues i vetëdijes kolektive, së cilës tek e fundit edhe i kërkohet të mirëmbajë kujtimin e Luftës Nacional-Çlirimtare.

Në analiza të ngjashme, gjurmët e subjektit të thëniesimit në tekste të tilla i kanë kërkuar edhe në presupozimet (*entimemat*) që u nënvendosen thëniesive; ose në deduksionin, fare të lehtë, se ai që thotë për dëshmorin “ra heroikisht”, duket sheshit se mban anën e të rënit; sikurse ai që thotë “e torturuan barbarisht” doemos ushqen armiqësi ndaj torturuesve. Edhe fjalë dhe shprehje të tjera, si “fitoren e revolucionit tonë popullor”, “jetën e lumtur që gëzojmë sot”, “heroizmi partizan”, “të masakruar”, dhe sidomos emërtimet e përdorura për armikun, si “tradhtarët e vendit”, “forcat gjermane dhe veglat e tyre”, “reaksioni”, “forcat pushtuese naziste”, “okupatorëve nazistë”, “fashistëve italianë”, “forcat gjermano-balliste”, “forcat tradhtarë të legalitetit”, etj., tregojnë jo vetëm angazhimin shpirtëror të subjektit të thëniesimit, por edhe e bëjnë këtë me mënyra të standardizuara, stereotipike, të cilat ndjekin një shabllon të shtangët. Mënyrat si mund të quhet armiku janë, në thelb, të përpunuara dhe të sanksionuara në ofcinat e diskursit historik për Luftën; dhe ka rëndësi që këto emërtime jo vetëm të shprehin ndjenja të urrejtjes dhe zemëratës, por edhe ta bëjnë këtë në mënyrë të kodifikuar.<sup>7</sup> Vetëm fjalët e veshura me uniformë kanë autorizim të përdoren në tekste të tilla, të cilat në mënyrën e tyre i vazhdojnë betejat e Luftës Nacional-Çlirimtare dhe konfliktin vetë me mjete diskursive. Dhe nëse është kështu, atëherë struktura e teksteve të mbishkrimeve u referohet, intertekstualisht, modeleve të miratuara; dhe vetë mbishkrimet dallojnë mes tyre, para së gjithash, nga emrat e përveçëm, datat dhe elemente të tjera identifikuese që përfshihen në tekst; çka edhe i afron mbishkrime të tilla me **formularët**, një tipar ky të cilit do t’i kthehemi në vijim.



Fig. 3 ALS-328 (detaj)

Retorika sunduese, në tekstet shoqëruese të lapidarëve dhe monumenteve të ngjashme që përkujtojnë dëshmorët dhe betejat e përgjakshme është ajo e *gjakut*. Gjaku është metaforë e jetës; dhe *të derdhësh gjakun* është e njëjtë me sakrificimin (ose flijimin) në fushën e betejës (*dhënien e jetës*). Që vrasja e dikujt të mos duket si produkt i rastësisë (“e mori plumbi”), ka rëndësi që të theksohet elementi i sakrificës – ose dëshmori a i rëni të paraqitet sikur e ka ofruar vullnetarisht jetën e vet “në altarin e lirisë”. Kjo retorikë e sakrificës dhe e *dhënies* së gjakut në emër të kauzës i ka rrënjët në diskursin religjioz dhe ndoshta edhe më thellë; por tani vihet e tëra në shërbim të diskursit totalitar për historinë – ku çdo i rënë është potencialisht një hero; dhe vetë vdekja e dikujt, sidomos ajo në fushë të betejës, interpretohet si shkak i “së sotmes së lumtur”. Në pllakat me mbishkrime historike, që i referohen Luftës Nacional-Çlirimtare, nuk gjen gjurmë të retorikës pacifiste për viktimat e luftës, pafajësinë dhe jetët e humbura; përkundrazi, fusha e betejës është skena ku përftohen heronjtë dhe ku çdo flijim është, njëfarësoj, edhe vetëflijim.

Si kryemetaforë, *gjaku* ndërton rreth vetes një rrjet kompleks kuptimesh, të ndërlihdura por jo identike. Kështu, në momentin e vdekjes, dëshmori *jep gjakun* “për çështjen e shtrenjtë të partisë dhe të popullit, për fitoren e revolucionit tonë popullor, për jetën e lumtur që gëzojmë sot” [ALS-138]; pa çka se nuk është e qartë se kujt pikërisht i jepet gjaku, edhe pse semantika dhe sintaksa e foljes *jep* e kërkojnë. Ndryshe nga diskursi mirëfilli religjioz ose mitologjik, ku sakrificata u bëhet perëndive (ose mbretit), në diskursin totalitar të një shoqërie që mëton të jetë ateiste, oferta e *gjakut* i bëhet së ardhmes ose rrjedhës së historisë.

Veç jetës, *gjaku* shënjon edhe përkatësinë e trupit fizik, zakonisht të dëshmorit, në komunitet; falë atij kuptimi tradicional e të ngulitur të fjalës, që i referohet fisit, bashkësisë dhe, më tej, racës (në kuptimin folklorik). Prandaj edhe *gjaku* është elementi që lidh së bashku

7 Këtë dukuri e ka analizuar, për rusishten totalitare, A. Yurchak, *Everything Was Forever, Until It Was No More: The Last Soviet Generation* (Princeton University Press, 2006), veçanërisht në kapitullin *The Normalization of Language* (f. 47–50), ku flitet për proceset karakteristike të “të shkruarit kolektiv” dhe “redaktimit të rregullorizuar”, si kushte të nevojshme për përfitim dhe riprodhimin e çka ai e quan “alfabetizim ideologjik”, ose aftësia për të prodhuar tekste ku asnjë element nuk mund të vihet në dyshim, meqë “çdo tekst i ri do të funksiononte si citim i teksteve të mëparshme”. Yurchak përdor termin “hipernormëzim”, për të përshkruar këtë lloj ligjërimi, ku “forma e teksteve autoritative vinte e bëhej gjithnjë e më e rëndësishme” se nevoja për të përcjellë një kuptim të caktuar. Për atë autor, “hipernormëzimi” ishte rezultati i “përpjekjeve të bëra nga një numër i madh njerëzish, të përfshirë në prodhimin e teksteve në gjuhë autoritare, për të minimizuar praninë e zërit të tyre autorial” (*vep. cit.*, f. 75).



*brezat*, veçanërisht brenda një komuniteti:

NË KËTË LUFTË TË MADHE JU SHOKË TË MYZEQESË  
KINI DHËNË KONTRIBUTIN TUAJ TË MADH ME  
GJAKUN E BIJVE TUAJ, ME NDIHMAT TUAJA, ME  
SAKRIFICAT TUAJA [ALS-328] (fig. 3)

Në raport me komunitetin, të rënë janë gjithnjë *bij* – kjo lidhet edhe me moshën e re të dëshmorëve, ose me nevojën e kodifikuar për t'i parë ata gjithnjë si të rinj; ndërsa komuniteti vetë shihet, para së gjithash, si i përbërë nga nëna dhe baballarë. Ky manierizëm, në dukje i pafajshëm, lejon që vetë komunitetet të shihen si artikulime *brezash*; të cilat ndërlidhen mes tyre jo thjesht nëpërmjet jetës së bashku, por edhe nëpërmjet gjakut. Kjo do të thotë edhe se gjaku i derdhur në fushën e betejës është edhe i *komunitetit* përkatës – që më pas do të ngrejë monumentin dhe do të mblidhet ritualisht për ta mirëmbajtur kujtimin e ngjarjes; ose të asaj “faqeje të lavdishme në epopenë e madhe të Luftës Nacional-Çlirimtare” e cila është shkruar “me gjak” [ALS-403].

Se si shfaqet subjekti, në tekstet e mbishkrimeve, kjo mund të gjurmohet edhe duke parë se kujt i flasin pikërisht, këto mbishkrime; kujt i drejtohen. Natyrisht, nuk do të gjejmë atje fraza eksplicite, të ngjashme me atë “Thuaju atyre në Spartë, o kalimtar...” që risjell Herodoti, për mbishkrimin në Termopile – dhe ku teksti i flet drejtpërdrejt kalimtarit të rastit. Në fakt, pyetja se kujt i flitet nuk mund të ndahet nga pyetja tjetër, se kush flet – autoriteti, pushteti dhe komuniteti. Përndryshe, në sipërfaqe të tekstit, shenjat e pjesëmarrësve ose palëve në aktin diskursiv të leximit nuk dalin veçse tërthorazi; supozimet (*entimemat*) e tekstit lidhin, me fije të padukshme, subjektin e thëniesimit me polin marrës (receptiv) të diskursit, i cili nuk ka mënyrë tjetër për të marrë pjesë aktivisht në këtë shkëmbim, përveçse duke e bërë të vetin tekstin dhe duke e shndërruar monologun e mbishkrimit në monolog të vetin.

Kjo do të thotë se tekstet e mbishkrimeve piren të jenë në vetë të tretë dhe t'i përkasin asaj çka Benveniste, dhe pas tij të tjerë semiologë të shkollës franceze, e kanë quajtur “rrefimi historik” (*récit historique*) dhe që, në atë gjuhë, shënjohej para së gjithash nga format foljore të aoristit (*passé simple*), ekskluzive për këtë lloj diskursi.<sup>8</sup> Diçka e ngjashme mund të vërehet edhe për aoristin që mbizotëron në mbishkrimet që analizojmë: *ranë, goditën, asgjësuan, demonstroi, dhanë gjakun, u internuan, u vranë, zunë pritë, u plagosën, masakruan, u kapën robër* etj. Këto forma të së kryerës së thjeshtë në shqipe, edhe pse

jo aq ekskluzivisht sa në frëngjishte, shërbejnë edhe ato për t'ia dhënë tonalitetin historik teksteve; ose për t'i paraqitur ngjarjet të cilave këto tekste u referohen si të pakthyeshme, pse të ngrira në të shkuarën, depozitë e të vërtetave përfundimtare; çfarë kushtëzon drejtpërdrejt, sikurse do ta shohim, edhe vlerën e vërtetësisë (*truth-value*) të mbishkrimeve – faktor kritik në receptimin e mbishkrimeve vetë dhe konsolidimin e versionit zyrtar të historisë.<sup>9</sup>

Vetëm në raste të rralla mbishkrimet e thyejnë kodin e rrefimit historik, për të lejuar forma personale të diskursit: “vepra juaj burim frymëzimi” [ALS-412] përmban një vetë të dytë shumës, çka do të thotë se subjekti i thëniesimit, cilido qoftë, u drejtohet retorikisht dëshmorëve si të ishin këta të pranishëm në kontekstin e komunikimit. Disi më shpesh përdoret veta e parë shumës, *ne-ja* e komunitetit ose subjekti kolektiv, depozitar, kujdestar dhe zëdhënës i kujtesës kolektive: “dhanë gjakun e tyre [...] për fitoren e revolucionit tonë popullor dhe për jetën e lumtur që gëzojmë sot” [ALS-138], “lufta e tyre [...] do të mbetet gjithmonë në mendjet dhe zemrat **tona**” [ALS-165]. Veta e parë shumës, kur përdoret, shërben edhe për të aktualizuar tekstin e mbishkrimit; sidomos po të pranojmë se lexuesi e interiorizon monologun dhe e bashkon subjektin e vet, mendërisht, me kolektivin që “flet”.

E megjithatë, mbishkrimet në lapidarët dhe monumentet e tjera përkujtimore asnjëherë nuk “nënshkruhen”; nuk shënohet aty as autori i veprës dhe i mbishkrimit vetë, as “autoriteti” në emrin e të cilit është kryer dhe vendosur monumenti (të krahasohet kjo me S.P.Q.R. në mbishkrimet klasike në Romë), përfshi edhe mbishkrimin; dhe më në fund, as vetë data e ngritjes së lapidarit. Kjo nuk duhet interpretuar sikur autori/autorët dhe autoriteti kërkojnë të mbeten në hije ose anonimë; por më shumë duhet marrë si një përpjekje për ta shndërruar shenjen në absolute, ose në pjesë të peizazhit – gjeografik dhe historik.<sup>10</sup>


9 Sipas Yurchak-ut, (*vep. cit.*), në tekstet totalitare, ku autori dhe autoriteti shpesh përkohjnë, vetë autori mëton të paraqitet jo aq si “përfutës” sesa “ndërmjetës” i dijes ose i informacionit që përcillet; në rastin tonë, e vërteta e informacionit të paraqitur në mbishkrimet e lapidarëve nuk ishte përzgjedhur, as vlerësuar nga *hartuesit* e mbishkrimeve; por vetëm riprodhuar, duke u nxjerrë nga një “magazinë” të vërtetash të amshuara.

10 Nga pikëpamja funksionale, ose semiotike, lapidarët ose monumentet e ngjashme janë menduar për t'u parë nga një farë distance – ose për t'u shquar në mes të peizazhit, qoftë ky natyror, qoftë i alteruar. Janë shenja dalluese, të ngjashme me flamurkat ose pineskat në një hartë topografike – dhe vetëm duke rënë në sy për së largu, mund ta kryejnë si duhet funksionin e tyre si “gurë kalendarike” – ose si barasvlera kujtimore të gurëve kilometrike (*milestones*). Megjithatë, nga kjo distancë relativisht e madhe mbishkrimet nuk mund të lexohen; çka do të thotë edhe se, në funksionin e vet parësor, lapidarit nuk i nevojitet mbishkrimi.

8 Émile Benveniste, “Les relations de temps dans le verbe français”, *Problèmes de linguistique générale* 1 (Éditions Gallimard 1966), f. 237–50.



Nga ana tjetër, në marrëdhënien semiotike që vendos vizitori me mbishkrimin, dhe me lapidarin a monumentin vetë, dallohen tre nyja të rëndësishme në vijën kohore: (a) data ose vendi në kalendar i ngjarjes historike që përkujtohet, dhe që zakonisht gjendet e eksplicituuar në tekstin e mbishkrimit; (c) data e tanishme, ose e aktualitetit a e momentit kur vizitori e lexon pllakën dhe konsumon mbishkrimin në lexim, për t' u njohur me ngjarjen që përkujtohet; dhe (b) data kur u ngrit lapidari, si ndërmjetësim material dhe fiks midis datës historike dhe momentit të tanishëm.



Ky trekëndësh ku secili prej këndeve përfaqëson një njëjë kohore nuk është veçse trekëndëshi semiotik i përfutur nga shenjuesi, i shenjuari dhe referenti – përkatësisht mbishkrimi në aktin e leximit (dhe krejt konteksti monumental, nëse duam), data e ngritjes së mbishkrimit (që mbetet e fshehtë ose e padukshme) dhe ngjarja historike, si referenti që qëndron jashtë shenjës.

Gjatë periudhës *a-b*, midis ngjarjes vetë dhe ditës kur është ngritur lapidari, historia ende ekziston në gjendje fluide, si beton ende i pangrirë; ngjarja mbetet e hapur për interpretime dhe autoritetet ende nuk kanë zgjedhur përfundimisht midis së vërtetave “konkurrenente” – një situatë e ngjashme me atë të maces së Schrödinger-it, në eksperimentin e famshëm konceptual. Historia, sa i për-

Përkundrazi, leximi dhe konsumimi publik i mbishkrimit bëhen nga një distancë tjetër, shumë më e afërt, nga ku mund të shquhen edhe disa tipare të tjera thjesht pamore të monumentit, për shembull ndonjë barelief, statujë ose ornament, simbolik ose abstrakt. Tani, gjithë duke mos e përjashtuar që njerëzit i afrohen lapidarit thjesht nga kurioziteti, pasi e kanë pikasur për së largu, do të pranojmë se, në rrethana normale, kur publiku të paktën ai lokal e di se çfarë përfaqëson lapidari ose monumenti në fjalë, vetë lapidari kryen një funksion të *dyfishtë*: si indeks i kulluar (“këtu”) në një farë distance; dhe si indeks i shoqëruar me elemente simbolike dhe ikonike, nga afër. Dhe nëse e pranojmë këtë, atëherë do të pranojmë edhe se teksti në mbishkrimin që shoqëron lapidarin shërben edhe si “shpjegim” i monumentit, ose parashtrim i arsyes pse është ngritur; në kuptimin që lapidari jo vetëm sanksionon një ngjarje historike, por edhe i shtohet peizazhit si vepër arti dhe, njëjloj si vepra të tjera arti, ka nevojë për një diciturë identifikuese.

ket ngjarjes në fjalë, ekziston më tepër si mbivendosje variantesh personale dhe kujtimesh të pasinkronizuara madje në konkurrencë vdekësore mes tyre. Ngritja e lapidarit (b) dhe vendosja aty e pllakës me mbishkrimin për “çfarë ka ndodhur” përfaqëson edhe çastin kur kjo histori fluide më në fund kristalizohet ose kodifikohet; dhe është gati për t’ia dhënë publikut për konsum. Në fakt, edhe vetë fakti që teksti në mbishkrim është i gdhendur në gur ose gjithsesi i shkruar në një medium të fortë dhe virtualisht të pandryshueshëm (mermer, granit, metal, beton etj.) tregon se mbishkrimi përmban rezultatin ose precipitatin përfundimtar të ngjarjes në kohë – të vërtetave divergjente dhe të mbivendosura ua lë vendin e vërteta unike dhe univoke e shkronjave kapitale në mbishkrim. Aq e madhe është forca heuristike e mbishkrimit, sa prej saj pritet të tejzgjatet prapa në kohë dhe të korrigjojë edhe ndonjë gabim a pasaktësi të mundshme, të bërë në të kaluarën.<sup>11</sup>

Siç mund të merret me mend, interesi i regjimit totalitar për kodifikimin e historisë nuk është interes thjesht akademik ose historiografik – është fjala për historinë e Luftës Nacional–Çlirimtare, ose atij konflikti prej të cilit u përfutur marrëdhëniet e pushtetit në kohën e Pasluftës (1945–1990), përfshi këtu edhe elitën që do të udhëhiqte vendin me dorë të hekurt. Në fakt, regjimi i instauruar pas Luftës, që nga fillimet e tij derisa u rrëzua në fillim të vitit 1991, do ta gjente legjitimitetin e vet më shumë në periudhën e Luftës Nacional–Çlirimtare dhe më pak në mekanizmat formalë të legjitimitetit, si zgjedhjet parlamentare. Edhe në nivelin lokal, saktësimi i ngjarjeve merrte rëndësi praktike – meqë sanksiononte komunitetet e përfshira në Luftë përkrah forcave të Frontit Nacional–Çlirimtar dhe, duke përmendur emrat e të rënëve, legjitimonte edhe një shtresë të privilegjuar të “familjeve të dëshmorëve”; njëjloj siç legjitimonte një shtresë tjetër të privilegjuar të veteranëve të Luftës, duke përmendur formacionet luftarake të përfshira në luftimet. Kishte edhe forma të tjera legjitimimi, përfshi certifikatat, dekoratat, urdhrat dhe medaljet, varrezat e dëshmorëve, arkivat e muzeve të Luftës e kështu me radhë; por lapidarët dhe monumentet e ngjashme ishin të vetmet që e ancoronin certifikimin në territor (në gjeografi).

Nga ana tjetër, vizitori komunikon drejtpërdrejt me

<sup>11</sup> Edhe thjesht nga pikëpamja gjeometrike, distanca (*a-b*) midis ngjarjes së përkujtuar dhe momentit të ngritjes së lapidarit do të vijë duke u zvogëluar ose duke shkuar drejt zeros, në kuptimin relativ, me kalimin e viteve, ose me rritjen e distancës midis momentit të tanishëm dhe periudhës kur është ngritur lapidari (*a-c*); për arsyen e thjeshtë se e para është fikse, e pandryshueshme, ndërsa e dyta me përkufizim rritëse. Kjo do të thotë se, me kalimin e kohës, momenti i ngritjes së lapidarit (b) do të duket sikur i mbivendoset datës historike të referuar (c).

mbishkrimin, jo me ngjarjen vetë; madje me kalimin e viteve, data historike e ngjarjes dhe data kur u ngrit lapidari me mbishkrimin do të vijnë duke u afruar me njëra-tjetrën, deri në shkrije – ose do të arrihet një fazë ku harta do të shkrihet me territorin dhe vetë lapidari, si makro-shenjë, do të komunikojë duke e maskuar distancën që e ndan(te) nga ngjarja vetë. Kështu, marrëdhënia tripalëshe mes shenjuesit (tekstit), të shenjuarit (arsyes ose rationale-s së monumentit) dhe referentit (ngjarjes historike) do të degradojë në marrëdhënie dypalëshe, midis shenjës (monumentit) dhe ngjarjes së referuar. Roli i monumenteve të tilla si lapidarët, në mirëmbajtjen, riprodhimin dhe amplifikimin e kujtesës historike të kodifikuar nuk mund të kryhet me sukses, veçse nëpërmjet këtij sheshimi të trekëndëshit semiotik.<sup>12</sup>

Përndryshe, si mbishkrime në medime të dureshme dhe të vëna në pah nëpërmjet strukturash pak a shumë abstrakte dhe të standardizuara, këto të lapidarëve i përkasin një klase mjaft heterogjene shenjash, ku bëjnë pjesë, ndër të tjera, edhe gurrët e varrit, varrezat monumentale (p.sh. varrezat e dëshmorëve, në Shqipëri) dhe, nga një këndvështrim tjetër, piramidat e kufirit, gurët e sinoreve dhe shenja të tjera topografike që i shërbejnë organizimit të territorit.

Ngjashmëria e lapidarëve me gurët e varrit dhe varrezat manifestohet sidomos në ato raste kur lapidarët u kushtohen të rënëve. Në ndonjë rast, si ky [ALS-204], ku edhe shënjohe viti i lindjes dhe viti i vdekjes së të ndjerit, dallimi nga varri nuk mund dhe nuk duhet të bëhet – sepse shkaku i vdekjes “rënë në përpjekje me okupatorët dhe tradhtarët...” shpesh mund të shënohet edhe në varr. Megjithatë, si rregull, lapidari nuk ka për funksion të shënojë vendin ku prehen *eshtrat* e dikujt, por vetëm ngjarjen që çoi në vdekjen e të ndjerit (dëshmorit, heroit); nuk përkujton vdekjen, sesa historinë që çoi te kjo vdekje. Ndoshta edhe ngaqë imazhi i vdekjes si barazues i madh u kish mbijetuar ndërrimit të botëkuptimeve, varret e dëshmorëve në varrezat monumentale shquhen për njëtrajtësinë e tyre vizuale dhe stilistike; çfarë nuk mund të thuhet për lapidarët, të cilët e ruajnë gjithnjë individualitetin.

Për arsye të ngjashme, edhe varret e dëshmorëve zakonisht i gjen të organizuara në varreza; në një kohë që lapidarët dhe monumentet e ngjashme nuk mund të

përftyrohen të shkëputura nga vendi gjeografik ku ka ndodhur ngjarja që përkujtohet; aq sa, në rastin e dikujt që ka rënë në fushën e betejës, zhvendosja e trupit drejt një varreze tolerohet mirë (“e çuan të rrijë me shokët”), sa kohë që varri nuk i referohet ndonjë vendi, por vetëm trupit të imagjinuar të personit; ndërsa lidhja e shenjës lapidar me referentin hapësinor do të humbiste, sapo të zhvendosej lapidari – qoftë edhe thjesht për shkak të ri-semantizimit të menjëhershëm të dëftorëve indeksikalë *këtu, në këtë vend etj.* Përkundrazi, në mbishkrimin e një varri, shprehja “këtu prehet...” nuk ri-semantizohet edhe sikur të zhvendoset varri, meqë kjo zhvendosje do të parakuptonte edhe bartjen e eshtrave përkatëse.

Nga ana tjetër, ngjashmëria funksionale e lapidarëve me piramidat e kufirit, gurët e sinorit, gurët kilometrikë dhe shenjat e tjera topografike të organizimit administrativ të territorit ndihmon për të kuptuar më mirë edhe rolin që kryenin dhe ndoshta vazhdojnë të kryejnë këto monumente, brenda ritualeve kolektive të përkujtimit historik.

Si shenjë indeksikale, lapidari vetëm sa tregon me gisht, duke thënë “këtu”; duke e kodifikuar të shkuarën dhe duke e ankoruar atë në territor, ai sanksionon të vërtetën historike për publikun, duke konstituuar dhe riprodhuar njëkohësisht një marrëdhënie të pushtetit me gjeografinë.

Këtë funksion sanksionues ose **certifikues** të historisë lapidari dhe monumentet e tjera të ngjashme e kryejnë duke bashkëlidhur tekstin përshkrues me indeksikalitetin e shenjës lapidar, që ngulet në territor njëlloj si pineska ose flamurka në hartë.

Çka don të thotë edhe që mbishkrimet në monumente të tilla mund, dhe duhet t’i përfshijmë në kategorinë e dokumenteve që autentifikojnë një fakt si të vërtetë, ose certifikatave – të cilat vlejnë në atë masë që lëshohen nga një autoritet zyrtar që e ka këtë fuqi *elokutive*. Prandaj edhe ngritja e lapidarëve gjithnjë ka qenë prerogativë e organeve të pushtetit lokal; dhe teksti i mbishkrimeve është miratuar nga një konstelacion autoritetesh, përfshi këtu organet e propagandës pranë Komiteteve të Partisë, Institutin e Historisë pranë Akademisë së Shkencave të Republikës, Komitetin e Veteranëve të Luftës, Arkivin e Shtetit, Arkivin e KQ të PPSH dhe palë të tjera të interesuara për një version të *caktuar* të historisë së Luftës Nacional-Çlirimtare, i cili t’i përgjigjet së tashmes në hollësi.<sup>13</sup>

12 Duke folur për monumentet historike në Bashkimin Sovjetik, Mikhail Yampolsky vëren se “ka shumë të ngjarë që arritja më e madhe e kulturës sovjetike të ketë qenë supresioni maksimal i kohës kronologjike dhe krijimi i një iluzioni të stabilitetit dhe të stazës, të domosdoshëm për funksionimin e masave” (“In the Shadow of Monuments: Notes on Iconoclasm and Time,” në *Soviet Hieroglyphics: Visual Culture in Twentieth-Century Russia*, red. Nancy Condee [Indiana University Press 1995], f. 98).

13 Nëse ky sanksionim formal i diskursit historik nëpërmjet mbishkrimit ndihmon apo jo për ruajtjen e kujtesës kolektive, kjo mund dhe duhet të diskutohet. Te *La mémoire, l'histoire, l'oubli* (Éditions du Seuil, 2000), Paul Ricœur i kthehet kësaj teme më se një herë, duke filluar me mitin e Theuth-it që ua dha shenjat e shkrimit egjiptianëve – me ç’rast ai pyet nëse të shkruarit e ka dëmtuar aftësinë e njeriut për të mbajtur mend; e cila tash e tutje

Disa tipare formale, si emrat e përveçëm, datat, të dhënat e tjera numerike (si numri i të varrëve, ose i armiqve të zënë rob) dhe format foljore të së kryerës së thjeshtë karakteristike për modalitetin *konstativ*, i afrojnë shënueshëm mbishkrimet e lapidarëve dhe monumenteve të tjera, nga pikëpamja e tipologjisë tekstuale, me certifikatat.

Sikurse dihet, certifikatat ndërtohen mbi një tekst formular, i cili plotësohet me informacion specifik nga hartuesi, gjatë përpilimit të dokumentit. Kështu, një formular tipik për mbishkrim do të kishte pamjen e mëposhtme:

KËTU MË (data), PARTIZANËT E (emri i formacionit luftarak) NËN UDHËHEQJEN E (emri i një komandanti të njohur) ZHVILLUAN LUFTIME TË ASHPRA ME (emri dhe lloji i armikut). GJATË LUFTIMEVE RANË HEROIKISHT (emrat e dëshmorëve), NDËRSA ARMIKU LA NË FUSHËN E BETEJËS (numri me shifra arabe) TË VRARË DHE TË PLAGOSUR.

Çfarë i mungon këtij formulari, në krahasim me atë të një certifikate të rëndomtë, është performativi fillestar (“Unë i nënshkruari N.N. certifikoj se...”), si dhe të dhënat identifikuese të lëshimit të certifikatës – data dhe nënshkrimi, së bashku me vulën e autoritetit përkatës.

E megjithatë, kjo mungesë nuk ia heq forcën heuristike mbishkrimit në lapidar; dhe kjo ngaqë, nën një regjim totalitar, çdo mbishkrim publik i panënshkruar ose përcjell autoritetin shtetëror, ose konsiderohet menjëherë si armiqësor dhe shkatërrohet. Nëse ky certifikim mishëron edhe një ilustrim tjetër të thënies se historinë e shkruajnë fitimtarët, për këtë mund të diskutohet; por fakti mbetet se nënshkrimi zero, karakteristik për të gjitha këto monumente, mund të funksionojë vetëm nën një regjim totalitar, ku shteti ka në pronësi jo vetëm territorin, por edhe hapësirën publike të komunikimit.<sup>14</sup>

---

do t’u delegohet shenjave të jashtme. Në fakt, historiografia e Luftës Nacional–Çlirimtare, e kodifikuar me shkrim në tekstet zyrtare të historisë, në tekstet shkollore të regjimit, në arkivat qendrore dhe lokale, në muzeumet qendrore dhe lokale dhe në mbishkrimet e monumenteve, pllakave përkujtimore dhe lapidarëve, binte gjithnjë në konflikt me kujtesën private të brezave që e kishin përjetuar Luftën; të cilët breza, në masë të madhe, zgjodhën të mos ua përcjellin këtë kujtesë private pasardhësve, për t’i mbrojtur nga rreziku i eksperiencave publike dhe politike të dyzuara; sa kohë që problematizimi i historisë së Luftës do të përfaqësonte vetvetiu një *thoughtcrime*.

